	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Idioms related to money</li> <li>- Vocabulary field: teenagers</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Asks grammatically structured questions related to basic needs and respond appropriately using short phrases and sentences;</li> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Uses vocabulary related to teenagers.</li> </ul>
	<p><b>Topic 5 - Fact and fiction</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Past tenses ( simple and continuous )</li> <li>- Activities</li> <li>- Time expressions</li> <li>- Which word is different?</li> <li>- Verbs and nouns that go together</li> <li>- Asking and answering about the time</li> <li>- Idioms related to time</li> <li>- Vocabulary field: Movies and books</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Engages in discussion with peers and teacher regarding real events and jokes, and compares them with personal experience;</li> <li>• Differentiates the correct use of prepositions with regard to time or location;</li> <li>• Makes a more complex oral presentation of narrative, expository, descriptive and persuasive type, with media, to a variety of audiences and receive feedback;</li> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Uses vocabulary related to movies and books.</li> </ul>
	<p><b>Topic 6 - Fame</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Perfect tenses ( present and past)</li> <li>- ever, never</li> <li>- for and since</li> <li>- already, just, yet</li> <li>- Homophones</li> <li>- Relative clauses</li> <li>- Idioms related experiences</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Makes connections to personal and shared ideas and experiences by talking in pairs or small groups;</li> <li>• Writes short, simple informal notes or messages about their experiences;</li> <li>• Expresses past events making connections with present life;</li> <li>• Asks questions to clarify or provide further understanding on the topic;</li> <li>• Takes part in discussions to express events in the past;</li> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Takes notes on a short, informal presentation on a familiar topic or on a biographical or experiential topic;</li> </ul>


	<p>- Vocabulary field: jobs</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Participates in play opportunities that promote social interaction with peers;</li> <li>• Uses vocabulary related to jobs.</li> </ul>
	<p><b>Topic 7 – Health</b>  - Giving advices  - Expressing obligations  - Abilities  - Nouns that go together  - Idioms related to health  - Vocabulary field: Food and drinks</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Writes short, simple informal notes or messages about their experiences. (places, eating, shopping, people);</li> <li>• Uses vocabulary related to food and drinks;</li> <li>• Discusses about problems and gives advice in negative and positive ways (e.g. you should/ shouldn't; you could/couldn't; I would/wouldn't);</li> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Shows awareness of a range of vocabulary related to the topic of 'health and lifestyle';</li> <li>• Writes short, simple informal notes or messages about their experiences (places, eating, shopping, people );</li> <li>• Writes a description of the way of staying healthy comparing jobs, responsibilities and activities;</li> <li>• Expresses ideas and feelings and understands and respects the perspectives of others;</li> <li>• Compares information and action required in authentic/authentic-like receipts and bills.</li> </ul>
	<p><b>Topic 8 – Hopes and Ambitions</b>  - will  - First conditional  - Time clauses  - Linking words  - Idioms related to transportations  - Vocabulary field: travelling</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Participates in play opportunities that promote social interaction with peers;</li> <li>• Makes predictions and arrangements about places, people and the weather;</li> <li>• Makes short dialogues expressing hopes and ambitions;</li> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Engages in discussion in pairs or group using their imagination and real situations;</li> <li>• Identifies and discuss aspects of everyday life such as transport, clothing and food;</li> <li>• Writes with reasonable accuracy concerning spelling and punctuation;</li> <li>• Responds to simple conversation in familiar contexts with familiar vocabulary;</li> <li>• Composes a three paragraph essay giving personal information ( journey, holiday, excursions);</li> <li>• Engages in discussion with peers and teacher regarding travel and transport;</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"><li>• Makes suggestions about places to visit;</li><li>• Uses vocabulary related to travelling.</li></ul>
--	--	---

## Guidelines for using the syllabus

All the learning outcomes in the syllabus are written based on four concepts of the language: Literary and non-literary texts, Figurative and non-figurative language, Criticism, theory and history, and Language system. Each topic in this syllabus should be treated as altogether concepts, so concepts shouldn't be developed as special but interconnected to each other within one topic, because each concept helps in development of student's knowledge, skills, values and attitudes.

In the syllabus there are all the topics that will be developed during one school year, with teaching contents for each topic. Teachers should develop the topic which is based on four concepts, laying out teaching units in logical order.



The learning outcomes in the syllabus are expectations of each student's knowledge, skills, values and attitudes in the end of this school year. Teacher's role is to develop to all students communicating skills: listening, speaking, reading and writing. In the syllabus there are outcomes based on these skills which are measurable and which affect directly to student's success. There are also some immeasurable outcomes which are important because through them students develop their values and attitudes.

## Methodological guidelines

In order to achieve the targeted aims and learning outcomes and equip learners with required competencies, Grade Seven English Language Syllabus promotes the most contemporary approaches in language teaching and learning. First and foremost, it promotes communicative approaches, task-based and project-based learning in order to facilitate learner interaction and collaboration, as well as develop learner autonomy and creativity. Thus, learning-centred approaches are favoured over the traditional approaches. Below are some brief guidelines regarding the methodology to be used by the teachers in their classrooms in order to motivate learners, as well as to facilitate their learning.



## **The Communicative Approach and Task-Based Learning**

The overall aim of the English Language Curriculum is to enable learners to communicate successfully. Successful communication means getting our message across to others effectively. The Communicative Approach to language learning aims at facilitating genuine interaction with others, whether they live in the neighbourhood, in a distant place, or on another continent.

In language learning, the attention of the learners may be focused on particular segments, or on the language as a whole. In cases when we want to focus learners' attention on particular segments, then a segment may be a grammatical structure (a tense), a language function (expressing gratitude), a vocabulary area (food and drinks), or a phonological feature (stress or particular sounds).

Since communication basically means sending and receiving messages, learners should develop the four language skills, which are the core of communication. Development of receptive skills, that is listening and reading skills, will enable learners to receive messages and, depending on tasks they are expected to fulfil, select essential information. However, since language skills do not occur in isolation, but are normally integrated for communicative purposes, after having received a message, learners should be able to make decisions, and respond appropriately. In a situation which involves language, their response is a communicative function, which is performed by one of the productive skills either by speaking or by writing.

## **The Learning – Centred Classroom**

The objective of learning-centred teaching is to make teachers aware of the importance of learner autonomy in the classroom. The teacher has a role, to support and help learners. The learners learn more actively and with enjoyment. The environment requires a learning-centred approach that relies on participant's share in the learning, and responsibility for furthering discussion. In all cases learners need clear guidelines and preparation for effective discussion and participation.

The major aim, or set of aims will relate to the development of learning skills. Such aims may include the following:

- To provide learners with efficient learning strategies;
- To assist learners identify their own preferred ways of learning;
- To develop skills to negotiate the curriculum;
- To encourage learners to adopt realistic goals and a timetable to achieve these goals;
- To develop learners' skills in self-evaluation.

## **The use of the mother tongue in the classroom**

Contrary to the principles of the direct method and natural approach in language learning, which favour exclusive use of the target language, excluding the mother tongue completely from the

classroom, most recent approaches today suggest that the use of the mother tongue at particular stages of foreign language learning may prove useful.

While there is clearly a place for the mother tongue in the classroom, teachers should make efforts to keep the use of the mother tongue to a minimum. Instead of translating words and/or asking learners to translate, they should demonstrate, act, use simple drawings and/or pictures, explain, give simple definitions. If teachers readily intervene with translation, as soon as learners are provided with an ‘equivalent’ word or expression, as soon as their curiosity is satisfied, they may lose interest in that particular item. In consequence, the English word or expression is easily forgotten and cannot be easily recalled. This method is easiest for teacher and learner, but may be the least memorable.

### **Vocabulary learning**

Vocabulary teaching and learning is central to learning English. Words have a central place in culture, and learning words is seen by many as the main task in learning another language.

At level 2 learners are beginning to read independently selecting simple texts and using a bilingual dictionary or glossary to look up new words. When reading on their own they are beginning to use context to work out what unfamiliar words mean etc.

<b>L 3</b>	<b>Teacher’s role</b>	<b>Learner’s role</b>	<b>Possible activities</b>
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ to guide the learners, monitor and assist their work to introduce new words.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ to collaborate with teachers and peers, use bilingual dictionaries, to write word lists, produce diagrams etc.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ matching parts of words to other words ,e.g. .beginnings and endings;</li> <li>▪ memory games;</li> <li>▪ filling in crosswords, grids ,and diagrams.</li> </ul>

### **The Role of Grammar**

If we see language as a building, the words as building blocks or bricks, and grammar as the architect’s plan, than we must admit that without a plan, even a million bricks do not make a building. Similarly, one may know a million English words, but if s/he does not know how to put them together, s/he cannot speak English (Sesnan, 1997).

In the light of this statement, the question is not whether to teach grammar or not, but how to teach it. We should consider which approach to adopt in teaching grammar, whether to teach form before meaning, or meaning before form, and what strategies and techniques to use in order to enable learners to put their knowledge of grammar into use and communicate effectively. It is the teacher's responsibility to estimate which approach would yield best effects at a particular stage of learning, or with a particular class.

L 3	Teacher's role	Learner's role	Possible activities
	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ To set problems, tasks and activities;</li> <li>▪ To monitor the development of activities</li> <li>▪ To make notes of possible problems related to meaning and form;</li> <li>▪ To ask questions that focus on meaning, form and context.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ To solve problems, fulfil tasks, and do activities;</li> <li>▪ To answer questions related to meaning, form;</li> <li>▪ To make attempts at noticing the regularities in language.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Problems and puzzles;</li> <li>▪ Drilling;</li> <li>▪ Open dialogues;</li> <li>▪ Substitution tables;</li> <li>▪ Guided writing.</li> </ul>

At this level, learners should be able to recognize different word categories and put words into phrases. They may also be able to combine phrases in order to form sentences. They should be able to deal with both Yes/No questions and WH-questions. At this level, learners may be able not only to grasp the meaning of language items, but also to understand particular aspects of the language system. Developing their cognitive and meta-cognitive skills, learners should be able to understand and use the rules of grammar. Regardless of this, teachers should be careful, when discussing explicitly and explaining the grammar, not to overdo, that is not to lecture on grammar. Instead, they should demonstrate grammar through substitution tables, or drills incorporated within communicative activities.

Teachers should always bear in mind that grammar is not an aim on its own, but is closely connected with communication. It should not be used as a driving force, but should arise out of other classroom activities.

## **Cross-curricular issues**

Since English Language is not taught and learnt for its own sake, but is seen as aim and vehicle, the Grade Seven English Language Syllabus integrates topics that directly relate to other subjects, such as: arts, culture, history, geography, media literacy, civic education, and similar. All these are in the function of equipping learners with first of all the communicative competence, as well as other competences foreseen in the Level Three Core Curriculum.

During this grade, learners are provided with numerous opportunities to learn about cross-curricular issues, while simultaneously acquiring and reinforcing words, phrases and simple sentences in English language. Learners are exposed to these cross-curricular issues through reading and speaking activities, structured practice of key vocabulary and tenses, information – gap activities and discussion questions.

## **Assessment and evaluation guidelines**

There are many reasons for assessing learners. Some of them are: to compare learners with each other; to see if learners have reached a particular standard; to help the learners' learning; to check if the teaching programme is successful.

Teaching means changing the learner. Teachers will always want to know how effective their teaching has been- that is, how much their pupils have changed.

This change can be seen in: the amount of English learners know; the quality of the English they use; their ability to use English.

The general word for measuring the change is assessment. Naturally if we want to assess how much pupils have changed, we have to know exactly what they already know and what they can already do.

There are different types of assessment (or evaluation).

- Self-assessment (self-evaluation)
- Group assessment (group-evaluation)
- Individual assessment (evaluation)
- Combination of group and individual assessment
- The use of work samples, portfolios and projects.

If teachers want to find out how effective their teaching has been, or if they want to evaluate the learners' progress, then tests are used. Tests are conducted in class by the teacher. They measure the results of learners' performance. Teaching and testing always go hand-in-hand. Questions are

often asked to check if the learners have understood what has been said. Equally, they may be asked to find out whether a particular point needs to be taught. We instinctively know why we ask a question: whether it is to teach or to test something. At this stage it is strongly recommended to involve learners in task-based and project-based learning in order to develop respect for peers and their work, collaborative attitude amongst teams, and responsibility for the overall team success.

Some major reasons for testing are:

- To diagnose learners level on arrival in this grade;
- To measure their progress;
- To find out how much pupils have learned;
- To find out how many of the class have learned what they were supposed to learn and then plan remedial work for the pupils who lag behind
- To motivate pupils for learning;

There are different kinds of tests, such as: diagnostic tests, proficiency tests, achievement tests, placement tests

We see evaluation as wider than just simply testing. Testing may be a successful tool in evaluation, but we also think there are other criteria for assessing pupil's performance.

Evaluation is not limited to numbers or just giving learners marks. Instead of trying to count or measure learner's ability to make useful contribution to the class, we can simply judge whether s/he makes a contribution or not, and sometimes we will have to justify, negotiate, and possibly modify our opinions.

With the evaluation we are trying to help the learner to learn, so it is not an assessment, in fact it is aid to learning. In other words, we can use assessment procedure to develop and improve, not only the learner, but also the teaching programme and even the school.

## **Guidelines for teaching materials, tools and resources**

In order to achieve the targeted aims and learning outcomes, and cover the topical content of the grade seven syllabus teachers should select teaching materials from course book(s) of elementary level. These materials and aids should primarily be age-appropriate, which means that they should be dedicated to children.

Apart from this, teachers are encouraged to use supplementary materials to suit the learners' needs, that is, their background knowledge their interests, and motivation. Supplementary materials (video tapes, documentary films, drama activities, projects, contests and quizzes, and

similar), may be used either within regular English classes, or within additional activities planned by the school curriculum (choice subjects, extra-curricular activities, and similar).

### **Suggested online resources (For teachers)**

<https://www.edutopia.org/blog/middle-school-resources-elena-aguilar>  
<https://www.youtube.com/channel/UCzuOCMm4bYELiv-DZAqfm4g>  
<https://americanenglish.state.gov/resources-0>  
<https://www.ereadingworksheets.com/browse-worksheets-by-grade-level/>  
<https://www.teachingenglish.org.uk/teaching-teens>  
<https://americanenglish.state.gov/search/solr?f%5B0%5D=bundle%3Aresource>  
<https://busyteacher.org/atoz/>  
<https://lyricstraining.com/>  
<https://www.eslkidstuff.com/>  
<http://www.englishforeveryone.org/>  
<http://www.eslcafe.com/quiz/>  
[http://www.dmoz.org/Kids and Teens/School Time/English/English as a Second Language/](http://www.dmoz.org/Kids_and_Teens/School_Time/English/English_as_a_Second_Language/)  
<http://www.manythings.org/vocabulary/games/l/words.php?f=body-1>  
<http://www.englishclub.com/esl-quizzes/>  
<http://www.cdlponline.org/index.cfm?fuseaction=stories&topicID=1>  
<http://iteslj.org/ESL.html>  
<http://www.manythings.org/>  
<http://a4esl.org/>  
<http://www.english-at-home.com/>  
<http://www.learningchocolate.com/>  
<http://www.bbc.co.uk/worldservice/learningenglish>  
<http://www.britishcouncil.org/learnenglish>  
<http://www.esl-lab.com>

### **Media**

[www.cnn.com](http://www.cnn.com)  
[www.bbc.co.uk/](http://www.bbc.co.uk/)  
[BBC English Radio.](http://www.bbc.co.uk/1/mediacentre/2014/01/bbc-english-radio.shtml)  
[BBC World Service.](http://www.bbc.co.uk/1/mediacentre/2014/01/bbc-world-service.shtml)  
<http://www.mirror.co.uk>

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Gjuhë gjermane**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Njohja e gjuhëve të huaja krijon hapësirë dhe liri më të madhe të lëvizjes e me këtë edhe vetëbesim dhe është një ndër kushtet kryesore të kualifikimit për tregun botëror të punës, njëkohësisht është edhe kusht paraprak për njohjen me kulturat e tjera.

Duke qenë se gjuha gjermane është gjuhë, e cila flitet më së shumti brenda Bashkimit Evropian, atëherë mësimi i saj është shumë i rëndësishëm për kohën në të cilën jetojmë.

Poashtu, për shkak të migrameve të shumta në vendet gjermanofolëse, në një mënyrë janë krijuar edhe lidhjet me gjuhën dhe kulturën gjermane. Kjo ka krijuar dhe ka rritur nevojën për kualifikime të ndryshme të nxënësve të shkollave tona dhe mësimin e gjuhës gjermane.

Poashtu mundësia e përgatitjes profesionale e të rinjve tanë në vendet gjermanofolëse është dukshëm më e madhe se sa në vendet tjera. Arsyet tashmë dihen.

Të gjitha këto janë arsye që mësimdhënia moderne e gjuhëve të huaja duhet t'u ofrojë të rinjve shkathtësitë dhe njohuritë e duhura për një botë shumëgjuhëshe, të cilat ua bëjnë të mundur atyre të jenë të aftë të veprojnë edhe jashtë kufijve të gjuhës së tyre amtare.

Gjuha Gjermane në klasën e 7-të mësohet me një orë në javë. Me këtë numër të orëve duhet të arrihet niveli A1/1 (pjesa e dytë e leksioneve), sipas “Kornizës programore për gjuhën gjermane si gjuhë e huaj” e Konferencës së Ministrisë Gjermane të Kulturës, e cila përsëri orientohet në Kornizën e Rekomanduar Evropiane të Gjuhëve të Huaja.

## Qëllimet

Qëllimet kryesore të mësimdhënies së gjuhës gjermane në klasën e shtatë janë:

- Të zhvillohen katër shkathtësitë gjuhësore;
- të aftësohen nxënësit për t'u marrë vesh në situata të thjeshta gjuhësore, brenda dhe jashtë shkollës, me njerëz që i përkasin kulturës dhe gjuhës gjermane;
- të aftësohen nxënësit të krahasojnë kulturën gjermane me kulturën dhe traditën vetjake, si dhe të shfrytëzojnë këto pikëpamje në profilet arsimore të zgjedhura nga ata;
- të aftësohen nxënësit të shfrytëzojnë strukturat dhe rregullsitë e gjuhës gjermane për përdorimin më të vetëdijshëm të gjuhës amtare;
- të aftësohen që t'i zhvillojnë në mënyrë të pavarur njohuritë e fituara në gjuhën gjermane për t'i aplikuar ato në profesionet e tyre të ardhshme.
- Të mësuarit e gjuhës gjermane në Kosovë është ndihmë edhe e përgatitjes së e nxënësve për të kryer provimet e njohura ndërkombtarisht të gjuhës gjermane, të cilat i organizon kryesisht Instituti Göte. Këto provime ju shërbejnë nxënësve dhe studentëve në të ardhmen për të studiuar, punuar në vendet gjermanofolëse e gjetiu, ku flitet gjuha gjermane.

## Shkathtësitë e komunikimit

- Shkathtësitë receptive: Të dëgjuarit dhe të lexuarit
- Shkathtësitë produktive: Të folurit dhe të shkruarit



## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
Sistemi i gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shtetet / vendet</li> <li>• Lëndët mësimore</li> <li>• Takimet</li> <li>• Personazhet e preferuara të serialeve</li> <li>• Të dhënat e kohës/ Takimet</li> <li>• Aktivitetet e lira</li> <li>• Familja</li> <li>• Profesionet</li> <li>• Blerjet</li> <li>• Numrat deri 100</li> <li>• Ushqimet/pijet</li> <li>• Përshkrimi i një dite</li> </ul>	<p><b>TË DËGJUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- I kupton përshëndetjet themelore si dhe shprehjet e zakonshme të formës së mirësjelljes (si psh. tungjatjeta, mirupafshim, më vjen keq etj).</li> <li>- I kupton informacionet e thjeshta dhe pyetjet rreth vetes, familjes, shkollës, gjërave konkrete, poqëse biseda zhvillohet shumë ngadalë, rrjedhshëm, kur i flitet shumë ngadalë dhe me kujdes, i përsëriten fjalitë disa herë, kur bëhet pauzë më e gjatë të folurit dhe bashkëbiseduesi është i gatshëm t'i ndihmojë ta plotësojë mendimin, sidomos nëse mbështeten përmes gjesteve apo nga ana vizuale.</li> <li>- Kupton përshëndetjet, format e mirësjelljes, format e falënderimeve dhe kërkimfaljeve</li> <li>- Pyet apo emërton diçka, përshkruan, tregon çka i pëlqen e çka nuk i pëlqen duke e përdorur mohoren etj.</li> <li>- Kupton shprehjet e thjeshta lidhur me udhëzimet në klasë si dhe kur shoqërohen me anë të gjesteve.</li> <li>- Gjatë bisedës përdor saktë foljet e rregullta dhe ato të ndashme në kohën e tashme, të njohura nga teksti mësimor, foljet modale etj.</li> <li>- Përdor përemrat vetorë e pronorë, parafjalët e thjeshta dhe kallëzoren.</li> </ul>
		<p><b>TË LEXUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Lexon dhe kupton fjali dhe shprehje të thjeshta në një tekst.</li> <li>- Lexon dhe kupton tekstet nga libri shkollor dhe të ngjashme</li> <li>- Njeh dhe kupton fjalët nga reklamata televizive apo në revista të thjeshta.</li> <li>- Kupton fjali të thjeshta, poqëse janë të shoqëruara edhe me fotografi.</li> <li>- Kupton informatat kryesore në një tekst të shkruar thjeshtë e që ka lidhje me interesat e tij.</li> </ul>

		<p><b>TË FOLURIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Flet për planin javor, pastaj orën mësimore.</li> <li>- Jep mendimin e vet për çështjet që diskutohen në mësim.</li> <li>- Shpreh një dëshirë.</li> <li>- Bën një propozim, pranon apo refuzon atë.</li> <li>- Flet për familjen, profesionin.</li> <li>- Përshkruan dikë, përshkruan një ditë të zakonshme.</li> <li>- Përdor përshëndetjet themelore si dhe shprehjet e zakonshme të formës së mirësjelljes (si p.sh. tungjatjeta, më vjen keq etj.).</li> <li>- Përdorë fjali shumë të shkurtëra e të njohura, duke bërë shumë pauza që të gjejë shprehjen e duhur.</li> <li>- Jep informacione të thjeshta personale për vetëvetën dhe të tjerët.</li> <li>- Përshkruan vendin ku banon.</li> <li>- Përgjigjet pozitivisht apo negativisht në pyetje të thjeshta për tema të caktuara të thjeshta.</li> <li>- Tregon për ushqimet e preferuara.</li> <li>- Tregon për çmimet dhe për kohën(orën).</li> </ul> <p><b>TË SHKRUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan fjalë e tekste të shkurtëra.</li> <li>- Plotëson fjalë e pjesë fjalishë në tekstet me zbrazëtira.</li> <li>- Shkruan fjalë dhe fjali të shkurta të njohura nga teksti mësimor.</li> <li>- Shkruan të dhënat elementare për një person të marra nga një listë dhe i bartë ato në një formular.</li> <li>- Shkruan të dhënat elementare për një person të marra nga një listë dhe i bartë ato në një formular.</li> <li>- Shkruan shënime të shkurta si psh. : emrin, fjalën, kohën, datën etj.</li> <li>- Shkruan çmimet, emrat, takimet, numrat (veçanërisht pasi të jenë germëzuar).</li> </ul>
--	--	--

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Gjuha, e cila pikësëpari shërben si mjet komunikimi, nuk mësohet vetëm në orët e gjuhës, por në një formë a në një tjetër tek të gjitha lëndët mësimore, përderisa në to aftësitë, pikëpamjet e ndryshme e njohuritë zhvillohen përmes rrugëve gjuhësore.

Për atë që sa gjuha ndihmon tek lëndet e tjera, atë mund të ndihmojnë lëndët tjera për arritjen e objektivave brenda mëimit të gjuhës gjermane. Parasegjithash, edhe temat e zgjedhura kanë të bëjnë me shumë fusha të jetës e me këtë edhe me shumë lëndë mësimore, njohuritë e të cilave na ndihmojnë në mësimin e gjuhës gjermane.

Natyrisht se gjuha para së gjithash është e ndërlidhur me artet sepse çdo fjalë a nocion i ri mund (duhet) të shpjegohet përmes këngës, vizatimit, fotografisë a lojës (qoftë te fëmijët (niveli II) apo te të rinjtë (niveli III)).

Edhe njohuritë nga shkencat, qoftë natyrore apo shoqërore duhet t'i shfrytëzojmë gjatë trajtimit të temave të ndryshme të parapara për klasën e shtatë.

Këto njohuri shfrytëzohen sidomos në fazën e parë të orës (rikuajtimi), ku varësisht nga temat që do të trajtojmë, përdorim njohuritë nga lëndët tjera (nxënësit i parapërgadisim për temën).

Të ndërlidhura më shkencat shoqërore e që vetëdijësojnë nxënësit për çështje të shumta jetësore si dhe u ndihmojnë të arrijnë shkathtësitë e duhura jetësore e komunikative, janë temat e shumta në klasën e shtatë (sidomos me edukatën qytetare). Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe temave të ndjeshme, siç është tema e barazisë gjinore.

Ndërlidhja ekziston edhe me shkencat natyrore, sidomos të potencuara janë ato që kanë të bëjnë me ambientin, ruajtjen e tij, shëndetin, ushqimin, etj.

## **Udhëzime metodologjike**

Në një mësimdhënie bashkëkohore komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Cilat mjete gjuhësore u duhen nxënësve që në situata të caktuara gjuhësore të shprehën dhe të sillen në mënyrë të duhur? Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja për një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo e kundërta.

Tri gjetjet e psikologjisë së të mësuarit dhe neurodidaktikës veçanërisht të rëndësishme për mësimin e gjuhës janë:

1. Interesi dhe emocionet zgjohen më së miri përmes tregimeve.
2. Kujtesa jonë punon me imazhe.
3. Të forcohen përsëritjet dhe motivimi.

Njeriu mëson me të gjitha shqisat. Për këtë arsye, materiali mësimor duhet të jipet nëpërmjet kanaleve të shumta dhe të lidhura në mënyrë optimale së bashku. Ky lloj i prezantimit e mbanë më gjatë vëmendjen e zgjuar.

Forma të ndryshme të të mësuarit përmes këngëve, përmes lojërave të ndryshme krijojnë një rrjet të përkryer; një rrjet që ka në shënjestër rritjen e suksesit të të mësuarit të gjuhës.

### **Rradhitje e qartë e rrafsheve gjuhësore**

Është e nevojshme, posaqërisht në nivelin fillestar të mësimdhënies, që t'u jepet një theks i veçantë rrafsheve të ndryshme gjuhësore, si: përpunimit të vokabularit (fjalorit), përpunimit të teksteve dhe strukturave gjuhësore. Kjo do të thotë se duhet të caktohen prioritetet brenda një njësie mësimore; nuk mundet njëkohësisht që të zhvillohet edhe vokabulari i ri, e edhe strukturë e re gjuhësore. Mënyra më e drejtë do të ishte, sëpari të përpunohet vokabulari, i cili paraqitet në leksionet e caktuara. Pastaj, vokabulari i përpunuar të futet në struktura të reja sintaktike.

Mësuesi, brenda mësimdhënies komunikative, përzgjedhë situata të tilla gjuhësore, të cilat janë të afërta me përditshmërinë, ashtu që, strukturat e ushtruara të jenë natyrale e jo artificiale.

### **Realizimi i një ore përmes objektivave**

Përcaktimi i qartë i objektivave është lehtësim për punën e mësuesit dhe e ndihmon atë vet në përcaktimin e objektivave më specifike. Kur të arrihet objektivi - kjo do të thotë se nxënësit e zotërojnë materien e përpunuar- atëherë mësimdhënësi do të duhej të jetë i kënaqur me këtë. Nëse ende nuk ka përfunduar ora mësimore nuk ka logjikë që të futen edhe përmbajtje të reja në orë. Në këtë rast më e logjikshme do të ishte që të përforcohet ajo që është mësuar me anë të ushtrimeve të llojllojshme, të përpunohet një këngë gjatë orës së mësimimit ose të futet ndonjë lojë mësimore më qëllim të arritjes së objektivit.

Gjithashtu është e rëndësishme që në fazën e “e njoftimit me temën e re” (Sprachbegegnung)” të hyhet mundësisht shpejtë në thelb të “problemit” me një motivim me të cilin arrihet objektivi dhe jo të shkohet rrugëve anësore, të cilat do krijojnë te nxënësit hutë, lidhur me atë se çka në të vërtetë mund të jetë qëllimi i orës mësimore.

### **Përcaktimi i saktë i objektivave**

Duke i njohur nxënësit dhe duke i pasur të qarta objektivat e përcaktuara më parë mësuesi nuk do të duhej të bëjë gabim e të përcaktojë shumë objektiva për një orë mësimi e të habitet pastaj pse nuk është arritur objektivi. Për këtë arsye mësuesi duhet të caktojë një objektivi specifik, të cilin tenton ta arrijë brenda një ore mësimi. Përcaktimi i shumë objektivave për një orë ka për pasojë këtë: mbetet pak kohë për ushtrime dhe zbatim, për këtë arsye nxënësit nuk mund ta bëjnë zotërimin e mjaftueshëm të materies. Në orën e ardhshme duhet të përsëritet dhe sqarohet materia edhe një herë, sepse mund të ndodhë që të jenë përvjedhur gabime, të cilat pastaj me mund mund të korrigjohen, arsye kjo për t'u dëshpruar arsimtari dhe nxënësi. Llogaria është e thjeshtë: një orë e stërngarkuar dhe një orë për përsëritje bëjnë dy. Në këtë rast do të ishte më e logjikshme që materia qysh nga fillimi të ndahet në dy orë. Sipas hulumtimeve nxënësit mesatarë janë në gjendje që, për një orë mësimi të mbajnë mend rreth dhjetë shprehje të reja. Ky fakt nuk duhet të lihet anash.

## **Radhitja: të dëgjuarit/ të kuptuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit**

Posaçërisht në mësimin fillestar do të duhej të ruhet radha e katër shkathtësive, që d.m.th.:

- Nxënësit nuk do të duhej të flasin asgjë që nuk e kanë dëgjuar më parë.
- Ata nuk do të duhej të lexojnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar dhe folur më parë.
- Ata nuk do të duhej të shkruajnë asgjë që nuk e kanë dëgjuar, folur dhe lexuar më parë.

Për t'iu përmbajtur kësaj radhitjeje posaçërisht te fillestarët, flasin këto arsye:

- Nëse flitet një fjalë e re, logjikisht ajo do të duhej të dëgjohej më parë. Në anën tjetër leximi i një fjale të re është më i lehtë kur ajo më parë është dëgjuar ose folur. Edhe të shkruarit do të duhej të ishte më i lehtë, kur ajo fjalë është dëgjuar, folur apo lexuar më parë.

-Grafemat e gjermanishtës dhe të shqipes nuk përputhen në çdo rast. Pasi që nxënësit janë mësuar me alfabetin e gjuhës shqipe, mund të paraqitet “përgjithësimi” ose interferenca, nëse fillohet herët me shkrimin në gjuhën gjermane. E mu kjo mund të shmanget nëse mësimi fillon me të dëgjuarit dhe pastaj lëvizë mbi stacionet e të folurit dhe të lexuarit në drejtim të shkruarit.

### **Puna aktive dhe konkrete**

Një dallim në mes të mësimin të gjuhës gjermane në Gjermani, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjermanishten si gjuhë amtare ose për gjermanishten si gjuhë e dytë ose e huaj dhe në Kosovë është ndër tjera se mjedisi kosovar mund të japë pak ose aspak informacione për Gjermaninë dhe përveç orës së mësimin pothuajse nuk ka ndonjë mundësi për t'iu zbatuar ajo që është mësuar. Kështu që bie mundësia që ajo që është mësuar në shkollë të thellohet jashtë orëve të mësimin si përmes ekskursioneve, zhvillimit të intervistave etj. Në këtë kontekst nuk duhet mbiçmuar apo nënçmuar televizionin.

Prodhimi (krijimi) i pllakatave, mozaiqeve dhe posterëve, prodhimi i punëdoreve të vogla janë gjithashtu të rëndësishme.

Një arsye tjetër për aktivitete të këtilla, janë njohuritë nga psikologjia e të mësuarit: sipas saj rezultati (arritja) është më i madh, sa më shumë që të mbështeten veprimet gjuhësore nga veprimet konkrete.

### **Kohë e mjaftueshme për ushtrime dhe zbatim**

Për nxënien dhe zotërimin e sigurtë të një gjuhë nevojiten në përgjithësi tri gjëra: kohë, kohë dhe prapë kohë.

Ne e dimë se ekzistojnë 3 tipa të ndryshëm të nxënësve:

**Tipat akustik** : ata e nxënë- mësojnë gjuhën më shpejt përmes dëgjimit- veshit;

**Tipat vizuel**- pamor: ata e nxënë gjuhën në radhë të parë përmes syrit;

**Tipat motorik** -ata nxënë gjuhën më së shpejti përmes të shkruarit.

Për këtë arsye është e rëndësishme, që ushtrimi të zgjedhet gjithashtu edhe përmes këtij këndvështrimi; që gjuha të mësohet njëkohësisht përmes kanaleve të shumta, pasi që te shumica e atyre që mësojnë gjuhën bëhet fjalë për tipa të ashtuquajtur të përzier.

### **Llojlojshmëria në fazat e ushtrimeve**

Secili mësues dhe mësuese e di saktësisht se në orën e gjuhës, të ushtruarit monoton të strukturës së fjalisë ka më shumë ndikim negativ sesa që e arrihet ajo është synuar.

Nxënësit do ta humbin interesimin për mësim dhe nuk do të marrin pjesë aktivisht në të. Në anën tjetër, ne e dimë se motivimi i synuar dhe dhënia e detyrave interesante mund ta ngrisin dëshirën për mësim dhe gatishmërinë për punë (rezultate).

Ndërrimi i formave të punës (puna e veçantë, puna në çifte ose në grupe) është shumë më frytëdhënëse, por edhe lojërat në mësim, këngët dhe poezitë si dhe tregimet duhet të bëhen pjesë përbërëse të mësimin.

### **Korrigjimi i shprehjeve të nxënësve**

Pothuajse asnjë çështje nuk diskutohet aq shpesh dhe në mënyrë kundërtënëse në rrethin e mësimit se sa mënyra e korrigjimit.

Derisa korrigjimin disa e vështrojnë si pengesë të rrjedhjes gjuhësore, të tjerët mbështeten në atë se gabimet duhet korrigjohen menjëherë që të mos përvidhen.

Ndoshta mund të bëhet një kompromis i arsyeshëm gjatë korrigjimit dhe ai do të dukej kështu:

- Në fazën e kontaktit të parë me temën e re, si për shembull përmes një fotografie, mësueset dhe mësuesit presin një të shprehur të lirë të nxënësve të tyre.

Po të bëjnë korrigjimin masiv gjatë kësaj faze të mësimin, nxënësit ndoshta do të tërhiqeshin menjëherë dhe në fund do të heshtin plotësisht.

Në këtë fazë është e drejtë që përmirësimet ndër të tjera të parashtrihen në atë mënyrë, për shembull, një fjalë e thënë gabimisht të përsëritet nga mësuesi edhe një herë, por natyrisht në mënyrë të drejtë.

- Situata në fazën e zbatimit dhe të ushtrimit është tjetër. Këtu bëhet fjalë për ushtrimin e vokabularit dhe të strukturave dhe këtu korrigjimi natyrisht është i pakushtëzueshëm.

S'ka diskutim se nxënësit nuk bënë t'i turpërojmë para klasës, por të tregojmë takt pedagogjik.

### **Diferencimi**

Ndodh shpesh që rezultatet e ndryshme gjuhësore të nxënësve në mësim të paraqesin pjesërisht vështirësi të mëdha. Derisa një nxënës ta ketë kryer tanimë detyrën e tij, të mërzhitet në mësim apo të pengojë të tjerët duke kryer detyrat, tjetri nuk është ende gati edhe pse ka mjaft kohë në dispozicion.

Për mësueset dhe mësuesit ekzistojnë këtu dy mundësi: të bëjnë kinse nuk ka dallime në rezultate, por atëherë do të duhej që të merrej parasysh edhe ajo që herët apo vonë do të paraqiten vështirësitë nga ngarkesat (kërkesat tona) e vogla, gjegjësisht të mëdha.

Mundësia tjetër mbështetet në praktikimin e masave të diferencimit të brendshëm e kjo pa dyshim për nxënësen/sin do të thotë të punojë.

Dallohen forma të ndryshme të diferencimit, të cilat nuk do të diskutohen këtu sepse ato tanimë janë të njohura.

Vetëm dy forma duhet të shikohen më për së afërmi:

Diferencimi kuantitativ dhe kualitativ

*-Diferencimi kuantitativ* do të thotë, se detyrat dallohen në kuantitetin e tyre, pra në sasinë e tyre. Kjo s' do të thotë asgjë tjetër, veçse nxënësit "e shpejtë" marrin detyra plotësuese. Masa zbatohet lehtë, sepse mësueset dhe mësuesit duhet vetëm që të mendojnë detyra shtesë, të cilat pastaj në se është nevoja ia japin disa nxënësve. Ky lloj i diferencimit megjithatë i ka edhe të metat e tij, sepse me an të detyrave shtesë prej nxënësve kërkohet edhe më shumë e në këtë mënyrë bëhen gjithnjë e më të mirë. Me fjalë tjera: dallimi në mes të të mirëve dhe më pak të mirëve bëhet gjithnjë më i madh. Gjithashtu shtrohet pyetja, mos ndoshta nxënësit më të vjetër i shohin këto detyra shtesë si një lloj dënimi për atë që kanë punuar më shpejtë.

*-Diferencimi kualitativ* shtron më shumë kërkesa. Me këtë rast jipen detyra me shkallë të ndryshme vështirësie, pa e lënë ansh temën e përbashkët. Të nisemi prej asaj, që brenda një klase kemi të bëjmë me tri grupe të ndryshme të rezultateve A, B, dhe C, ku me grupin A nënkuptojmë grupin me arritje më të larta, me grupin B grupin me arritje të mesme dhe me grupin C grupin me arritje më të dobëta.

Skema e rrjedhës së një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

<b>Sprachbegegnung - Kontakti i parë me temën e re (Evokimi)</b> e përbashkët për të gjithë nxënësit		
<b>Spracherarbeitung - Përpunimi i temës (Realizimi)</b> e përbashkët për të gjithë nxënësit		
<b>Sprachübung - Ushtrimet rreth temës (Reflektimi)</b> diferencimi i grupeve sipas shkallës së arritshmërisë, p.sh.		
Grupi A Përpunimi i tërë tekstit. Detyra kreative shtesë	Grupi B Përpunimi i tërë tekstit me ndihmesë, psh. Artikelhilfe	Grupi C Përpunimi i një pjese të tekstit me ndihmesë, p.sh. Artikelhilfe.

Shpesh dëgjohet edhe një argument që flet kundër kësaj forme të diferencimit e që është:

Tek kjo mënyrë e zhvillimit të mësimit nuk mësojnë të gjithë nxënësit të njëjtën gjë, sepse profili i kërkesave është i ndryshëm, në këtë rast treshkallësh.

- Një analizë e këtij argumenti tregon megjithatë shumë shpejtë, se kjo nuk mund të vlejë gjithmonë, sepse: nxënësit nuk e arrijnë parimisht kurrë njësoj shpejtë dhe mirë objektivin e orës mësimore.
- Ajo çka arrihet me anë të këtij procesi, është shmangia nga kërkesa e tepërt apo e paktë, sepse aftësitë e nxënësve për të nxënë janë të ndryshme pavarësisht nga ajo se a praktikohen masat e diferencimit apo jo.

## Ndarja e një ore mësimore

Rrjedha e një ore mësimore do të mund të dukej kështu:

<b>Artikulationsstufen</b>	<b>Methodische Absichten</b>
<b>1. Sprachbegegnung</b>	Begegnung mit der neuen Sprachsituation, z.B. durch Bild, Tonaufnahme, Filmausschnitt, Lehrer- oder Schülervortrag.
<b>2. Spracherarbeitung</b>	Bereitstellen und Erarbeiten von neuem Wortschatz oder neuen Strukturen.
<b>3. Sprachübung</b>	Übungsbeispiele, möglichst in Form von realen Sprech-handlungen. Aufgreifen und Wiederholen von bekanntem Wortschatz mit neuen Strukturen und umgekehrt. Differenzierungsmaßnahmen Sprachlernspiele
<b>4. Sprachanwendung</b>	Übertragen des Gelernten auf neue Situationen: Im Klassenzimmer Im außerschulischen Bereich

## Udhëzime për vlerësim

Një ndër çështjet kryesore dhe shumë të rëndësishme në mësimdhënien dhe mësimnxënien e një gjuhe të huaj është vlerësimi. Ai duhet të bëhet në vazhdimësi përmes korigjimit, pyetjeve dhe testimit.

Vlerësimi bëhet për secilën shkathtësi gjuhësore, si ato receptive, poashtu edhe ato produktive. Vlerësimi fillon qysh në fillim të mësimdhënies me qëllim verifikimi të pengesave eventuale që u dalin nxënësve, pastaj në çfarë mase nxënësit i arrijnë objektivat e përcaktuara.

### Mësimdhënësi në vazhdimësi duhet të vlerësojë:

- Njohuritë që kanë fituar nxënësit: në ç'skallë kanë zotëruar nxënësit fjalorin dhe sa është i aftë nxënësi t'i përdorë shkathtësitë gjuhësore.
- Pengesat e nxënësve: vlerësohet shkalla e zotërimit të njohurive me qëllim të eliminimit të pengesave dhe të ndihmës së nxënësve për eliminimin e vështirësive
- Integrimin e njohurive të fituara: vlerësohen aktivitetet apo projektet e ndryshme që nxënësit realizojnë jashtë programit shkollor dhe integrimin e këtyre njohurive në situata brenda shkollës

Gjatë procesit mësimor rëndësi të veçantë do të kenë mënyrat e ndryshme të vlerësimit si:

- Vlerësimi nga mësimdhënësi; vlerësimi i drejtëpërdrejtë dhe pandërprerë, përcjellja e vazhdueshme e rezultateve të nxënësve si dhe vlerësimi indirekt me anë të testeve
- Vlerësimi nga nxënësi; gjatë punës në grupe ose gjatë përgjigjeve që japin, nxënësit mund ta plotësojnë njëri-tjetrin dhe njëkohësisht vlerësojnë mbi bazën e argumenteve



- Vetëvlerësimi; vlerësimi i vetë nxënësi

### Mundësitë praktike

Mësuesi i ka të lira disa mundësi për vlerësim. Mësuesi parase të bëjë vlerësimin duhet të mendojë se çfarë forme të vlerësimit do të zbatohet, sepse nuk është secila mënyrë e vlerësimit njësoj e përshtatshme për verifikimin e njohurive të nxënësit.

Në përgjithësi janë tri fusha të mëdha veprimesh (aftësishë), të cilat vlerësohen:

1. Riprodhimi(reprodukimi)- nënkupton riprodhimin nga nxënësi e asaj që është mësuar më parë.
2. Riorganizimi- nënkupton bartjen e të mësuarës në situata të ngjashme( p.sh. nëse nxënësit i mësohet vendi i foljes në fjali të varur, duhet të jetë i aftë të aplikojë foljen në fjali tjera të varura).
3. Transferi- nënkupton bartjen e të së mësuarës, në situata plotësisht të reja.

Kryesisht i njohim tri sfera të mëdha tek vlerësimi:

1. Mënyra e të vlerësuarit me shkrim: prej nxënësit pritet një përgjigje me shkrim.
2. Mënyra e të vlerësuarit oral: prej nxënësit pritet një përgjigje me gojë.
3. Mënyra e të vlerësuarit të veprimeve: prej nxënësit pritet një veprim aktiv, p.sh. tek ushtrimet ku kërkohet radhitja.

Në vijim do të paraqiten vetëm mënyrat e të vlerësuarit me shkrim. Ato janë mënyra më objektive dhe zbatohen më së shpeshti në shkollë.

### Përgjigjet seleksionuese

Siç tregon edhe vetë emri, nxënësi gjatë përgjigjes në një pyetjeje ka mundësinë e zgjedhjes (të zgjedhë tek përgjigjet e shumta të dhëna) në mes të të saktës dhe të pasaktës. Edhe këtu ka mundësi të ndryshme.

- **Përgjigjet alternative**

Nxënësit i ipen dy mundësi të përgjigjes. Ai duhet të identifikojë një përgjigje si të saktë dhe të shenjojë atë.

Shembull: rretho përgjigjen e saktë!

Berlin ist die Hauptstadt von BRD.	richtig <input type="radio"/>
	falsch <input type="radio"/>

Fjalja e dhënë është e formuluar qartë.

Duke supozuar, se nxënësi i kupton të gjitha nocionet, fjalia do të rrethohet si e saktë. Përparësia e përgjigjeve alternative është e qartë: ato formulohen, zbatohen dhe vlerësohen shpejtë dhe lehtë.

Të metat janë të dukshme: mundësia që të qëllohet zgjidhja e drejtë është 50%, sepse vetëm njëra nga zgjidhjet është e saktë.

- **Përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes**

Përkundër përgjigjeve alternative, përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes i japin nxënësit më shumë mundësi për zgjedhje, prej të cilave ai duhet të gjejë të saktën.

**Shembull:** rretho përgjigjen saktë!

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter der Straße.
	<input type="radio"/> über der Straße.
	<input type="radio"/> in der Straße.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Nxënësi, që të mund ta rrethojë zgjidhjen e saktë, duhet t'i njohë parafjalët e përdorura në shembull. Ai duhet t'i dallojë dhe t'i krahasojë. Në krahasim me përgjigjet alternative, mundësia që të qëllohet përgjigjja e saktë bie; tek ky shembull është 25%.

Tek përgjigjet me mundësi të shumta të zgjedhjes duhet të kihen pararsysh disa pikë: shtruarja e pyetjeve dhe përgjigjet duhet të kenë një lidhje logjike.

**Shembull:** rretho përgjigjen saktë!

Die Fliege	<input type="radio"/> fliegt auf den Kopf	des Vaters.
	<input type="radio"/> landet auf dem Kopf	
	<input type="radio"/> schwebt auf den Kopf	
	<input type="radio"/> befindet sich auf dem Kopf	

Në këtë rast nxënësi mund të ketë probleme gjatë të rrethuarit të zgjidhjes së saktë. Ndoshta edhe ndonjë gjermanofolës nuk do të mund të dinte se cila zgjidhje do të ishte më e mira, sepse tek mundësitë e dhëna, bëhet fjalë para së gjithash për një çështje, stili gjuhësor.

Përgjigjet e pasakta që janë dhënë afër përgjigjeve të sakta, duhet të kenë një lidhje të arsyeshme me pyetjen. Nëse nuk është ashtu, atëherë detyra me mundësi të shumta të zgjedhjes në këto rrethana do të shndërrohet në detyrë me përgjigje alternative. Kjo ndodh nëse nxënësit, në shikim të parë, zgjidhjet e pasakta i duken si përgjigje alternative.

**Shembull** : rretho përgjigjen e saktë !

Das Auto steht	<input type="radio"/> unter dem Wasser.
	<input type="radio"/> über der Mauer.
	<input type="radio"/> in der Blume.
	<input type="radio"/> auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi tri zgjidhjet e para do t'i heq menjëherë, si të pasakta. Nga përgjigjja me mundësi të shumta të zgjedhjes nuk do të mbetet asgjë. Ndërtimi dhe formulimi nuk guxon t'ia lehtësojë nxënësit zgjidhjen.

Das Auto	<input type="radio"/> stehst unter der Straßen.
	<input type="radio"/> stehen über der Straßen.
	<input type="radio"/> steht auf der Straße.

Në këtë rast nxënësi do të mund të zgjedhë mundësinë e tretë shumë shpejtë si të vetmen të saktë, sepse vetëm tek kjo mundësi kallëzuesi në njëjës përputhet me kundrinën e cila gjithashtu qëndron në njëjës.

### **Përgjigjet rregulluese**

Karakteristikë e përgjigjeve rregulluese është se nxënësi duhet të rregullojë një sistem të dhënë. Këtu ekzistojnë dy mundësi :ajo e klasifikimit dhe e radhitjes.

- **Përgjigjet klasifikuese**

Nxënësit i jipen dy grupe fjalësh apo fjalishë. Ata kanë për detyrë që një pjesë të grupit të parë t'i shtohet pjesa përkatëse e grupit të dytë.

**Shembull** : Klasifiko !

1. Peter	a) Griechenland
2. Armend	b) Deutschland
3. Giuseppe	c) Spanien
	d) Kosova
	e) Türkei
	f) Italien

**Shembull:** Çka përshtatet? Klasifiko !

1. die Schule	a) der Lehrer	d) das Geld	g) der Sandkasten
2. der Spielplatz	b) die Arbeit	e) die Maschine	h) der Schüler
3. die Fabrik	c) die Rutsche	f) das Tor	i) der Meister

Përgjigjet klasifikuese kanë përparësi, sepse mësuesi mundet shumë mirë të vërtetojë, se a e ka kuptuar nxënësi logjikisht një problem.

• **Përgjigjet radhitëse**

Detyrë e nxënësit është t'i vë në radhë të duhur fjalitë, shkronjat dhe fjalët.

**Shembull:**

Vëri fjalitë në radhën e duhur !

- |  |
|--|
| <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Es ist acht Uhr.</li> <li>2. Liridon geht bei Rot über die Kreuzung.</li> <li>3. Der Wecker klingelt.</li> <li>4. Liridon kommt zu spät zur Schule.</li> <li>5. Liridon hat verschlafen.</li> <li>6. Der Autofahrer bremst scharf.</li> <li>7. Er springt aus dem Bett.</li> <li>8. Der Fahrer schimpft Liridon.</li> <li>9. Er läuft schnell Weiter.</li> </ol> |
|--|

Zgjidhjen e drejtë të kësaj detyre mund ta lehtësojë një rradhë fotografishë.

**Shembull:** Radhiti shkronjat!

schueRt	
hrreeL	
Seluch	
mbsret	

Edhe tek ky shembull mund të paraqiten fotografi për lehtësimin e gjetjes së zgjidhjes.

**Shembull:** Rradhiti shkronjat drejtë.

Der	bremst	Autofahrer	Scharf
a	B	c	D

**Shembull:**

Radhiti shkronjat drejt në kutitë e rendit të parë!

Shkruaj shkronjën e fjalës joadekuate në kuti!

a) Der b) bremst c) Autofahrer d) groß e) scharf

Në këtë shembull shihet problematika. Si të bëhet vlerësimi nëse dy nxënës vijnë me këto zgjidhje:

Nxënësi 1: *Der Autofahrer scharf bremst.*

Nxënësi 2: *Der Autofahrer bremst groß.*

Asnjëra nga dy zgjidhjet nuk është e saktë. Përderisa tek nxënësi 1. renditja e fjalëve është gabim, nxënësi 2. ka zgjedhur ndajfoljen e gabuar. A nuk merr asnjëri nxënës pikë? Apo, a mund të thuhet se njëra nga të dy zgjidhjet është “më e saktë”, kurse tjetra “ më pak e pasaktë”?

Nëse mësuesi dëshiron të testojë renditjen e drejtë të fjalëve në fjali: A mundet atëherë nxënësi 2 ta marrë njëren nga dy pikët e mundshme?

### 1.3. Përgjigjet e lira

Përgjigjja e lirë karakterizohet përmes asaj, që nxënësi duhet të reagojë në detyrën e dhënë të mësuesit, pa pasur mundësi zgjedhjeje.

#### Përgjigjet plotësuese

Përgjigjet plotësuese, të ashtuquajtura, përgjigje të shkurtëra, praktikohen shpesh në shkollë.

#### Shembuj:

Viele Dinge sind schneller, schöner usw. als andere. Setze die richtige Form ein.

(langsam)	Ein Fahrrad ist ... als ein Auto.
(schöer)	Fünf Kilo sind ... als ein Kilo.
(teuer)	Fleisch ist ... als Brot.

Trage das Gegenteil in die Lücke ein.

Dieses Buch ist spannend. Es ist nicht ...  
Elona ist groß. Sie ist nicht ...  
Latra ist ein Mädchen. Sie ist kein ...

Setze die richtige Zeit in die Lücke ein.

Heute Nachmittag ... (gehen) ich auf den Spielplatz.  
Morgen ... (spielen) ich Tennis.  
Gestern ... (sein) ich im Kino.

#### Përgjigjet e shkurtëra hartuese

Ky nocion mund të sjellë keqkuptime. Më këtë janë menduar përgjigjet e nxënësve sipas udhëzimit të mësuesit, të cilat paraprakisht nuk mund të vlerësohen qartë si të sakta apo të pasakta.

#### Shemull:

Formo një fjali prej këtyre dy fjalive!

Elira weint. Eine Wespe hat sie gestochen.

Te ky shembull nuk shfaqen probleme të mëdha gjatë vlerësimit. Më vështirë është te tregimet me fotografi, të cilat gjithashtu numërohen si përgjigje të shkurtëra hartuese. Për të gjithë nxënësit detyra është e njëjtë, sepse të gjithë i kanë në dispozicion fotografitë e njëjta. Megjithatë nuk mund të vlerësohet vetëm numri i informacioneve, sepse kriteret tjera luajnë një rol të rëndësishëm, psh. radhitja, zgjedhja e fjalëve, lidhjet etj. Këto e vështirësojnë një vlerësim objektiv.

## **Udhëzime për materialet didaktike dhe burimet e mjetet mësimore**

### **Literatura**

**Beste Freunde**, Stufe A 1.1 (gjysma e dytë e nivelit A1/1; leksionet 5-9), Kursbuch und Arbeitsbuch, Hueber, Ismaning

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Gjuhë frënge**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Gjuha frënge, si gjuhë e huaj e dytë, vazhdon të mësohet në klasën e 7-të të ShMU-së, me të njëjtin status, zakonisht me të njëjtin mësimdhënës, me të njëjtën metodë për mësimin e saj, dhe kryesisht, në të njëjtat kushte dhe rrethana të punës me ato në klasën paraprake, por tani me nxënës jofillestarë. Ata tashmë janë më të rritur, me kapacitete të rritura intelektuale, me një përvojë edhe në mësimin e një gjuhe të huaj të dytë dhe kanë përvetësuar një fjalor fillestar të gjuhës frënge, i cili do të zgjerohet dhe pasurohet në mënyrë progresive. Ky fjalor fillestar i nxënësve në këtë gjuhë të huaj, me kohë, do të pasurohet gradualisht edhe me një çasje ndërdisiplinare të mësimdhënies së kësaj lënde me lëndët e tjera mësimore. Ky synim mbështetet në krijimin e një atmosfere pozitive dhe garuese gjatë orës së mësimin dhe në identifikimin e mënyrave dhe strategjive të të mësuarit. Ajo do t'u shërbejë jo vetëm si mundësi komunikimi në këtë gjuhë të huaj në botë, por edhe si mundësi ndërtimi e karrierës, e punësimit, e studimeve etj. Nxënësit e kësaj klase do të përvetësojnë një fjalor më të zgjeruar të kësaj gjuhe të huaj, të domosdoshëm për komunikim; do të zhvillojnë më tutje shkathtësitë kryesore gjuhësore (të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit) dhe do të zhvillojnë kapacitetet intelektuale të tyre në këtë fushë.

## Qëllimet

Mësimi i gjuhës frënge në klasën e 7-të kërkon arritjen e njohurive gjuhësore sipas Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët (1/4 e nivelit A1), të përcaktuara në bazë të numrit të orëve mësimore në javë, të cilat janë të matshme nga institucione përkatëse të kësaj fushe; që përfshijnë përvetësimin e një fjalori më të zgjeruar të gjuhës frënge nga nxënësit dhe përdorimin elementar të tij për nevoja personale; njohjen dhe dallimin e formave të sistemit gjuhësor (fonetikë, morfologji, sintaksë); përforcimin e mëtejme të shkathtësive gjuhësore receptive (të dëgjuarit dhe të lexuarit) dhe shkathtësive produktive (të folurit dhe të shkruarit); rritjen e kapaciteteve intelektuale të tyre; konsolidimin dhe integrimin e njohurive; formimin e të menduarit kritik dhe krijues; njohje e mëtejme të një kulture të re, formimin e gjykimit të drejtë për botën; formimin e një personaliteti tolerues, respektues, bashkëpunues dhe human dhe formimin e një qytetari të dobishëm dhe të përgjegjshëm për shoqërinë.



## Temat dhe rezultatet e të nxënit

1 orë në javë, 37 orë në vit

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNLT)
<p>Tekste letrare dhe joletrare</p> <p>Pjesët skenike, teatri, drammatizimi, etj</p> <p>Sistemi i gjuhës</p>	<p><b>Shkëmbimi i informatave</b></p> <p><b>Ushqimi</b></p> <p><b>Pushimet</b></p> <p><b>Aktivitetet e përditshme</b></p> <p><b>Frankofonia</b></p>	<p><b>TË DËGJUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton përsëndetjet dhe dallon ato të formës formale dhe joformale. Kupton format e falenderimit dhe kërkimfaljet.</li> <li>• Kupton fjali të thjeshta dhe shprehje të izoluar rreth vetes.</li> <li>• Kupton biseda rreth vetes, familjes, shkollës, aktiviteteve të përditshme dhe gjërave konkrete, nëse njerëzit flasin ngadalë dhe rrjedhshëm.</li> <li>• Kupton informata të thjeshta rreth ushqimit.</li> </ul> <p><b>TË FOLURIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdor shprehje ose fjali të thjeshta për t'u prezantuar ose për të prezantuar të tjerët.</li> <li>• Përdor formën formale dhe joformale të të shprehurit, varësisht nga situata.</li> <li>• Di të porosisë kërkuj dhe porosisë ushqim.</li> <li>• Flet për veprimet e përditshme varësisht nga momenti i ditës.</li> <li>• Flet për shijet dhe preferencat.</li> <li>• Pyet dhe përgjigjet në pyetje, nëse bashkëbiseduesi flet ngadalë dhe qartë, dhe nëse është nevoja të riformulohen .</li> </ul> <p><b>TË LEXUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton fjalë dhe shprehje në një tekst të thjeshtë.</li> <li>• Kupton informatat kryesore në një ftesë, reklamë ose orar.</li> <li>• Kupton udhëzimet e shkurtëra dhe të thjeshta me ndihmën e ilustrimeve.</li> <li>• Kupton elementet kryesore në një meny.</li> <li>• Kupton informatat kryesore në një letër të korrespondencës, nëse është shkruar thjeshtë.</li> </ul> <p><b>TË SHKRUARIT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkruan të dhëna bazike për vetveten dhe të tjerët.</li> <li>• Plotëson një formular me të dhëna personale elementare (në një hotel).</li> <li>• Shkruan një kartolinë gjatë pushimeve (vendi, moti, aktivitetet dhe data e kthimit).</li> <li>• Di të shkruajë fjalë bazike të gjërave ushqimore.</li> </ul>

## **Udhëzime metodologjike**

Procesi i mësimdhënies për fushën Gjuhët dhe Komunikimi duhet të bazohet në nevojat dhe interesat e nxënësve, në funksion të zhvillimit të individualitetit dhe kreativitetit të tyre. Nxënësit e kësaj klase që mësojnë gjuhën frënge duhet të arrijnë kompetencat e tyre nëpërmjet mësimi dhe çasjes së integruar. Suksesi i tyre arrihet përmes rezultateve të fushës kurrikulare. Metodatat, format, mjetet, përmbajtjet mësimore si dhe strategjitë e teknikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies, janë çelës kryesor për arritjen e këtyre kompetencave. Për arritjen e rezultateve për tema të caktuara ndërkurrikulare si: edukimi qytetar, edukimi për paqe, ndërvarësia, edukimi për media, arsimi për zhvillim të qëndrueshëm, mësimdhënësi duhet të përzgjedhë metodën, formën dhe strategjinë e duhur.

### **Parimet didaktike-metodike**

Të mësosh frëngjishten si gjuhë e huaj do të thotë të përvetësosh njohuri të caktuara dhe të jesh në gjendje t'i përdorësh në situata të jetës reale. Për këtë qëllim duhet ndjekur dy parime kryesore: 1) përqendrimi në komunikim dhe jo si deri më tani përqendrim në gjuhë; 2) përqendrimi në nxënësin dhe në nxënien e tij. Përvetësimi i shkathtësive gjuhësore zë vend parësor në mësimin e gjuhëve të huaja.

### **Forma komunikative e mësimdhënies**

Mësimdhënia më e mirë e kësaj gjuhe të huaj të gjallë bëhet në formë komunikuese, prandaj komunikimit i kushtohet vëmendje e posaçme. Kjo formë e mësimdhënies ua mundëson nxënësve arritjen e mjeteve gjuhësore që u nevojiten për t'u shprehur në klasë, kurse më vonë edhe në situata të caktuara të jetës së përditshme. Komunikimi është mënyra më e pranueshme për arritjen e objektivave të përcaktuara. Pikënisja e një mësimdhënie të tillë nuk do të jetë një rregull gramatikore, por situatat e ndryshme gjuhësore. Kjo do të thotë se prej situatave gjuhësore nxirren rregullat dhe jo anasjelltas.

### **Metodat e mësimdhënies**

Për mësimin e gjuhës frënge mësimdhënësi duhet të përdorë metoda bashkëkohore sepse vetëm ato nxisin komunikimin e drejtpërdrejtë në këtë gjuhë dhe jo metodën tradicionale (megjithëse ajo mund të mbetet si një metodë ndihmëse në një fazë të parë të mësimi të saj). Puna në grupe ose në çifte, dialogjet e shkurtra, lojërat në role, tekstet e shkurtra, materialet pamore dhe format e punës që nxisin punën e pavarur, kreativitetin dhe frymën garuese të nxënësve në klasë, po ashtu, janë shumë të rëndësishme. Duhet përdorur metodologji të punës që nxitin aktivitetet prodhuese të nxënësve.

Renditja e veprimeve

Për një mësim të efektshëm të frëngjishtes si gjuhë e huaj e dytë, është e nevojshme të respektohet kjo renditje e shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit dhe të kuptuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Puna aktive dhe konkrete: mësimdhënësit duhet të kenë parasysh kushtet dhe rrethanat e punës (si një mes jofrankofon) që dallohen shumë nga ato të Francës ose të një vendi tjetër frankofon. Ushtrimet duhet të zënë vend meritore, varësisht nga llojet e tyre. Ato mund të bazohen në të dëgjuar, në të shikuar dhe në të shkruar.

### Korrigjimi i gabimeve të nxënësve

Mënyrat e korrigjimit të gabimeve të nxënësve diskutohen shpesh dhe në mënyrë kundërthënëse në rrethin e mësimdhënësve. Disa i shohin gabimet si pengesë në procesin e mësimdhënies, të tjerët i shohin si ndihmesë në përvetësimin e gjuhës së huaj. Ndërsa disa prej tyre mendojnë që ato duhet të korrigjohen menjëherë që të mos përseriten, të tjerët mendojnë që ato nuk duhet të korrigjohen me çdo kusht. Sido që të jetë, nxënësit nuk duhet ndëshkuar, qortuar apo kritikuar për gabimet e bëra.

### Mësimdhënia / nxënia e diferencuar

Asnjë klasë nuk ka përbërje homogjene nxënësish sa u përket njohurive të tyre paraprake nga gjuha frënge dhe aftësive psikofizike dhe intelektuale të tyre, prandaj mësimdhënësit duhet të organizojnë orën mësimore mbi këtë bazë. Kjo nënkupton që, nxënësit që kanë aftësi për nxënie më të shpejtë të trajtohen ndryshe nga të tjerët, në mënyrë që mësimi i gjuhës frënge të jetë në përputhje me mundësitë dhe aftësitë individuale të secilit nxënës.

### Teknikat e punës

Një ndër detyrat e mësimdhënies në gjuhën e huaj është edhe aftësimi i nxënësve që të përgatiten dhe të marrin përgjegjësinë për të mësuarit individual. Nxënësit të cilët kanë mundësi për të menduar për proceset e nxënies së gjuhës frënge dhe të organizojnë procesin e të mësuarit të saj në grup, zakonisht arrijnë sukses më të mirë. Në këtë mënyrë ata, përveç tjerash, mund të përgatiten që të reagojnë në mënyrë të pavarur në situatat jashtëshkollore dhe të vazhdojnë proceset e mësimin të gjuhës.

### Përdorimi i mediave

Kompjuteri dhe interneti përbëjnë një mjet shumë të dobishëm dhe të përhershëm që duhet shfrytëzuar si nga arsimtari ashtu edhe nga nxënësit. Emisionet shkollore kushtuar gjuhës ose kulturës frënge të ne, programet e filmit dhe ato të dramës dhe emisionet e ndryshme televizive të jashtme në gjuhën frënge janë një mjet i fuqishëm që do të ndihmojë dhe përshpejtojë përvetësimin e saj nga nxënësit tanë.

Filmi, teatri, muzika, po ashtu, përbëjnë mjete të rëndësishme motivuese për arritjen e rezultateve më të mira në përvetësimin e gjuhës frënge. Fotografitë ndihmojnë sajimin e teksteve kreative dhe përshkruese. Ato tregojnë një ngjarje, fillimin ose mbarimin e së cilës e përshkruan

fotografia. Videoprojektori rrit interesimin e nxënësve për mësimin e saj. Kjo arrihet me: prezentimin e fotografive, vizatimeve, tregimeve të ilustruara dhe të teksteve përmes folive dhe projektorit. Materiali auditiv mundëson ballafaqimin me frëngjishten standarde dhe nxit të kuptuarit e nxënësve përmes dëgjimit. Videomateriali u jep nxënësve mundësi të shumta për sajimin e teksteve me shkrim dhe me gojë. Shfaqja e një filmi të punuar mbi bazën e një tregimi ose përralle nxit krahasimin me tregimin ose me përrallën e lexuar ose të dëgjuar më parë.

## **Udhëzime për zbatimin e ndërkurrikulare**

Mësimi i një gjuhe të huaj ofron mundësi të shumta për lidhje ndërlëndore dhe ndërprogramore, në të gjitha nivelet. Këto lidhje do të përfshijnë sidomos ato të gjuhëve (gjuhës amtare dhe gjuhës së huaj të parë dhe gjuhës së huaj të dytë); të shkencave shoqërore (edukatën qytetare, historinë, gjeografinë, etj.); të arteve të llojeve të ndryshme; por edhe të shkencave të natyrës. Në këtë mënyrë, në njërën anë, përmes njohurive nga lëndët e tjera, nxënësit do të ndihmohen në përvetësimin më të suksesshëm të gjuhës frënge, në anën tjetër, përmes njohurive nga gjuha frënge, ata do të zgjerojnë dhe përforcojnë njohuritë e tyre paraprake nga lëndët e tjera. Përmbajtjet e çështjeve ndërkurrikulare dalin nga temat lidhur me paqen, të drejtat e njeriut, zhvillimin e mediave, barazinë gjinore, shkathësitë për jetë, kujdesin ndaj mjedisit, shëndetin dhe mirëqenien etj. Çështjet ndërkurrikulare mund të realizohen nëpërmjet projekteve të natyrave të ndryshme, debateve për tema të caktuara, diskutimeve, hulumtimeve lidhur me shkeljen e të drejtave të fëmijëve, vizitave të institucioneve shëndetësore, etj. Kjo do të arrihet përmes një çasjeje të integruar të mësimdhënies së gjuhës frënge me çështje, aspekte dhe fusha të ndryshme të lëndëve të ndryshme. Kjo çasje e bën më të lehtë dhe më të shpejtë përvetësimin e njohurive nga kjo gjuhë dhe njëkohësisht ato integrohen mes vete dhe bëhen shumë më të qëndrueshme. Prandaj, gjatë përgatitjes së planit vjetor caktohen temat mësimore që janë në funksion të të gjitha lëndëve mësimore. Për të ndihmuar këtë kërkohet që planet vjetore të kenë formatin e njëjtë në të cilin shënohet korrelacioni i cili do të ndihmojë funksionimin e lidhjes ndërmjet fushave dhe lëndëve.

## **Udhëzime për vlerësim**

Për fushën Gjuhët dhe Komunikimi, vlerësimi bëhet me qëllim të mbledhjes, sistemimit, evidentimit dhe raportimit të të dhënave për arritjet e nxënësve gjatë gjithë procesit të mësimnxënies. Vlerësimi i rezultateve të arritura të nxënësve në mësimin e gjuhës frënge u siguron nxënësve informacione për nivelin e përvetësimit dhe të arritjes së kompetencave. Vlerësimi duhet të përqëndrohet në njohjen e fjalorit të gjuhës frënge, në të kuptuarit e tij në një kontekst të caktuar dhe në përdorimin e tij në komunikimin e përditshëm, duke zbatuar njohuritë e tyre nga fonetika, gramatika dhe përvojën e tyre paraprake në komunikimin në gjuhën angleze. Gjatë të shprehurit gojor dhe shkrimor vlerësohet përvetësimi i drejtshqiptimit dhe

drejtshkrimit. Natyrisht, për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive gjuhësore të nxënësve duhet të mbështetemi në qëllimin e vlerësimit, në informatat cilësore për vlerësim, në vlerësim të balancuar, në shkallën e saktë të arritshmërisë së nxënësve dhe në përdorimin e instrumente adekuate për vlerësim (vrojtimi, pyetësi, të shprehurit me gojë, të shprehurit me shkrim, testi i bazuar në kriteredhe objektiva dhe testi i arritshmërisë sipas kërkesave).

*Llojet e vlerësimeve:* ekzistojnë lloje të ndryshme të vlerësimit të njohurive të nxënësve si: vlerësimi diagnostik (identifikimi i aftësive dhe vështirësive të nxënësve në mësim); vlerësimi i jashtëm (vlerësim nëse njohuritë e fituara mjaftojnë që nxënësi të kalojë në klasën e radhës); vlerësimi formativ (vlerësimi për të nxënë); vlerësimi parashikues (parashikim i dështimeve dhe sukseseve potenciale të nxënësve); vlerësimi përfundimtar (përparimi i nxënësve dhe rezultatet e arritura në mësim); vlerësimi selektiv (vetëvlerësimi nga nxënësit i arritjeve dhe problemeve të tyre në mësim); vlerësimi somativ (mundëson vlerësimin e njohurive dhe kompetencave të fituara nga nxënësi në fund të një viti shkollor, klasifikimin e nxënësve dhe konstatimin nëse nxënësi i ka arritur kompetencat për të kaluar në klasën vijuese); vlerësimi formativ (konsiston në vlerësime interaktive që tregojnë të arriturat dhe progresin ose mangësitë e nxënësve gjatë të nxënësve).

*Çfarë duhet të vlerësohet?* -Të kontrollohen njohuritë e fituara; përparimi i nxënësve; shkalla e zhvillimit të nxënies; shkalla e zotërimit të gjuhës frënge; shkalla e integritit të njohurive të fituara dhe aktivitetet jashtëshkollore.

*Mënyrat e vlerësimit:* kontrolli i vazhdueshëm; vlerësimi i drejtpërdrejtë (me tabelë); vlerësimi i tërthortë (me test); vlerësimi objektiv (me tabelë); vlerësimi subjektiv (pa tabelë); vlerësimi nga nxënësit (vlerësimi i njëri-tjetrit); vlerësimi në grupe nxënësish brenda klase (me tabelë) dhe vetëvlerësimi i nxënësve (secili nxënës vlerëson vetveten).

*Kriteret e vlerësimit:* aktivitetet e të shprehurit; të shprehurit gojor; të shprehurit me shkrim; aktivitetet e receptimit (të kuptuarit gojor dhe të kuptuarit me shkrim); aktivitetet e riprodhimit (të shprehur me gojë dhe me shkrim. Notat numerike jepen sipas shkathtësive gjuhësore: të dëgjuarit; të folurit; të lexuarit dhe të shkruarit (5, 4, 3, 2, 1).

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për arritjen e rezultateve të nxënësve të klasës së 7-të në gjuhën frënge, në rend të parë është i rëndësishëm përdorimi i literaturës didaktiko-metodike të kësaj gjuhe të huaj (në gjuhën shqipe dhe frënge), i materialeve të pasura didaktike nga burime (linqe) të ndryshme përmes internetit për mësimdhënie dhe mësimnxënie. Për realizimin e rezultateve të fushës dhe për arritjen e suksesshme të rezultateve për lëndë, të gjitha mjetet dhe materialet mësimore duhet t'u përbahen kërkesave të këtyre rezultateve. Metoda franceze për mësimin bashkëkohor të gjuhës frënge, "Merci" (pjesa e dytë nga 4 pjesët e barabarta të saj), e lejuar nga Ministria e Arsimit, e

Shkencës dhe e Teknologjisë për përdorim në ShMU të Republikës së Kosovës, bashkë me pjesët përbërëse të saj, përbën mjetin kryesor të punës dhe burimin kryesor të informatave të mësimdhënies dhe mësimnxënies, por jo edhe të vetmin mjet dhe burim që mësimdhënësi i i kësaj gjuhe të huaj dhe nxënësit e tij mund dhe duhet të përdorin. Ata kanë në dispozicion mundësi shumta për sigurimin e mjeteve mësimore të pasura nga burime të ndryshme për marrjen e informacionit, me kusht që ato të përzgjedhen me kujdes, varësisht nga njësia mësimore, qëllimi i saj, moshë e nxënësve dhe njohuritë paraprake të tyre dhe të përdoren në mënyrë të përshtatshme për nxënës.

# **FUSHA KURRIKULARE: ARTET**

**Kurrikulat lëndore/programet mësimore**

*Arti figurativ*

*Arti muzikor*

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## Arti figurativ

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore



## Hyrje

Lënda Art figurativ për klasën e shtatë është një nga lëndët e rëndësishme brenda fushës kurrikulare Artet, e cila së bashku me lëndët e tjera të kësaj fushe ka një ndikim dhe rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve dhe kultivon kulturën artistike, intelektuale, shpirtërore dhe emocionale tek ata.

Përmes artit zhvillohen vlerat shoqërore dhe formimi i personalitetit dhe identitetit personal e kulturor, duke kontribuar në arritjen e kompetencave e të nxënësve të Kurrikulës Bërthamë.

Lënda Art figurativ në klasën e gjashtë fokusohet në zgjerimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të njohurive dhe shkathtësive të artit dhe përdorimit të tyre në krijimtari artistike duke zhvilluar kreativitetin, imagjinatën, mendimin kritik dhe shijen estetike.

Arti figurativ iu jep mundësi shprehëse dhe komunikuese nxënësve për të pasqyruar idetë dhe qëndrimet e tyre përmes veprave artistike.

Lënda e artit synon të vë në pah rolin dhe rëndësinë e artit për shoqërinë njerëzore në përgjithësi dhe zhvillimin e shkathtësive krijuese dhe talentit artistik të nxënësve me prirje artistike si një mundësi për studime të mëtutjeshme në krijimin e individualitetit të tyre artistik e profesional.

## Qëllimi

Lënda e artit figurativ për klasën e shtatë, nëpërmjet përmbajtjeve të përcaktuara sipas tematikave, ka si qëllim:

- Zgjerimin e mëtejshëm të njohurive dhe koncepteve në art figurativ;
- Zhvillimin dhe formimin estetik, artistik, personal, intelektual, social dhe kulturor të nxënësve;
- Njohjen e rolit dhe rëndësisë së artit për individin dhe shoqërinë;
- Zhvillimin e shkathtësive kreative e artistike për të komunikuar ndjenjat, idetë dhe mendimet përmes punimeve artistike;
- Shkathtësinë e përdorimit të elementeve dhe parimeve të artit në punime artistike;
- Njohjen dhe përzgjedhjen e materialeve, teknikave dhe mjete të ndryshme artistike dhe përdorimi i tyre në vepra arti;
- Kultivimin e shijes dhe përjetimit estetik të veprave të artit;
- Zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive për të vlerësuar dhe analizuar vepra arti;
- Zhvillimin e aftësisë për të identifikuar veprat e artit nëpërmjet periudhave, përmbajtjeve, temave, stileve, metodave, teknikave dhe materialeve.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepti	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
<p><b>KRIJIMTARIA DHE PERFORMANCA ARTISTIKE</b></p>	<p><b>Krijimi i punimeve</b> (Vizatimi, Piktura, Grafika, Dizajni Grafik, Modelimi, Konstruksioni)</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Realizon punime dy dhe tri dimensionale duke përdorur teknika dhe medime të ndryshme të artit.</li> <li>• Krijon veprave artistike duke përdorur lloje dhe teknika të ndryshme të vizatimit.</li> <li>• Përzgjedh dhe përdor teknika të ndryshme të pikturës për të realizuar punime artistike.</li> <li>• Krijon duke përdorur njohuritë e teorisë së ngjyrave (ngjyrën, vlerën, intensitetin, etj).</li> <li>• Realizon punime në teknikat e grafikës duke mësuar veqoritë dalluese të saj.</li> <li>• Modelon vepra skulpturale në reliev dhe skulpturë tridimensionale duke përdorur forma të ndryshme.</li> <li>• Përzgjedhë dhe përdor materiale dhe teknika të ndryshme për të krijuar skulptura të ndryshme.</li> <li>• Realizon fotografi artistike duke përdorur mjetet dhe teknikat manuale apo digjitale.</li> <li>• Manipulon me imazhe fotografike duke përdorur programe të ndryshme kompjuterike.</li> <li>• Realizon punime nga arti aplikativ duke bërë dallimin nga arti figurativ.</li> <li>• Realizon piktura aplikative në teknikën e mozaikut dhe kollazhit.</li> <li>• Realizon punime të ndryshme në dizajn të produkteve të ndryshme .</li> <li>• Përdor materiale të ndryshme për të krijuar konstruksione të ndryshme arkitektonike në miniaturë.</li> </ul>
<p><b>GJUHA DHE KOMUNIKIMI ARTISTIK</b></p>	<p><b><u>Elementet figurative:</u></b> vija, ngjyra, toni, tekstura, madhësia, kahja, forma, vëllimi dhe hapësira.</p> <p><b><u>Parimet e artit figurativ:</u></b> kontrasti, ritmi,</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njeh, përshkruan dhe përdor elementet dhe parimet e gjuhës figurative.</li> <li>• Dallon dhe përdor lloje të ndryshme të vijave për të realizuar punime artistike.</li> <li>• Dallon llojet e ngjyrave dhe aplikon ato në punimet artistike</li> <li>• Identifikon dhe përdor llojet e ndryshme të toneve në vepra artistike.</li> <li>• Dallon teksturë natyrale dhe teksturë artificial sipas prejardhjes së materialit.</li> <li>• Dallon veprën figurative kur kombinohen madhësi të cilat janë të ndryshme sipas</li> </ul>

	<p>harmonia, baraspesha, gradacioni, proporcioni, bashkësia dhe kompozimi.</p>	<p>madhësisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon kahje horizontale, kahje vertikale dhe kahje të pjerrët në veprën figurative.</li> <li>• Shpjegon rëndësinë e dritë hijes dhe aplikon atë në vepra të artit.</li> <li>• Dallon dhe aplikon vëllimin në vepra dy dhe tri dimensionale</li> <li>• Përdor lloje të ndryshme teksturash për të krijuar një punim me teksturë.</li> <li>• Dallon dhe përshkruan llojet e ndryshme të hapësirës duke përdorur parimin e perspektivës për të arritur iluzionin e hapësirës në punime artistike.</li> <li>• Dallon rregullat e kompozimit dhe i përdor ato për të kompozuar vepra artistike.</li> <li>• Identifikon dhe aplikon llojet e ndryshme të kompozicionit në punimet e tyre artistike.</li> <li>• Identifikon llojet e ndryshme të barazpeshave dhe përdor ato në vepra artistike.</li> <li>• Identifikon llojet e ndryshme të harmonive duke realizuar një punim me parimin e harmonisë</li> <li>• Shpjegon dhe përshkruan rolin dhe rëndësinë e proporcioneve për realizimin e sakt të raportit në mes të formave të ndryshme.</li> <li>• Dallon lloje të ndryshme të sipërfaqeve dhe aplikon ato në punime artistike.</li> <li>• Analizojnë ritmin në punime të ndryshme të artistëve të njohur dhe aplikojnë lloje të ndryshme të ritmit në punët e tyre</li> <li>• Identifikojnë rëndësinë dhe karakteristikat e kontrastit për të bërë dallimin midis elementeve të ndryshme figurative në një vepër arti.</li> <li>• Përdorin lloje të ndryshme të kontrastit në punime artistike.</li> </ul>
--	--	---

<p><b>RELACIONI ART – SHOQËRI</b></p>	<p><b>Ekspozita dhe aktivitete kulturore</b></p> <p><b>Vizita dhe ngjarje artistike</b> Vizita në Galeri, muzeume, objekte të trashëgimisë kulturore, atele (studio) të artistëve, qendra kulturore etj.</p> <p><b>Periudha historike:</b> Vepra arti nga vende, kultura dhe kohë të ndryshme dhe objekte nga trashëgimia kulturore Arti i Rilindjes Manierizmi Arti barok Neoklasicizmi Romantizmi Realizmi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë në ekspozita e projekte artistike në klasë, shkollë, Galeri e komunitet.</li> <li>• Viziton atele dhe studio të artistëve, dhe ndanë eksperiencat me artistët profesionist.</li> <li>• Viziton institucione të ndryshme të artit si muze, galeri, qendra kulturore, vizita virtuale në internet në faqe të ndryshme etj.</li> <li>• Informohet rreth zhvillimeve bazë të historisë së artit duke dalluar disa nga këto periudha.</li> <li>• Njeh disa nga përfaqësuesit kryesor të periudhave dhe drejtimeve të ndryshme artistike.</li> <li>• Identifikon dhe njeh disa nga veprat më të njohura të artit.</li> </ul>
<p><b>ÇMUARJA DHE VLERËSIMI ESTETIKO-ARTISTIK</b></p>	<p>Vlerësimi i Periudhave dhe drejtimeve të artit</p> <p>Vlerësimi i Veprave artistike</p> <p>Analiza estetike e punimeve <i>Debate për trajtimin e çështjeve dhe problemeve të artit.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezentonë dhe përshkruan punimet e tij, para klasës.</li> <li>• Analizonë dhe vlerësojë krijimet artistike vetjake dhe të tjerëve duke analizuar, elementet, parimet dhe teknikat e gjuhës artistike.</li> <li>• Vëren, përjeton, analizon, çmon, vlerëson e gjykon punën artistike në mënyrë analitike-kritike përmes punimeve individuale, grupore brenda dhe jashtë klasës, ekspozitave të organizuara shkollore.</li> </ul>

## Udhëzimet metodike metodologjike

Për organizmimin sa më të mirë të procesit mësimor, për një mësimdhënie dhe mësimnxënie të suksesshme dhe për realizimin e planprogramit mësimor, në lëndën e artit figurativ duhet të përdoren metodologji të ndryshme të mësimdhënies. Këto metodologji janë në shërbim të rritjes së cilësisë së sukseseve dhe arritjeve të mësimnxënjes nga ana e nxënësve, duke i ofruar mundësinë që të shfaqin dhe të zhvillojnë potencialin krijues/artistik që zotërojnë brenda vetes.

Metodologjitë duhet të jenë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, koncepteve, shkathtësive dhe në harmoni me rezultatet e të nxënësve të lëndës së artit figurativ (RNL), fushës së arteve (RNF) dhe kompetencave kryesore të Kurrikulës Bërthamë (RNSH).

Përzgjedhja e metodologjive është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës, dhe ato përgjithësisht në përputhje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Duke marrë për bazë natyrën e lëndës së artit figurativ që më tepër është veprimtari praktike, ku nxënësit realizojnë vepra të ndryshme artistike, edhe metodologjitë përzgjidhen në atë mënyrë që nxënësi të motivohet për pejsmarrje aktive në këto aktivitete si një mundësi që ata përmes përdorimit të mjeteve të larmishme artistike të reflektojnë idetë, qëndrimet dhe mendimet e tyre. Ata janë aktivë kur përfshihen në veprimtari, eksplorime, krijime ose simulime të njohurive, interpretime, qëndrime dhe gjykime. Për të siguruar këtë pjesëmarrje aktive të nxënësve, mësuesi duhet të krijojë një atmosferë që i bën ata të ndihen të lirshëm dhe të zhdërvjellët për të zhvilluar njohuritë e tyre në artin figurativ.

Mësimdhënia në artin figurativ synon gjithëpërfshirjen, motivimin, barazinë në të gjitha aspektet *në mësimdhënien dhe nxënien, bazuar në kompetenca, në mësimdhënien me nxënësin në qendër dhe mësimdhënien - nxënien e integruar.*

Planifikimi dhe përzgjedhja e strategjive dhe metodave të mësimdhënies në mësimin e artit figurativ merr parasysh:

- Zhvillimin dhe forcimin e njohurive dhe shkathtësive bazë të artit figurativ duke u mbështetur në ato paraprake;
- Kompetencat kryesore të të nxënësve në artin figurativ;
- Nxitjen e të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- Motivimin e nxënësve, për krijimtari artistike dhe punë të pavarur;
- Rëndësinë e veprimtarive praktike në artin figurativ, brenda dhe jashtë klasës;
- Rëndësinë e përdorimit të mjeteve konkrete didaktike dhe ato të teknologjisë;
- Veçoritë e veprimtarive individuale dhe në grup;

- Nevojën e individit për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Rëndësinë e qëndrimit pozitiv ndaj lëndës së artit figurativ dhe vlerësimit të përdorimit të gjithanshëm të tij;
- Nxitjen e bashkëveprimit mësues-nxënës në procesin mësimor, dhe
- Eksperiencat gjatë vizitave nëpër institucione të artit (galeri, muze).

Secila metodologji duhet të jetë në shërbim të interesave dhe nevojave të nxënësve dhe t'i inkurajojë ata të kenë besim në arritjen e suksesit në fushën e artit.

Për të zhvilluar suksesshëm procesin mësimor mësimdhënësit duhet të krijojnë një mjedis të përshtatshëm në klasë, të stimulojnë dhe inkurajojnë nxënësit për pjesëmarrje në veprimtari të ndryshme duke planifikuar shumëllojshmëri aktivitetesh, materialesh, teknikash dhe informacionesh, në mënyrë që, nxënësit të kenë mundësi për të eksploruar sa më shumë mbi artin figurativ. Edhe prezentimet e projekteve, diskutimet, debatet gjatë realizimit të tyre, janë mundësi shumë e mirë për realizimin e kompetencave figurative/artistike.

### **Format e punës në lëndën Art Figurativ**

Në procesin mësimor të realizimit të përmbajtjeve programore të lëndës së artit figurativ aplikohen forma të ndryshme të punës:

- individuale,
- në çifte,
- në grupe, dhe
- me tërë klasën.

### **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Në sistemin arsimor temat ndërkurrikulare janë tema të rëndësishme përmes të cilave nxënësit fitojnë, zhvillojnë dhe përvetësojnë disa aftësi dhe njohuri specifike, në mënyrë që të përgatiten për jetën dhe punën në të ardhmen dhe të përballojnë dhe tejkalojnë me lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare janë tema me të cilat vazhdimisht është ballafaquar shoqëria njerëzore, të cilat synojnë krijimin dhe kultivimin e disa vlerave shoqërore, humane e njerëzore, të cilat kontribuojnë në formimin e identitetit dhe personalitetit individual dhe të pavarur të nxënësve.

Në temat ndërkurrikulare integrohen dhe kontribuojnë të gjitha fushat kurrikulare në forma të ndryshme duke përfshirë edhe e fushën e arteve me lëndët e saj, e cila i ndihmon nxënësit të njohin, kuptojnë dhe të interpretojnë më mirë botën, ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe të rritin lidhjen e arsimit me jetën dhe me interesat e saj.

Temat ndërkurrikulare të cilat trajtohen në fushën e arteve janë:

- *Edukimi për qytetari demokratike,*
- *Edukimi për paqe,*
- *Globalizimi dhe ndërvarësia,*
- *Edukimi për media, dhe*
- *Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm*

Këto tema mund të ndërliken dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me programin e lëndës së artit.

### **Edukimi për qytetari demokratike**

Në temën Edukimi për qytetari demokratike përmes artit nxënësit mund të trajtojnë tema për qytetërimet dhe demokracinë dhe në këtë formë të formojnë identitetin e tyre qytetar e kulturor, si qytetar aktiv për mirëqenien e tyre dhe të komunitetit.

### **Edukimi për paqe**

Nxënësit në lëndën e Artit figurativ, mund të trajtojnë dhe realizojnë tema që kanë të bëjnë me paqen, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, dinjitetit njerëzor, diversitetit kulturor, tolerancës, humanizmit, harmonisë dhe bashkëjetesës.

### **Globalizimi dhe ndërvarësia**

Nxënësit trajtojnë tema që kanë të bëjnë me epokën e globalizimit në sfera të ndryshme shoqërore si në art, kulturë, ekonomi, arsim etj. Dhe ndërvarësia dhe raporti i zhvillimeve të kulturave të ndryshme shoqërore, duke krijuar një këndvështrim pozitiv e pranues ndaj këtyre përvojave dhe kulturave.

### **Edukimi për media**

Edukimi për përdorimin e medias është një domosdoshmëri e kohës për nxënësit. Ajo u siguron informacione për zgjerimin e njohurive të tyre mbi zhvillimet historike të artit, autorëve, pastaj vepra arti, teori dhe problem artistike, duke zhvilluar dhe kultivuar shkathtësinë dhe kulturën hulumtuese për trajtimin e problemeve të caktuara. Gjithashtu, media mund të përdoret edhe për krijime artistike dhe prezantim të projekteve të ndryshme artistike.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

Zhvillimi i qëndrueshëm është një proces i cili i përgatitë nxënësit me aftësi të qëndrueshme, që garanton mundësitë për një jetë më të mirë. Nxënësit duhet të aftësohen të zbulojnë sfidat e

zhvillimit të qëndrueshëm në këndvështrime të ndryshme, që kanë të bëjnë me ndikimet e veprimtarisë së njeriut mbi shoqërinë, në aspektin kulturor-artistik, social, ekonomik dhe mjedisor.

## **Udhëzime për vlerësimin**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjes së nxënësve gjatë procesit të të nxënësve. Vlerësimi përfshin tërë veprimtarinë dhe konsiderohet si element i mësimdhënies që ndihmon mësimdhënësit për ndjekjen e zhvillimit gradual në arritshmërinë e rezultateve të të nxënësve në nivel klase dhe shkolle të nxënësve si dhe zotërimin e kompetencave. Mësimdhënësi gjatë vlerësimit duhet të ketë parasysh përmbajtjen programore në arritjen e rezultateve mësimore dhe kompetencave të përcaktuara për këtë nivel, poashtu, metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies është e lidhur ngushtë me procesin e vlerësimit të nxënësve ngase është një element i pranishëm në çdo veprimtari mësimore.

Ky proces vlerësimi shtrihet që nga vlerësimi dhe vetëvlerësimi i punimeve të nxënësve të realizuara me teknika të larmishme artistike, portofoli me punë artistike, prezentimi me gojë dhe me shkrim, testimi, pjesëmarrja në një projekt kurrikular etj.

Vlerësimi në artin figurativ, mbështetet në parimin e individualizimit, ngase arritjet janë më shumë individuale, ku çdo nxënës ka predispozita dhe prirje të ndryshme për format e shprehjes artistike.

Inkurajimi, imagjinata, shprehja origjinale, krijuese, interesimi, përjetimi artistik, interpretimi dhe prezentimi i punëve artistike janë forma, të cilat ndihmojnë në vlerësimin e punës krijuese të nxënësve në arte.

Gjithashtu, pjesëmarrja individuale dhe në grupe, në aktivitetet të ndryshme artistike, që organizohen në klasë, shkollë dhe në komunitet, janë pjesë e procesit të vlerësimit.

Vlerësimi individual bëhet në funksion të matjes së kompetencave artistike të caktuara, që arrin të zhvillojë nxënësi gjatë procesit mësimor, vetëm ose në grup, përmes veprimtarisë praktike, d.m.th., përmes krijimit, vëzhgimit, dhe analizës së veprave të artit etj. Nxënësit vlerësohen, ndërsa demonstrojnë arritjet nëpërmjet veprimtarive e prodhimeve të ndryshme.

Portofoli, me krijimet, shkrimet, prezentimet dhe testimi, janë një mundësi objektive e vlerësimit të nxënësve, pasi i përgjigjet edhe vlerësimit sipas kompetencave të lëndës së artit figurativ.

### **Qëllimet e vlerësimit:**

- *Të identifikohet përparimi i nxënësve dhe t'u ofrohen të dhëna të mjaftushme.*
- *Të motivohen nxënësit për punë.*
- *Të sigurohen informacione për shkallën e arritshmërisë së kompetencave.*
- *Të diagnostikojnë pikat e dobëta dhe të forta tek nxënësit.*
- *Të përmirësohen nxënësia dhe mësimdhënja.*
- *Të japin detyra sipas aftësive individuale në përputhje me nivelin e nxënësve.*



- *Të përzgjedhin metoda të përshtatshme gjatë mësimdhënies, bazuar në nivelin e klasës.*
- *Të sigurohen informacione për zhvillimin e nxënësve për orientimin e tyre të ardhshëm.*

### **Format dhe instrumentet e ndryshme të vlerësimit**

Gjatë procesit të vlerësimit këshillohet që mësimdhënësit të përdorin forma dhe instrumente të ndryshme vlerësimi, duke u ofruar nxënësve jo vetëm kritere të shkruara, por edhe lloje të tjera të vlerësimit, për të kuptuar në mënyrë konkrete arritjet të cilat ata i synojnë. Instrumentet për vlerësim gjithmonë duhet të jenë të përshtatshme, varësisht prej qëllimit të vlerësimit. Forma dhe lloji i vlerësimit dhe veçanërisht mënyra në të cilën rezultatet raportohen, gjithmonë duhet të reflektojnë qëllimin e vlerësimit. Mënyra e ndërtimit të vlerësimit gjithmonë duhet të jetë transparente dhe e drejtë. Vlerësimi gjithmonë duhet të zbatohet me standardet më të larta etike. Vlerësimi i nxënësve duhet të jetë motivues dhe objektiv.

### **Metodat e vlerësimit**

- **Vlerësimi verbal** - përdorimi i pyetjeve të shkurtra, biseda rreth materialit mësimor apo një detyre konkrete, duke diskutuar me nxënës, një nga një, grupe apo me gjithë klasën, duke dëgjuar diskutimet që bëjnë nxënësit me njëri – tjetrin; për një koncept, mbi njohuri të arteve figurative, vepër apo detyrë artistike etj.
- **Vlerësimi me shkrim ose testimi** - detyra të veçanta për grupe nxënësish, teste të shkurtra për një koncept, temë apo dhe një grup temash, për një ese si dhe testime për një linjë të caktuar, semestrare dhe vjetore.
- **Vlerësimi i detyrave të realizuara** - vëzhgimi hap pas hapi i detyrave të artit, që nga ideimi deri tek organizimi dhe realizimi si p.sh: demonstrimi i arritjeve në punë konkrete (fjala vjen realizimi i punëve dy dhe tredimensionale, interesimi për ndjekjen e jetës artistike në komunitet, pasioni, vlerësimi dhe përkushtimi ndaj kësaj lënde etj).
- **Vlerësimi i projekteve të ndryshme**-bashkëpunimi i nxënësve në një projekt në bazë shkolle apo krahine.
- **Vlerësimi i punëve artistike** - marrja pjesë në veprimtari të ndryshme artistike që organizon shkolla etj., pjesëmarrja në veprimtari kombëtare si: konkurset, ekspozitat në shkallë vendi apo më gjerë.
- **Vlerësimi përmes portofolit** - portofoli i nxënësit, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve të tij përgjatë vitit shkollor. Ai mund të përmbajë detyra tematike (ese), krijime të ndryshme dy dhe tredimensionale të

realizuara gjatë vitit shkollor që mund të jenë krijime në pikturë, skulpturë (plastelinë), kompjuter etj., projekte kurrikulare, të gjitha në dobi të veprimtarive të ndryshme shkollore, produkte të veprimtarive kurrikulare etj. përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënësit, mësues/i,-ja rekomandon.

### **Instrumentet e procesit të vlerësimit**

- Testi (me shumë zgjidhje, saktë- gabim, përputhje, plotësim, përgjigje e shkurtër dhe kërkesa të hapura);
- Testi i strukturuar me gojë;
- Lista e kontrollit;
- Pyetësi;
- Fleta për intervista;
- Anketa;
- Eseja;
- Projekti;
- Dosja/Portofoli.

### **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Përzgjedhja dhe përdorimi i mjeteve didaktike e mësimore është pjesë e pandashme e procesit të mësimdhënies, dhe ka një rëndësi të veçantë në arritjen dhe realizimin e kompetencave.

Këto mjete janë në shërbim të demonstrimit dhe konkretizimit të temave dhe njësive mësimore të trajtuara në lëndën e artit, dhe ato duhet të jenë shumë efikase, të prekshme dhe praktike për nxënësit.

Teknologjia është një nga mjetet me përdorim të gjerë në lëndën e artit figurativ duke ndihmuar nxënësit të hulumtojnë dhe njohin vepra arti të ndryshme, objekte të trashëgimisë kulturore, objekte të dizajnit, etj., duke krijuar tipin studiues të nxënësve në lëndën e artit.

Shkolla si institucion arsimor, duhet të siguroj dhe ofrojë kushte dhe mundësitë tekniko-teknologjike adekuate apo alternative në realizimin dhe arritjen e kompetencave të planprogrameve të lëndëve të caktuara, në këtë rast edhe të lëndës së artit.

Në këtë formë nxënësve u krijon mundësinë të demonstrojnë apo prezantojnë me anë të medimeve teknologjike detyra dhe projekte të ndryshme.

Mësimdhënësi nxit interesimin e nxënësve për veprimtari dhe trajtim të temave të artit duke përdorur një fjalor të pasur të gjuhës artistike figurative me fjalë dhe fjali të qarta, të sakta, kuptimore e konceptuale.

Mësimdhënësi nxit zgjerimin e njohurive mbi artin tek nxënësit, duke i motivuar që, të përdorin burime, materiale dhe tekste (libra) të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e të mësuarit.

**Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:**

- Materiale tekstuale: *teksti shkollor, fletore e punës, katalogë arti, albume, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale pedagogjike, enciklopedi etj.;*
- Mjete vizuale – figurative: *tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, vazo, riprodhime të veprave të artit dhe postera, diagrame, mjete grafike etj.;*
- Mjete auditive-dëgjimore: *radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;*
- Mjete audiovizuale – figurative-dëgjimore: *televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, DVD, e-mail-i;*
- Mjedisi mësimor (*klasa, ateleja, kabineti, natyra, galeria, muzeu etj.*).

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## Arti muzikor

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Muzika kontribuon në zhvillimin fizik, emocional, intelektual, social dhe estetik të fëmijës, pra në formimin e gjithanshëm të tij e posacërisht në formimin kulturor, duke e pasuruar botën e tyre shpirtërore, identitetin dhe personalitetin. Me gjuhën universale të cilën e kuptojnë të gjithë njerëzit; pa dallim race, gjinie, e moshe, muzika u ndihmon nxënësve të kuptojnë dukuritë dhe proceset muzikore për t'i shfrytëzuar ato për komunikim dhe shprehje artistike në kontekste të ndryshme.

Si aktivitet shoqëror, që në zanafillën e paraqitjes së saj, muzika është medium që mundëson aktivitete të përbashkëta grupore, ku kërkohet bashkëpunimi në realizimin e këngëve, pjesëve muzikore me instrumente etj., duke iu mundësuar nxënësve që të zhvillojnë shkathtësitë e ndryshme muzikore krahas zhvillimit të kompetencave të tjera të përgjithshme .

## Qëllimi

Lënda Edukatë muzikore në klasën e shtatë vazhdon të:

- zhvillojë shkathtësitë muzikore (këndimin, luajtjen në instrumente muzikore dhe aftësitë krijuese) të nxënësve sipas interesimit dhe dispozitave individuale;
- zhvillojë veshin muzikor të nxënësve (ndjenjën ritmike, melodike dhe harmonike) përmes veprimtarive muzikore;
- zhvillojë njohuritë e nxënësve për ritmin, melodinë, harmoninë, format muzikore, instrumentet, institucionet, krijuesit dhe performuesit;
- zhvillojë komunikimin artistik me elementet e gjuhës muzikore duke pasuruar edhe 'fjalorin' dhe shkrim-leximin muzikor;
- aftësojë nxënësit që të familjarizohen me dëgjimin aktiv muzikor dhe të cmojnë e vlerësojnë krijimtarinë muzikore (kombëtare dhe botërore) të stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore;
- nxis nxënësit që të provojnë aftësitë e tyre krijuese muzikore;
- identifikojë krijuesit dhe performuesit, institucionet dhe ngjarjet e rëndësishme muzikore në vend dhe në botë.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Rezultatet e të nxënit të fushës (RNL) zbërthehen dhe specifikohen me anë të rezultateve të të nxënit të lëndës, të organizuara në 4 tërësitë tematike kryesore.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL)
	RNF.1.	<p><b>Demonstron prirje për të zhvilluar ndonjë ose disa shkathtësi artistike në muzikë, dramë, arte pamore e vallëzim</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal;</li> </ul> <p><b>Krijon duke përdorur mjete të ndryshme shprehëse artistike për të shprehur përjetimin individual, ndjenjat dhe idetë personale</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë;</li> <li>krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.</li> </ul>
<b>Krijimtaria dhe performanca artistike</b>	Këngët	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit këndojnë këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).</li> </ul>
	Interpretim në instrumente	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit shoqërojnë këndimin dhe luajnë pjesë të thjeshta instrumentale të zhanreve të ndryshme individualisht dhe në grupe.</li> </ul>
	Kreativiteti muzikor	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit improvizojnë me zë, me instrumente ritme dhe melodi në masa të ndryshme e në forma të ndryshme muzikore.</li> <li>Nxënësit shprehen me lëvizje/vallëzim, shprehje letrare e figurative të inspiruar nga muzika e dëgjuar.</li> <li>Nxënësit krijojnë melodi të reja për ritme e tekste të shkurtëra poetike të përzgjedhura duke përdorë edhe notacionin muzikor ose simbolet.</li> </ul>
	<b>RNF.2.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përdorin me kreativitet e origjinalitet elementet e gjuhës artistike për të komunikuar idetë e veta.</li> <li>Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të përdorura të gjuhës artistike dhe</li> </ul>

	<p>teknikave të përdorura.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike të tyre.</li> <li>• Komunikojnë me mjetet shprehëse artistike përkatëse (muzikë, dramë, vallëzim dhe arte vizuale) në mënyrë të përshtatshme për audienca të ndryshme (kolegë, prindër, fëmijë të tjerë, publik më i gjerë etj.).</li> </ul>	
Gjuha dhe komunikimi artistik	<p><b>Elementet muzikore</b></p> <p>Ritmi Harmonia Melodia Forma</p>	<p>Nxënësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdorin me kreativitet elementet muzikore (ritmi, masat, melodia, harmonia, shkallët muzikore etj) për të komunikuar me shprehje muzikore;</li> <li>• përdorin elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë luajtjes në instrumente muzikore;</li> <li>• marrin informacione për strukturën formale të veprave muzikore;</li> <li>• nxënësit identifikojnë dhe dallojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (fuga, sonata, oratoriumi, cantata, opera, simfonia etj) përmes dëgjimit muzikor;</li> </ul>
	<p><b>Shkrim leximi Muzikor</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rrokjet e solmizimit</li> <li>• Simbolet për gjatësinë e tingullit muzikor</li> </ul> <p><b>Shkallët muzikore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Reprodukojnë saktë lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore në bazë të rrokjeve të solmizimi dhe gajtësive ritmike (vlerat e notave) të këngëve që këndojnë;</li> <li>• identifikojnë parimin e ndërtimit të shkallëve të ndryshme muzikore përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore;</li> <li>• përdorin me sukses njohuritë për elementet muzikore në zbatimin e tyre praktik gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente.</li> </ul>
<b>RNF.3.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Identifikojnë dhe emërtojnë vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme;</li> <li>• Identifikojnë dhe dallojnë zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile të ndryshme etj.).</li> <li>• Njohin ngjarje, institucione, e zhvillime artistike të rëndësishme të</li> </ul>	

	periudhave të ndryshme historike në kontekste të ndryshme shoqërore(lokal, regjional, kombëtar, global etj).	
Muzika dhe shoqëria	<b>Zhanret muzikore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit dallojnë dhe krahasojnë zhanret muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok, muzikë festive etj) përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.</li> </ul>
	<b>Gjinite (llojet) muzikore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit përmes dëgjimit muzikor dallojnë dhe krahasojnë muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzikën skenike përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare.</li> </ul>
	<b>Instrumentet dhe formacionet muzikore</b>  <b>Krijuesit dhe performuesit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit përmes dëgjimit muzikor dallojnë dhe krahasojnë instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje.</li> <li>Nxënësit dallojnë dhe krahasojnë ansamblet e ndryshme muzikore, sipas funksionit dhe llojit.</li> <li>Nxënësit njohin vepra artistike dhe krijuese, artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.(<i>së paku 10 më të shquar</i>).</li> </ul>
<b>RNF 4.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Komentojnë dhe shprehen për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, powerpoint, prezantim e forma të tjera shprehëse.</li> <li>Komentojnë krijimet/performimet e veta dhe të tjerëve duke përdorur terminologjinë dhe konceptet artistike adekuate.</li> <li>Çmojnë veprat e trashëgimisë kulturore –popullore në ambientin ku jeton.</li> </ul>	
Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik	<b>Vepra muzikore</b> <b>Ngjarje muzikore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit vlerësojnë këndimin dhe interpretimin e vet dhe të tjerëve.</li> <li>Nxënësit shprehen për veprën e dëgjuar muzikore me vizatim ,ese, poezi ose forma tjera shprehëse artistike(së paku 10 vepra).</li> <li>Nxënësit shprehen për karakteristikat e veprës muzikore (formën, llojin, zhanrin, përmbajtjen)</li> <li>Nxënësit komentojnë ngjarje të ndryshme nga jeta artistike kombëtare</li> </ul>



		dhe botërore. <ul style="list-style-type: none"> <li>Nxënësit marrin pjesë në aktivitete të ndryshme muzikore brenda dhe jashtë shkollës.</li> </ul>
--	--	---

## Udhëzime metodologjike

Përjetimi artistik, kërkuesia, imagjinata dhe liria e të shprehurit, janë parimet kryesore të metodologjisë së mësimdhënies në fushën e arteve. Duke pasur parasysh se klasa VII është vazhdimësi e klasës së VI dhe pjesë e shkallës së III, në mënyrë graduale nxënësit vazhdojnë të mësojnë për konceptet e ndryshme, dukuritë dhe fenomenet muzikore përmes mësimdhënies intuitive dhe çasjes konstruktive të të nxënësit. Nxënësit kuptojnë proceset dhe teknikat krijuese muzikore, duke mësuar edhe si t'i zbatojnë ato në praktikë gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente muzikore. Artet ndërveprojnë mes vete, andaj edhe në procesin mësimor mund të ndërlihen format e ndryshme të të shprehurit artistik, p.sh., kënga me lëvizjen dhe vallëzimin, muzika me shprehjen figurative, muzika me shprehjen letrare, shprehja figurative me shprehjen letrare, performanca artistike sinkretike etj. Sidomos në këtë nivel, mund të aplikohet çasja e integruar e kombinimit të shprehjeve artistike për tema të ndryshme.

Ndërlidhja e gjuhës (amtare dhe të huaj) me muzikën mund të jetë shumë e suksesshme. Poezitë e ndryshme janë shpesh pjesë të këngëve artistike, por edhe temat e ndryshme letrare ndërlihen me veprat e ndryshme muzikore për dëgjim.

Udhëzimet specifike metodike të mësimin të muzikës në këtë klasë të elaboruara për secilën tërësi tematike e ndihmojnë mësimdhënësin që të planifikojë me kujdes orët mësimore gjatë një muaji, në mënyrë që ato të jenë të kombinuara dhe të mundësojnë arritjen e qëllimeve të lëndës.

## Krijimtaria artitike dhe performance

### *Këndimi dhe luajtja në instrumente muzikore*

Këndimi, luajtja në instrumente muzikore janë veprimtaritë muzikore që vazhdojnë të përdoren në këtë klasë, krahas dëgjimit të muzikës që shtohet në sasi, sepse përmes dëgjimit mësohen njësi të ndryshme mësimore nga temat si instrumente muzikore, veprat muzikore, krijuesit, performuesit etj.

Përmes të kënduarit zhvillohen më tej mënyrat e formësimit të zërit dhe zhvillohet shprehja dhe aftësia për të kënduarit e saktë në intonacion e në ritëm të caktuar. Përmbajtjet e këngëve janë të thjeshta dhe vazhdojnë të ruajnë tematika të tilla si: dashuria për familjen, shkollën, atdheun, këngët patriotike dhe festat e ndryshme, idetë dhe dëshirat e ndjenjat personale, si edhe temat nga çështjet ndërkurrikulare (paqja, tolerance, ambienti, etj) etj. Këngët për të rinj dhe ato popullore të përzgjedhura me kujdes sipas kriterëve të përzgjedhjes së këngës duhet poashtu të përfshihen. Këngët duhet të jenë të thjeshta për nga shtrirja e regjistrimit vokal (zërit), melodia dhe

në ritme e masa të ndryshme. Ndërsa luajtja në instrumente muzikore (popullore dhe klasike me te cilat disponojnë fëmijët) bëhet sipas veshit (me imitim) por edhe me tekst notal, për të shoqëruar këngët, por nxënësit nxiten që edhe të interpretojnë individualisht dhe në grupe pjesë të shkurtëra muzikore, sipas tekstit notal.

### **Gjuha dhe komunikimi artistik**

Melodia dhe ritmi janë pjesë e pandashme e njohurive të domosdoshme që duhet të dijë nxënësit për kuptimin e muzikës. Trajtohen masa e ndryshme muzikore dhe dukuritë ritmike e melodike, shkallët muzikore etj. në bazë të këngëve e shembujve dhe në këtë mënyrë zgjerojnë më tej njohuritë muzikore për të kuptuarit, krijimin, interpretimin dhe gjykimin e saktë të muzikës që dëgjon apo performon.

### **Dëgjimi muzikor, çmuarja dhe vlerësimi**

Dëgjimi muzikor, përjetimi dhe të shprehurit emocional ndaj muzikës, është një proces shumë i rëndësishëm. Muzika krijon emocione të ndryshme dhe nxënësit duhet të nxiten që t'i shprehin ato emocione të përjetuara. Dëgjimi aktiv muzikor kërkon përzgjedhjen e kujdesshme të veprave muzikore për dëgjim që ato të jenë të përshtatshme për aftësitë përjetuese të nxënësve. Muzika orkestrale, muzika skenike janë atraktive për nxënësit e kësaj moshe, krahas muzikës nga zhanre të ndryshme që ata preferojnë. Me rëndësi është që vepra që zgjidhet të jetë me vlerë artistike me karakter edukativ-didaktik . Vepra nga muzika vokalo-instrumentale janë edhe më konkrete për shkak të tekstit gjuhësor që e konkretizon përmbajtjen muzikore.

Muzika programore, skenike, muzika e popullarizuar poashtu mundëson që nxënësit të jenë më afër përmbajtjes muzikore dhe mesazhit të këtyre veprave. Përdorimi i teknologjive të ndryshme ndihmon dhe është në funksion të kërkimit të të dhënave dhe të prezantimit të veprave muzikore për dëgjim (shembujt muzikorë dhe videot e interpretimeve të veprave të ndryshme muzikore në youtube, CD, video etj). Nxënësit inkurajohen vazhdimisht që të cmojnë dhe vlerësojnë veprat e dëgjuara duke përdorur termet adekuate për elementet muzikore dhe shprehjen artistike.

Ata, në këtë klasë njihen me instrumentet muzikore në kuadër të familjeve të veçanta të instrumenteve muzikore. Njohin forma të caktuara muzikore, krijues, performues, zhvillime shoqërore që kanë ndikuar në zhvillimin e muzikës etj.

Në lëndën e muzikës për klasën e shtatë mund të trajtohen një varg çështjesh ndërkurrikulare.

**Edukimi për demokraci dhe paqe-** ka të bëjë me promovimin e përgjegjësisë, të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë gjinore, çështjet kulturore dhe ndërkulturore, parandalimin dhe luftimin e dukurive negative shoqërore, promovimin e dialogut, tolerances etj. Këto tema mund të jenë subjekt i këngëve, që nxënësit i këndojnë në klasë dhe në aktivitetet jashtëshkolllore. Mund të organizohen projekte tematike në këto tema me ç'rast përzgjidhen këngët dhe veprat muzikore për dëgjim që kanë ndërlidhje me këto tema.

### ***Globalizimi dhe ndërvarësia***

Nga perspektiva e arteve, vetë veprimtaritë artistike grupore e trajtojnë këtë temë, ngase p.sh. kur duhet të realizohet një mural, mozaik, kolazh, ose maketë grupore, të gjithë pjesëmarrësit e kuptojnë që pa bashkëveprimin e secilit nuk mund të realizohet tërësia e përbashkët. Muzikimi në ansambël, kor, orkestër realizohet vetëm duke respektuar bashkëveprimin dhe ndërvarësinë.

### ***Edukimi për media***

Nga perspektiva e arteve, këtu përfshihen çështjet e përdorimit të drejtë të teknologjisë dhe mediave për krijimin dhe shpërndarjen e veprave artistike, por edhe edukimin e shijes estetike për artin, që përfaqësohet në media; imazhet, muzika e mirë dhe jo e mirë, shpërndarja e muzikës përmes medimeve (e drejta autoriale, copyright etj.), por edhe aplikimi i mediave për krijim artistik (fotografia, kolazhi etj.).

### ***Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm***

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, çështjet e realizimit të së drejtës për të jetuar në mjedis të shëndoshë dhe në mirëqenie sociale, bazuar në konventat ndërkombëtare, mund të jenë objekt trajtimi i veprimtarive artistike (muzikës, dramës, vallëzimit, arteve pamore dhe teknikave të ndryshme (postere, grafike, pikturë etj.). Përdorimi i shprehjes artistike muzikore për të trajtuar të drejtën e fëmijës për shkollim, për liri e jetë të dinjitetshme, për dukuritë e ndryshme (p.sh. kundër duhanit, stop dhunës ndaj fëmijëve, stop luftës, etj.) është i mundshëm përmes projekteve tematike në të cilat muzika merr pjesë.

Përdorimi i shprehjes artistike dhe lëndëve artistike për të trajtuar temat e zhvillimit të qëndrueshëm (mbrojtja e ambientit, hapësirave, rregullit, lobimi për jetë të shëndetshme etj.) është poashtu një mundësi shumë e mirë e trajtimit të çështjeve ndër-kurrikulare edhe e integritetit ndërlëndor. Një ambient i shëndoshë tingullor është shumë i rëndësishëm për shoqërinë andaj trajtimi i shijes muzikore të nxënësve, kujdesi për nivelin e zërit, zhurmave etj. adreson këtë çështje.

### **Udhëzimet për vlerësim**

Vlerësimi në përgjithësi bëhet sipas 5 niveleve.

Niveli 1 -Dëshmon një shkallë të pamjaftueshme të përmbushjes së rezultateve të të nxënës dhe përkon me vlerësimin Pamjaftueshëm.

Niveli 2- Dëshmon një zotërim minimal dhe të mjaftueshëm të rezultateve të të nxënës, por që janë bazë për veprimtarinë e nivelit pasardhës dhe përkon me vlerësimin Mjaftueshëm.

Niveli 3 - Përfaqëson disa arritje të pjesshme të të nxënit dhe kompetenca për të kapërcyer sfidat e të nxënit dhe përkon me vlerësimin Mirë.

Niveli 4 - Përfaqëson arritje të larta e solide në përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe përkon me vlerësimin Shumë mirë.

Niveli 5 - Përfaqëson arritjet më të larta e të qëndrueshme në përmbushjen e rezultateve të të nxënit dhe përkon me vlerësimin Shkëlqyeshëm.

Vlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm por mund të zbatohet edhe vlerësimi përmbledhës për periudhën dy apo tre mujore që të vlerësohet arritja e zbatimit të planit dy mujor.

Vlerësimin e vazhdueshëm e mundëson mësimdhënësi përmes evidentimit të progresit të nxënësve me instrumente të ndryshme të vlerësimit, ku përfshihen:

- Lista e kontrollit për këngët, pjesët instrumentale dhe vlerësimi për nivelin e performimit sipas kritereve të përcaktuara,
- testet e ndryshme muzikore ( me dëgjim dhe me goje e me shkrim),
- detyrat e ndryshme hulumtuese me elementin e dëgjimit muzikor, dhe
- Vlerësimi i dosjes (portofolit) të nxënësit.

Dosja e nxënësit mund të përmbajë punët/detyrat praktike që zbatohen në klasë, projekte/pune praktike, si: detyrë shtëpie, kolazhe, CD, DVD me shembuj muzikorë, kërkime individuale për kompozitorët, instrumentet, veprat muzikore etj.

## **Materiale dhe burime mësimore**

Gjatë mëimit të muzikës mund të përdoren mjete didaktike dhe burime të ndryshme muzikore. Zëri dhe instrumentet tjera muzikore janë burimet kryesore për realizimin me sukses të edukatës muzikore. Pajisja e kabinetit të muzikës me instrumente të ndryshme muzikore ( ritmike dhe melodike) mundëson aktivitet muzikore dinamike në klasë dhe në shkollë. Pajisja me mjete te teknologjisë bashkëkohore TV, CD, projektor dhe qasje në internet i mundëson mësimdhënëseve që të prezantojnë shembujt muzikore në klasë në mënyrë auditive dhe vizuale, por edhe nxënësve u mundëson prezentimin e detyrave hulumtuese dhe projektet e tyre.

Tekstet mësimore, enciklopeditë muzikore e burimet online mundësojnë nxënësve të marrin informacione të duhura për krijuesit, instrumentet, stilet dhe zhanret muzikore, performuesit dhe institucionet. Tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësuesit, fletoret e punës, katalogë (të këngëve dhe shembujve muzikorë për dëgjim), albume të ndryshme me pamje të instrumenteve, kompozitorëve etj. mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan duhet të jetë i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit në punët e tyre krijuese dhe performuese.

**Disa burime online:**

**Libri i klasës së VII për edukim muzikor**

<http://music-teacher-resources.com/>

<http://www.zzounds.com/edu--musicteacherhandouts>

<http://interactivesites.weebly.com/music.html>

<http://www.classicsforkids.com/>

[https://www.youtube.com/results?search\\_query=muzike+instrumentale+klasike](https://www.youtube.com/results?search_query=muzike+instrumentale+klasike)

[https://www.youtube.com/results?search\\_query=muzike+popullore+shqiptare](https://www.youtube.com/results?search_query=muzike+popullore+shqiptare)

<https://www.youtube.com/watch?v=fABL5xSG4cA>

# **FUSHA KURRIKULARE: MATEMATIKË**

## **Kurrikula lëndore/programi mësimor Matematikë**

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Matematikë**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Matematika si fushë dhe lëndë mësimore, në klasën e shtatë u mundëson nxënësve të vazhdojnë të përmbushin me sukses nevojat dhe interesat për matematikën në raport me moshën e tyre, të zhvillojnë personalitetin dhe potencialin e tyre në zhvillimin intelektual dhe formimin e personalitetit për të qenë të suksesshëm në përballje me sfidat e të jetës dhe integritet në shoqëri. Programi lëndor i klasës së shtatë është vazhdimësi logjike e programit lëndor të klasës së gjashtë dhe mundëson realizimin e tërësishëm të rezultateve të fushës për shkallën e tretë. Që të arrihet kjo, nevojiten materiale të mira mësimore, metodologji të larmishme të mësimdhënies, si dhe angazhim i përhershëm për zhvillim të aftësive të nxënësve. Tërë kjo ka synim që nxënësit të vazhdojnë të fitojnë njohuritë e nevojshme dhe të kuptojnë marrëdhëniet sasiore, hapësinore dhe modelet në fenomene të ndryshme në natyrë, shoqëri dhe në jetën e përditshme si dhe zhvillimin e të menduarit logjik, kritik, analitik dhe abstrakt.

Programi i matematikës për klasën e shtatë shërben:

- nxënësit për zhvillimin e kompetencave kryesore të të nxënësve gjatë gjithë jetës dhe të kompetencave të fushës së matematikës, në mënyrë që ai në të ardhmen të jetë i suksesshëm;
- mësimdhënësit për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarisë mësimore dhe arrijtjet e nxënësve në klasë dhe jashtë saj;
- prindit për njohjen e rezultateve të të nxënësve të fëmijës dhe kriteret e vlerësimit në periudha të caktuara kohore, si dhe
- hartuesit të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësimdhënësit dhe nxënës.

Programi i matematikës paraqet rezultatet e të nxënësve të lëndës për tema mësimore për përmbajtje të cilat krijojnë kushte që nxënësi të ndërtojë dhe zbatojë njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, në funksion të kompetencave të fushës dhe kompetencave kryesore.

Poashtu programi përmban edhe udhëzime metodologjike të mësimdhënies si kusht për zbatimin e programit, për arrijtjen e kompetencave nga ana e nxënësve, duke i dhënë secilit mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes, udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare për kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme. Njëkohsisht në të janë dhënë edhe udhëzime për vlerësimin e arrijtjes së nxënësve të klasës së shtatë dhe udhëzime për materiale didaktike dhe burimet e mjetet mësimore.

## Qëllimi

Përmes të mësuarit e matematikës në klasën e shtatë synohet që, nxënësit të përvetësojnë njohuri themelore matematikore të nevojshme për të kuptuar fenomenet dhe ligjet e natyrës dhe të shoqërisë, zhvillimin intelektual të nxënësve, ushtrimin e rregullave themelore, kultivimin e vlerave si dhe përgatitjen për klasat në vijim. Po ashtu programi i matematikës ka për qëllim të



pajisë nxënësit me modelet e të menduarit matematik, me idetë bazë dhe strukturat matematikore si dhe t'u zhvillojë atyre aftësitë llogaritëse dhe të zgjidhjes së problemeve në jetën e përditshme. Njëkohësisht programi i matematikës në klasën e shtatë gjatë zbatimit: përzgjedh dhe zbaton strategji të zgjidhjes së problemeve; bën vrojtime, hetime, hulumtime, që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; komunikon të menduarit e tij matematik duke përdorë simbole matematike; krijon paraqitje të koncepteve të matematikës duke i lidhur mes vete dhe i zbaton në zgjidhjen e problemeve.

Qëllimi i lëndës së matematikës në klasën shtatë është promovimi i zhvillimit të mëtejshëm të koncepteve bazë të matematikës dhe përforcimin e tyre i cili bëhet përmes:

- të nxënit e integruar dhe në kontekstin e jetës së përditshme, si dhe
- të nxënit nëpërmjet përvetësimit të koncepteve elementare dhe koncepteve të ndërtuara të matematikës.

Programi i matematikës për klasën e shtatë qëllim kryesor ka krijimin e kushteve për zhvillimin e mëtejshëm të kompetencave të fushës - lëndës si dhe të kompetencave kryesore që lidhen me to.

Programi i matematikës në klasën e shtatë promovon edhe më shumë *zhvillim të përgjithshëm dhe konsolidim* i cili bëhet përmes:

- të nxënit të integruar në kontekstin e jetës së përditshme, dhe
- përvetësimit të koncepteve elementare dhe ndërtim në koncepte të reja.

## **Tema dhe rezultatet e të nxënit**

Përvetësimi i përmbajtjeve programore nga nxënësi demonstron si njohuri relevante që atij i parashtrihen në raport me moshën. Shkathtësitë që i demonstroi nxënësi përfshijnë: aftësitë, zotësitë, teknikat dhe metodat për zbatimin e njohurive në arritjen e rezultateve të të nxënit të planifikuara për tema përkatëse për këtë klasë.

Në lëndën e matematikës për klasën e shtatë zhvillohen dhe përvetësohen kryesisht këto koncepte të përgjithshme matematikore:

- numrat, algjebra dhe funksioni;
- forma, hapësira, matjet dhe gjeometria;
- përpunimi i shënimeve dhe probabiliteti;

Konceptet e përgjithshme zërthehen në tema dhe për secilën temë paraqiten rezultatet e të nxënit që bazën mbështetëse e sigurojnë nga rezultatet e të nxënit të fushës për shkallë.

Koncepti	Temat	Rezultatet e të nxënit të lëndës për temë (RNL-të)
Numri	<p><b>RNF</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Njeh dhe përvetëson termat (numër pozitiv, numër negativ, numër i kundërt, vlerë absolute, numër reciprok, numër racional, rrënjaë katrore);</li> <li>2. Kupton konceptin për thyesat, numra dhjetorë, numra përpjesëtimor, përqindje, shprehjeve shkronjore, funksioneve dhe zbatimin e tyre në një zgjidhje të problemeve;</li> <li>3. Arsyeton faktet dhe procedurat për zgjidhjet problemore që lidhen me numra të plotë dhe numra racionalë, përzgjedh dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>4. Integron matematikën si pjesë e kulturës njerëzore në situata ose dukuri nga kontekste të tjera: jeta e përditshme, lëndët tjera, sportet, ngrohja globale, turizmi, ekonomia, ambienti, migrimi etj.;</li> <li>5. Zbulon rregullat për veprimet me numra, përdor simbole dhe metoda për të modeluar marrëdhënie në situata praktike dhe zbaton strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve;</li> <li>6. Zgjidh probleme nga jeta e përditshme duke përdorur numra përpjesëtimorë, përqindjet, ekuacione dhe inekuacione elementare.</li> <li>7. Përdor teknologjinë informative për njehsime të ndryshme.</li> </ol>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon numrat e plotë dhe racionalë (pozitivë dhe negativë);</li> <li>▪ Paraqet numrat e plotë dhe racionalë në drejtëzën numerike;</li> <li>▪ Përcakton vlerën absolute të numrave me shenjë;</li> <li>▪ Krahason numrat e plotë dhe numrat racionalë;</li> <li>▪ Njehson shumën, ndryshimin, prodhimin dhe herësin e numrave të plotë dhe racionalë;</li> <li>▪ Zbaton radhën e veprimeve aritmetike në shprehje numerike;</li> <li>▪ Përkufizon bashkësinë e numrave të plotë si bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes, zbritjes dhe shumëzimit;</li> <li>▪ Përkufizon bashkësinë e numrave racionalë si</li> </ul>
	<p>Numrat e plotë dhe numrat racional</p>	

		<p>bashkësi të mbyllur ndaj mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit (në rastin kur pjesëtuesi nuk është zero);</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Njehson vlerën e shprehjeve me numra racionalë;</li> <li>▪ Dallon numërorët që tregojnë të njëjtën sasi (p.sh. <math>\frac{3}{5}</math> është barazi me 60% apo me 0.6);</li> <li>▪ Modelon dhe zgjidh barazi dhe jo barazi duke përdor numra racionalë.</li> </ul>
<b>Algjebra dhe funksioni</b>	<p><b>RNF</b></p> <p>Nxënësi</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kupton përpjesëtimin si raport të dy madhësive;</li> <li>2. Arsyeton fuqinë si prodhim disa herë i një numri apo shprehje;</li> <li>3. Lidhë rrënjën si veprim i kundërt i fuqisë;</li> <li>4. Zgjidh probleme përmes ekuacioneve dhe inekuacioneve</li> <li>5. Interpretton funksionin si lidhje të dy bashkësive përmes formës <math>y = f(x)</math>.</li> </ol>	
	Përpjesëtimi dhe përqindja	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon numërorët që formojnë përpjesëtim;</li> <li>▪ Dallon madhësitë e drejta përpjesëtimore;</li> <li>▪ Cakton të katërtën përpjesëtimore në përpjesëtimet e dhëna;</li> <li>▪ Zbaton rregullën e thjeshtë të treshit për të caktuar vlerën e të panjohurës te përpjesëtimet;</li> <li>▪ Vlerëson dhe kalkulon përqindjen përmendësh dhe me metoda llogaritëse;</li> <li>▪ Shndërron përqindjet në numra thyesorë, dhjetorë dhe anasjelltas;</li> <li>▪ Kryen “veprimet” me përqindje (p.sh. cakton vlerën e tërësisë kur dihet përqindja e një pjese të saj, cakton përqindjen e një pjese të tërësisë);</li> <li>▪ Zgjidhë probleme nga jeta e përditshme, duke përdor numra përpjesëtimorë dhe përqindjet.</li> </ul>

	Fuqia dhe rrënja	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Lexon dhe shkruan fuqitë me eksponent numër natyror;</li> <li>▪ Njehson vlerën e fuqisë me eksponent numër natyror dhe bazë numër racional;</li> <li>▪ Dallon rastet kur vlera e fuqisë është numër pozitiv apo negativ (varësisht nga baza dhe eksponenti);</li> <li>▪ Shpreh numrin e plotë në trajtë shkencore (p.sh. si zbatim të distanca mes planetëve);</li> <li>▪ Interpreton rrënjën katrore si veprim të kundërt të ngritjes në katror;</li> <li>▪ Njehson rrënjën katrore duke provuar/me tentativë dhe duke përdor kalkulatorin;</li> <li>▪ Modelon dhe zgjidhë probleme duke përdorur fuqitë.</li> <li>▪ Përdorë kalkulatorin për njehsimin e fuqisë;</li> </ul>
	Shprehjet shkronjore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zbaton radhën e veprimeve aritmetike dhe kllapave në shprehjet me shkronja;</li> <li>▪ Njehson vlerat e shprehjeve shkronjore për vlera të dhëna të shkronjave;</li> </ul>
	Ekuacionet dhe inekuacionet lineare me një të panjohur	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Zgjidhë ekuacionet lineare me një të panjohur (me numra të plotë dhe racionalë);</li> <li>▪ Zgjidhë inekuacionet lineare me një të panjohur (me numra të plotë dhe numra racionalë);</li> <li>▪ Paraqet zgjidhjet e inekuacioneve në drejtëzën numerike dhe formon bashkësinë numerike të zgjidhjeve;</li> <li>▪ Modelon dhe zgjidh ekuacione dhe inekuacione me numra të plotë dhe racionalë.</li> </ul>
	Funksioni	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Cakton vlerën e funksionit <math>y = f(x)</math> për vlera të ndryshme të argumentit <math>x</math>;</li> <li>▪ Paraqet pikat e funksionit me anë të tabelës, dyshes</li> </ul>

	linear	<p>së renditur dhe në rrjetin koordinativ;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndërton grafikun e funksionit duke bashkuar pikat në rrjetin koordinativ;</li> <li>▪ Modelon në mënyrë grafike probleme të ndryshme nga jeta e përditshme që ka të bëjë me funksionin <math>y = f(x)</math>.</li> </ul>
<p><b>Forma, hapësira, matjet dhe gjeometria</b></p>	<p><b>RNF</b></p> <p>Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Klasifikon dhe konstrukton këndet dhe shumëkëndëshat e ndryshëm i identifikon ata në figura dhe objekte të ndryshme;</li> <li>2. Zbaton teoremën e Pitagorës në figurat dhe objektet ku paraqitet trekëndëshi kënddrejtë;</li> <li>3. Zbulon marrëdhëniet ndërmjet këndeve, brinjëve, diagonaleve të shumëkëndëshave;</li> <li>4. Arsyeton dhe vërteton marrëdhëniet gjeometrike ndërmjet figurave 2D (dydimensionale) dhe trupave 3D tredimensionale. ;</li> <li>5. Kupton proceset e matjes duke përzgjedh teknikat dhe formulat e duhura për të kryer matje;</li> <li>6. Zgjidhë probleme nga situatat reale përmes matjes dhe formulave për njehsimin: e perimetrit, syprinës së figurave dhe vëllimit të trupave (prizmi, piramida) si dhe</li> <li>7. Zbaton rregullat për llogaritjen e syprinës së shumëkëndëshave, rrethit, prizmit piramidës;</li> <li>8. Zbaton rregullat për llogaritjen e vëllimit e prizmit dhe piramidës.</li> </ol>	
	Këndet	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Konstrukton këndin kongruent me këndin e dhënë;</li> <li>▪ Konstrukton simetralen e këndit dhe segmentit të dhënë;</li> <li>▪ Përdor njësitë për matjen e këndit: shkalla, minuta dhe sekonda dhe shndërron ato prej një njësie në tjetrën;</li> <li>▪ Mbledh dhe zbrit këndet e dhëna në mënyrë konstruktive dhe aritmetike;</li> <li>▪ Konstrukton këndet <math>60^{\circ}</math>, <math>30^{\circ}</math>, <math>15^{\circ}</math>, <math>90^{\circ}</math>, <math>45^{\circ}</math>, <math>120^{\circ}</math> etj. duke shfrytëzuar metoda të ndryshme (p.sh. fletët palosëse, këndmatësin, vizoren dhe kompasin);</li> <li>▪ Cakton këndin komplementar dhe suplementar të</li> </ul>

	<p>Figurat gjeometrike (shumëkëndëshat, rrethi)</p>	<p>këndit të dhënë, me njehsim dhe me konstruktim;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkruan vetitë e këndeve që formohen kur drejtëzat paralele priten nga transversalja dhe i emërton ata;</li> <li>▪ Identifikon shkallën e vizatimit (koeficientin e proporcionit) të figurat e ngjashme dhe në hartat gjeografike të qyteteve, shteteve, ...;</li> <li>▪ Njehson madhësitë e këndeve të trekëndëshit (të jashtme e të brendshme) kur dihen madhësitë e dy këndeve të tij;</li> <li>▪ Cakton perimetrin e figurave dydimensionale me anë të formulave dhe me matje;</li> <li>▪ “Vërteton” teoremën e Pitagorës në trekëndëshin kënddrejtë (duke ndërtuar katrorë mbi brinjët e tij) dhe e zbaton atë për njehsimin e gjatësisë së hipotenuzës apo katetit të trekëndëshi kënddrejtë;</li> <li>▪ Zbaton teoremën e anasjelltë të Pitagorës për të caktuar nëse një trekëndësh është kënddrejtë ose jo;</li> <li>▪ Zbaton Teoremën e Pitagorës për njehsimin e lartësisë të trekëndëshi barakrahës dhe barabrinjës, si dhe për njehsimin e diagonales të drejtkëndëshi dhe katrori;</li> <li>▪ Njehson perimetrin dhe syprinën e sipërfaqes shumëkëndëshe (paralelogrami, trekëndëshi, trapezi, deltoidi) me anë të formulave;</li> <li>▪ Konstrukton disa nga shumëkëndëshat e rregullt;</li> <li>▪ Njehson perimetrin dhe syprinën e sipërfaqeve shumëkëndëshe të rregullta kur dihet brinja dhe rrezja e rrethit të brendashkruar;</li> <li>▪ Zgjedhë njësitë standarde për matje të gjatësisë, sipërfaqes dhe vëllimit, si dhe shpjegon marrëdhëniet ndërmjet njësive të ndryshme të matjeve gjatë zgjidhjes së problemeve;</li> <li>▪ Konstrukton figurat me drejtëz simetrie dhe me</li> </ul>
--	---	--

		<p>qendër simetrie;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>▪ Zbulon marrëdhëniet e këndeve të brendshme (shuma e tyre është <math>180^0</math>) dhe këndeve të jashtme (shuma e tyre është <math>360^0</math>) të trekëndëshit me metoda të ndryshme (p.sh. duke i renditur qoshet e letrës, duke përdor këndmatësin, etj.);</li><li>▪ Njehson madhësitë e këndeve të trekëndëshit (të jashtme e të brendshme) kur dihen madhësitë e dy këndeve të tij;</li><li>▪ Cakton shumën e këndeve të brendshme në shumëkëndësia dhe anaşjelltas nga shuma e dhënë cakton shumëkëndëshin përkatës;</li><li>▪ Cakton numrin e diagonaleve të një shumëkëndëshi;</li><li>▪ Përshkruan marrëdhëniet ndërmjet njësive kubike dhe përdorë saktë ato gjatë matjeve;</li><li>▪ Përshkruan, emërton dhe klasifikon katërkëndëshat në bazë të pozitës së brinjëve (paralelogramet, trapezat, trapezoidët);</li><li>▪ Njehson perimetrin dhe syprinën e sipërfaqeve paralelograme, trapeze, deltoide.</li><li>▪ Përshkruan rrethin (me elementet e tij) dhe sipërfaqen rrethore;</li><li>▪ Përmes matjeve në rrahë të ndryshëm, konstaton se raporti ndërmjet rrezes, diametrit dhe perimetrit është numër konstant (numri pi), dhe gjen vlerën e përafërt të tij;</li><li>▪ Njehson perimetrin dhe syprinën e sipërfaqes rrethore;</li><li>▪ Zbërthen figurat jo të rregullta në figura të thjeshta dydimensionale për të gjetur perimetrin dhe syprinën e tyre;</li><li>▪ Përdorë formulat për njehsimin e perimetrit dhe syprinës së sipërfaqeve shumëkëndëshe dhe rrethore në detyra nga jeta e përditshme;</li><li>▪ Skicon objektet tredimensionale nga modelet dhe</li></ul>
	Matja	
	Trupat gjeometrik (prizmi dhe piramida)	

		<p>vizatimet;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Hulumton dhe raporton për shfrytëzimin e instrumenteve matëse në projekte të ndryshme, në shtëpi, punishte dhe në komunitet;</li> <li>▪ Identifikon figurat dydimensionale në rrjetin e prizmit dhe të piramidës;</li> <li>▪ Zbulon formulat për njehsimin e sipërfaqes së prizmit dhe të piramidës duke shfrytëzuar rrjeta përkatëse;</li> <li>▪ Zbulon formulat për njehsimin e vëllimit të prizmit dhe të piramidës të rregullt;</li> <li>▪ Hulumton dhe raporton për zgjidhjen e problemeve të ndryshme në shtëpi, punishte dhe komunitet që kanë të bëjnë me trupat gjeometrik (prizmi, piramida).</li> </ul>
<p><b>Të dhënat dhe probabiliteti</b></p>	<p><b>RNF</b> Nxënësi:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Demonstron njohuri për grumbullimin dhe paraqitjen e të dhënave, lexon, përvetëson dhe interpreton të dhënat për të marrë vendime;</li> <li>2. Përdorë terminologjinë matematikore (p.sh., modë, medianë, mesatare aritmetike, frekuencë relative, absolute, probabilitet etj) për të përshkruar situata të ndryshme nga statistika dhe nga jeta e përditshme;</li> <li>3. Arsyeton konceptet e probabilitetit përmes koncepteve elementare;</li> <li>4. Përdor teknologjinë për zgjidhjen e problemeve nga statistika dhe probabiliteti dhe nga jeta e përditshme.</li> </ol>	
	<p>Statistika</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Grumbullon të dhënat statistikore për dukuritë që na rrethojnë;</li> <li>▪ Paraqet të dhënat e grumbulluara në tabela;</li> <li>▪ Ndërton diagrame në bazë të të dhënave të grumbulluara;</li> <li>▪ Cakton vlerat mesatare: mesataren aritmetike, modën dhe medianën;</li> <li>▪ Cakton frekuencën absolute dhe relative të një grupi të dhënash.</li> </ul>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përdor teknologjinë për zgjidhje të problemave nga jeta në situata reale.</li> </ul>
	Probabiliteti	<p>Nxënësi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Parashikon mundësinë ( me dallime të mëdha );</li> <li>▪ Përdorë probabilitetin në jetën e përditshme;</li> <li>▪ Bën provën, e mundur, e pamundur;</li> <li>▪ Jep konceptin e probabilitetit.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Metodologjitë e mësimdhënies së matematikës në klasën shtatë bazohen në parimet e mësimdhënies të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë II, e cila ofron një mësimdhënie që zhvillon kompetencat e të nxënit. Temat që paraqiten në programin e klasës së shtatë zhvillohen si të integruara në mes vete, në vijimësi e atyre temave të zhvilluara në klasën paraprake si dhe të jenë të lidhura me fusha të tjera. Rezultatet e të nxënit për secilën temë shërbejnë edhe për kërkesat dhe nocionet që synojnë edhe tema të tjera brenda dhe jashtë fushës kurrikulare.

Mësimdhënësi duhet të përqëndrohet kryesisht në:

- lidhjen e rezultateve të të nxënit të kompetencave kryesore me rezultatet e të nxënit për kompetencat e fushës dhe rezultateve të të nxënit për tema;
- mësimdhënie me nxënësin në qendër;
- mësimdhënie dhe të nxënit e integruar;
- zhvillimi i temave ndërkurrikulare;
- zhvillimi i veprimtarive për arsimim të qëndrueshëm.

Mësimdhënësi duhet ta ndërtojë punën e vet mbi:

- përcaktimin e temës për t'u zhvilluar;
- listimin e metodave, teknikave dhe strategjive të cilat bazohen në ndërveprim;
- mundësimin në qasje në të gjitha mjetet e domosdoshme që u nevojiten nxënësve, motivimin, nxitjen dhe lavdërimin e përhershëm të nxënësve;
- informimin dhe mbajtjen në lidhje të vazhdueshme me prindërit për progresin e fëmijve të tyre.

Mësimdhënia e matematikës duhet të bëhet me metoda të avancuara dhe me forma moderne të punës me një qasje njohëse që përfshin zhvillimin konceptual, njohuritë dhe miratimin e skemave kuptimplote. Përdorimi i metodologjive efikase në procesin e të nxënit është kusht në rritjen e cilësisë së arritjeve nga ana e nxënësve, pasi i jep secilit nxënës mundësinë të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin që zotëron brenda vetes.

Nxënësit duhet të trajnohen për të punë të pavarur, punë në çifte, grupe të vogla dhe të mëdha, meqë kjo jep mundësi për të treguar guxim në zbulimin dhe eksplorimin e ri e të panjohur, të respektojnë rregullat, vlerat, qëndrimet personale dhe të tjerëve, për të zhvilluar aftësitë e komunikimit dhe punën ekipore. Përmes qasjes së nxënies me kompetenca mësimdhënësi mundëson dhe lehtëson hulumtimin dhe identifikimin e përvojave të nxënësve, të njohurive dhe pikëpamjeve të tyre, të cilat mundësojnë zhvillimin e tyre duke marr parasysh dallimet mes nxënësve në klasë.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Matematika ka një shumëllojshmëri të aplikimeve në jetën e përditshme dhe është e lidhur ngusht me shumë komponente të arsimit, e që njëkohësisht kontribuon në realizimin e këtyre temave: ngrohja globale, burime të përhershme e të pashtershme, njohja e kulturave, zhvillimi i qëndrueshëm, bashkëjetesa paqësore, planifikimi i buxhetit dhe edukimit mediatic, etj. Nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme, duhet të përdorë arsyetimin matematik dhe elemente të gjuhës matematikore, në mënyrë që të qartësojë dhe të shpjegojë çështje të ndryshme që lidhen me realizimin e tyre. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave matematikore me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave.

Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në ngritjen e tij personale. Nxënësi mund të përdorë metodat statistikore si anketa, intervista për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të asyetojë dhe argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë, në shkollë dhe jashtë shkolle, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

Duke përdor të kuptuarit për numrat, arsyetimin e raporteve, interpretimin e përqindjeve, nxënësi mund të ushtrojë gjykimin e tij kreativ dhe kritik për konsumimin dhe përdorimin e mallërave të konsumit. Njohuritë statistikore dhe probabiliteti mund të ndihmojnë nxënësin të interpretojë të dhëna për promovimin e shëndetit të mirë, traditës e zakoneve të jetesës dhe për të ushtruar gjykimin, argumentimin për vendimet e marra. Realizimi i temave ndërkurrikulare nëpërmjet lëndës së matematikës është një komponent i rëndësishëm i programit për kontributin e matematikës në shoqëri dhe në jetën e përditshme.

## **Udhëzime për vlerësim**

Në përputhje me parimet e qasjes së të nxënies bazuar në kompetenca, vlerësimi konsiderohet si element i mësimdhënies i cili përqendrohet në nivelin e arritjes së kompetencave. Vlerësimi i përmbajtjes lidhet me zotërimin e njohurive dhe demonstrimin e aftësive matematikore nëpërmjet treguesve të besueshëm për progresin e nxënësve. Gjatë vlerësimit mësimdhënësi, duhet të ketë

parasysh rezultatet e të nxënësve për tema mësimore të klasës, duke i pasur në fokus rezultatet e fushës për shkallë. Vlerësimi i arritjes së nxënësve të klasës së shtatë nga matematika realizohet nëpërmjet: evidencës së vlerësimeve të vazhdueshme, vëzhgimit në klasë, detyrave kontrolluese (testeve tematike), paraqitje me gojë, detyrave të shtëpisë, vlerësimit përmes testeve përmbledhëse periodike. Raportimi i të arriturave të nxënësve bëhet përmes përshkrimeve me komente konstruktive dhe me nota numerike (1-5).

Gjatë vlerësimit mësimdhënësi duhet të fokusohet dhe të mbështetet në një sasi të dhënash si: vlerësimi i përgjigjeve me gojë, puna në grup, aktivitetit gjatë debateve në klasë, detyrat e shtëpisë, testet për një grup temash të caktuara, testet në përfundim të një periudhe të caktuar mësimore, etj.

## **Udhëzime për materiale dhe burimet mësimore**

Gjatë mëimit të matematikës mësimdhënësi jep informacione dhe performon shkathtësi duke përdorur materiale didaktike dhe burime të nevojshme, ndërsa nxënësi **gjeneron** informacione dhe **formon** shprehje si dhe zhvillon shkathtësi duke i'u qasur të mësuarit përmes të pamurit, të dëgjuarit, prekjes, përdorimit të teknologjisë dhe formave të tjera.

Për realizimin e kompetencave të nivelit të dytë të arsimit të mesëm të ulët për klasën e shtatë, mësimdhënësi siguron qasje përmes përdorimit të materialeve të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit.

Mësimdhënësi, përveç materialeve dhe mjeteve të nevojshme didaktike, burimeve të besueshme të ndryshme nga interneti, krijon modele matematike, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të llojeve të ndryshme, krijon mjedis dhe klimë për aktivitete alternative. Ai po ashtu ofron edhe mjete teknike dhe teknologjike për të zhvilluar aftësitë e tij në mësimin e matematikës. Mësimdhënësi, u krijon mundësi nxënësve të demonstron apo prezentojnë detyra dhe projekte të ndryshme.

# **FUSHA KURRIKULARE: SHKENCAT E NATYRËS**

## **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Fizikë  
Biologji  
Kimi

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Fizikë

## **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Shkenca është veprimtari intelektual dhe praktike që përfshin studimin sistematik të strukturës dhe sjelljes së botës fizike dhe natyrore, përmes vëzhgimeve dhe eksperimenteve

Mësimi i lëndës së fizikës, për klasën e shtatë, iu ofron nxënësve mundësi për të zhvilluar; të kuptuarit e koncepteve dhe të proceseve shkencore, të praktikave të përdorura nga njeriu për zhvillimin e njohurive shkencore, të kontributit të shkencës në shoqëri dhe të zbatimeve të saj në jetën e përditshme.

Fizika është shkencë dinamike dhe evolutive, prandaj dijet tona për natyrën vazhdimishtë përparojnë në cilësi, për këtë arsye ndihet nevoja e freskimit të vazhueshëm të planit mësimor .

Fusha kurrikulare „Shkencat e natyrës” në shkallën e III kurrikulare paraqet vazhdimësinë e asaj që është arritur në kuadër të shkollës fillore.

Lënda mësimore, Fizika VII, më së shumti kontribuon në konceptin e fushës kurrikulare –

„proceset fizike” por edhe në konceptet tjera. Pikë referimi për lëndën Fizika VII, paraqesin rezultatet e të nxënësve të kompetencave dhe rezultatet e të nxënësve të fushës, shkalla III kurrikulare.

Përmes mëimit të Fizikës, kontribuojmë që nxënësi të arrij kompetencat e synuara sipas Kurrikulës Bërthamë për shkallën e tretë dhe arritjen e rezultateve të fushës, të parapara për klasën e shtatë.

Rezultatet lëndore, pika referente kanë temat: Lënda e studimit të fizikës, matjet themelore, lëvizjet e thjeshta, forcat ( llojet dhe baraspeshimi i tyre), puna, energjia dhe fuqia, gjendjet agregate dhe temperatura, makinat e thjeshta dhe zëri.

## Qëllimi

Programi në shkencat e natyrës ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të nxënësit, duke gërshetuar të nxënësve teorik me metodat e hulumtimit (vrojtimin të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator ose në teren, burimeve të ndryshme mësimore, përpunimit të informatave dhe prezentimit të të gjeturave etj.). Kjo iu mundëson nxënësve që aktivisht të zhvillojnë kompetencat e tyre dhe në saje të kërkimeve; të kuptojnë, shpjegojnë dhe ndërhyjnë në ndërlidhjen e jetës me natyrën.

Qëllimet e fushës së shkencave të natyrës janë konceptuar në funksion të të nxënësve gjatë gjithë jetës. Përmes lëndës së fizikës nxënësit:

- zhvillojnë njohuritë dhe konceptet bazë për formimin shkencor në fushën e fizikës;
- zbatojnë njohuritë dhe aftësitë shkencore në mënyrë analitike, kritike dhe krijuese në problemet që kërkojnë zgjidhje dhe marrje vendimesh;
- vlerësojnë kontributin e shkencës dhe të teknologjisë për mirëqenien e njeriut dhe të shoqërisë;
- shpjegojnë proceset përmes katër bashkëveprimeve (gravitetit, elektromagnetik, bërthamor dhe bashkëveprimi i dobët);

- përdorin teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, si mjet për sigurimin dhe komunikimin e informacionit;
- shpjegojnë rolin e shkencës në zhvillimin e qëndrueshëm, si edhe në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit.

Të gjitha këto aftësi, shkathtësi, qëndrime, vlera dhe motivim, arrihen duke synuar kompetencat e përgjithëshme të parapara për shkallën e caktuar, dhe në mënyrë të veçantë përmes shkencave natyrore – të përmbledhura në rezultate të të nxënit për lëndë.

### **Temat dhe rezultatet e të nxënit**

Përmbajtja e lëndës së fizikes është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënit lëndore (RNL).Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës përfshin gjashtë koncepte; të zërthyera në koncepte specifike (domene),në tema dhe rezultateve të të nxënit lëndorë,me anë të të cilave përfshihet fondamenti i fushës së shkencës në lëndën përkatëse.

**Domeni: I.** Lëvizja; **II.** Struktura e lëndës; **III.**Bashkëveprimi; **IV.**Energjia

Konceptet	Tërësitë tematike	Rezultatet e të nxënit.
Proceset fizike	1.Lënda e studimit të fizikës	<p><b>I,II,III dhe IV.</b>  <b>Nxënësi:</b>  - shpjegon fizikën si shkencë të natyrës që studion vetitë, strukturën dhe shndërrimet e materies dhe i formulon në formë të rregullave dhe ligjeve.  -dallon dy metodat themelore të studimit të fizikës të njohura si fizikë eksperimentale dhe fizikë teorike.  -shpjegon fizikën si zbuluse të msheftësive të natyrës, matematikën si artikuluese të tyre në formë të ligjeve, kurse inxhienerinë si aplikuese në prodhimtari.  -vlerëson saktësinë e ligjeve të fizikës ndaj saktësisë së zbatimit të tyre nga inxhinierët, të bazuar në faktin se prodhimet e dizajnuara nuk gjykohen për nga vërtetësia e tyre.</p>
	2. Matjet themelore	<p><b>II</b>  -vlerëson saktësinë e matjeve në fizikë me veglëri, sipas ndjeshmërinë së shkallës së tyre dhe pozitës së syrit.  -emërton veglëritë gjegjëse për matje të gjatësisë, kohës, masës dhe temperaturës, të bazuar në qëllimin e matjes.  -përcakton gjatësinë e ndonjë objekti dhe trupave të hollë me veglëri përkatse.  -shpreh vlerën e ndonjë sipërfaqe dhe vëllimin e ndonjë trupi me nënfisha të ndryshëm të njësisë themelore.  -njehson vëllimin e trupave të rregulltë dhe <b>demonstron</b> përcaktimin e vëllimit të trupave të parregulltë.  -vlerëson saktësinë e matjes së kohës së një ndodhie, me orë mekanike, kronometër dhe me orë numerike.  -shpjegon masën e trupit me ndihmën e vetive të saj.  -<b>demonstron</b> matjen e masës së trupave të njëjtë me peshore mekanike dhe peshore numerike dhe vlerëson saktësinë e tyre.  -<b>demonstron</b> përcaktimin e dendësisë së trupave të parregulltë dhe të lëngjeve.  -<b>demonstron</b> përcaktimin e dendësisë të lëndëve të ndryshme me vëllime të njëjta, (psh. kubëza prej <math>1\text{cm}^3</math> ).  -dallon dendësinë e trupit në lëng nga dendësia e lëngut dhe paraqet raportin e tyre për zhytje, notim dhe pluskim të tij.  -<b>demonstron</b> matjen e vëllimit të lëngjeve me shiringë dhe enë të shkallëzuara dhe temperaturën e përzierjes së ujit me akull me termometër meteorologjik; me shkallë pozitive, zero dhe negative.  -zgjidhë detyra numerike për dendësi, masë dhe vëllim të trupave dhe lëngjeve dhe për shndërrimin e njësive gjegjëse.</p>



	<b>3.Lëvizjet e thjeshta</b>	<p><b>I.</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-përkufizon shpejtësinë e njëtrajtshme drejtvizore në bazë të vlerave paraprake tabelare, për rrugën e kaluar <math>s</math> dhe kohën <math>t</math> të lëvizjes së ndonjë trupi.</li> <li>-vizaton grafikun <math>s/t</math> dhe grafikun <math>v/t</math> për <math>v = \text{konst.}</math> dhe përfiton formulën e rrugës nga sipërfaqja mes gjysmëdrejtzës <math>v = \text{konst.}</math> dhe boshtit <math>t</math>.</li> <li>-vizaton në grafikun <math>s/t</math>, për dy-tre trupa që lëvizin, vlerat përkatëse të rrugës <math>s</math> dhe kohës <math>t</math> dhe nga pjerrtësia e gjysmëdrejtzave nxjerr përfundim për shpejtësi të tyre.</li> <li>-shndërron njësinë e shpejtësisë nga m/s në km/h dhe anasjelltas.</li> <li>-shpreh formulën e nxitimit të lëvizjes së trupit dhe shpjegon shpejtësinë e rënjes së lirë si lëvizje të nxituar me nxitim konstant <math>g</math>.</li> <li>-zgjdhë detyra numerike për njehsimin e shpejtësisë, rrugës, kohës dhe nxitimit.</li> </ul>
	<b>4. Forcat dhe lëvizja</b>	<p><b>I dhe III</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-identifikon forcën si madhësi fizike, që karakterizon bashkëveprimin reciprok të trupave( tërheqje dhe refuzim) dhe kushtëzon ose ndërrim të shpejtësisë, ose deformim të trupit.</li> <li>-shënon njësinë e forcës dhe emërton forca sipas llojit të bashkëveprimit.</li> <li>-identifikon peshën e trupit si forcë dhe e dallon nga masa sipas njësive matëse.</li> <li>-<b>demonstron</b> matjen e masës dhe peshës si dhe përcakton raportin mes tyre duke matur të njëjtët trupa me vegëlritë përkatëse: peshore, dinamometër etj.</li> <li>-<b>demonstron</b> shembuj të veprimit të forcës në trup të shoqëruar me kundërveprimin e tij.</li> <li>-<b>demonstron</b> zgjatjen e sustës elastike, në varësi të disa peshave të varura në të dhe njehson raportin <math>F/x</math> që paraqet ligjin e Hukut për elasticitet.</li> <li>-shpjegon fërkimin e qetësisë, të lëvizjes dhe të rrotullimit, rolin e tij në jetën e përditshme dhe mënyrat e zvogëlimit të tij.</li> <li>-<b>demonstron</b> vartësinë e forcës së fërkimit nga pesha e trupit dhe pavarësinë nga madhësia e sipërfaqes takuese të tij.</li> <li>-<b>demonstron</b> baraspeshimin e forcave, përcaktimin e qendrës së rëndimit të trupave të rregullt, të sipërfaqeve të rregullta dhe të parregullta.</li> <li>-zgjdhë detyra numerike për forca dhe veprimet e tyre.</li> </ul>
		<p><b>IV</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-përkufizon punën mekanike dhe analizon vartësinë e saj nga madhësitë e përkufizimit.</li> <li>-analizon vartësinë e energjisë kinetike dhe energjisë potenciale nga madhësitë e përkufizimit.</li> <li>-shpreh lidhmërinë e punës me energji dhe interpreton nxehtësinë, si energji që bartet nga trupi në trup.</li> </ul>

	<b>5. Puna dhe energjia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>-interpretton ligjin e ruajtjes së energjisë bazuar në shembuj të shndërrimit të saj.</li> <li>-identifikon shpjeguesin e kryerjes së punës dhe shpreh njësisë së saj me njësi të punës.</li> <li>-analizon rendimentin e aparaturave të shfrytëzimit të shndërrimit të energjisë.</li> <li>-zbaton ligjin e ruajtjes së energjisë, për <b>demonstrim</b> të bartjes së energjisë së saj, gjatë goditjes së sferës elastike në tokë.</li> <li>-vlerëson rolin e energjisë në zhvillimin e shoqërisë bashkëkohore.</li> <li>-njehson numerikisht detyra për njehsimin e punës, energjisë dhe fuqisë.</li> </ul>
	<b>6. Zëri dhe përhapja e tij.</b>	<p><b>I dhe IV</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-<b>demonstron</b> ngjeshjen dhe zgjatjen e sustës elastike, si analog, mekanik, të dendësimeve dhe rrallimeve të grimcave të mjedisit nëpër të cilët përhapet zëri.</li> <li>-tregon burimet e zërit, karakteristikat fizike dhe përhapjen e tij, si trajtë të energjisë që regjistrohet me vesh dhe aparatura.</li> <li>-<b>demonstron</b> zvogëlimin e intensitetit të zërit me largësi.</li> <li>-<b>demonstron</b> me pirun akustik, ndërrimin e dendësisë (shtypjes) së ajrit gjatë përhapjes së zërit.</li> <li>-ilustron pjesët e veshit të njeriut dhe parimin e regjistrimit të zërit me vesh dhe vegël akustike.</li> <li>-shpjegon vartësinë e shpejtësisë së përhapjes së zërit në ajër nga temperatura me formulë të redukuar.</li> <li>-<b>demonstron</b> përhapjen e zërit në ajër, ujë dhe trupa të ngurtë të dendësive të ndryshme.</li> <li>-<b>demonstron</b> mospërhapjen e zërit në boshllëk.</li> <li>-përshkruan karakteristikat themelore subjektive të zërit dhe dallon llojet e tij sipas frekuencës.</li> <li>-shpjegon krijimin e jehonës dhe shfrytëzimin e saj për përcaktimin e shpejtësisë së përhapjes së zërit në ajër dhe largësisë së ndonjë objekti (sonari).</li> <li>-zgjidhë detyra numerike për shpejtësi të përhapjes së zërit dhe përcaktim të temperaturës së ajrit.</li> </ul>
	<b>7. Gjendjet agregate</b>	<p><b>I dhe IV</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-dallon trupat e ngurtë, lëndët e lëngta dhe lëndët e gazta dhe krahason vetitë e tyre sipas dendësisë, ngjeshmërisë dhe mënyrës si e zënë hapësirën.</li> <li>-shpjegon dallimin mes trupave të ngurtë, lëndëve të lëngëta dhe lëndëve të gazta me modelin grimcorë të ndërtimit të tyre dhe mënyrës së lëvizjes së grimcave.</li> <li>-<b>demonstron</b> mënyrët si mund të diktohen grimcat e lëndës (molekulet dhe atomet).</li> <li>-përshkruan tri gjendjet agregate të lëndës dhe kalimet nga një gjendje në tjetrën me nxehtësitë latente dhe sublimim, (ngjirje, shkrirje, avullim dhe lëngzim).</li> <li>-<b>demonstron</b> zvogëlimin e pikës së shkrirjes së akullit me zmadhimin e shtypjes dhe e shpjegon me modelin</li> </ul>

		<p>grimcorë të ndërtimit të lëndës.</p> <p><b>-demonstron</b> ndërrimin e vëllimit dhe dendësisë së trupit me temperaturë dhe debaton për anomalinë e ujit.</p> <p>-shpjegon reshjet atmosferike dhe mënyrat e krijimit të tyre.</p> <p>-identifikon kalimet e energjisë në biosferë në formë të rrymave ajrore, vullkaneve, gejzereve, rrymave detare etj</p>
<p><b>8. Parimi i punës së makinave të thjeshta.</b></p>		<p><b>III dhe IV</b></p> <p>-tregon lloje të makinave të thjeshta që kryejnë veprime për ndryshim të drejtimit, shumëfishues të forcës apo shumëfishues të distancës dhe shpjegon rregullën e artë të mekanikës sipas Galileit.</p> <p>-përkufizon përparësinë mekanike (herësin e forcave) <math>\alpha</math> dhe herësin e shpejtësive (herësin e distancave) <math>\beta</math> të makinës së thjeshtë dhe arësyeton a janë më të mëdha, apo më të vogla se një për një shumëfishues të forcës dhe shumëfishues të distancës.</p> <p>-paraqet formulën e përkufizimit të efiçencës <math>\eta</math> të makinës së thjeshtë dhe mundësinë e paraqitjes së saj me ndihmën e përparësisë mekanike <math>\alpha</math> dhe herësit të shpejtësive <math>\beta</math>.</p> <p>-klasifikon llozet në bazë të pozitive relative të përpjekjes, ngarkesës dhe pikëmbështetjes, e poashtu, përcakton përparësinë mekanike <math>\alpha</math>, herësin e shpejtësive <math>\beta</math>, efiçencën <math>\eta</math> dhe llojin e veprimit që kryejnë.</p> <p><b>demonstron</b> punën me rrafsh të pjerrët duke e ndryshuar këndin e tij, përcakton madhësinë <math>\beta</math> dhe tregon llojin e veprimit që kryen.</p> <p><b>-demonstron</b> baraspeshimin mes trupave në anë të llozit në pikë mbështetëse, (momenti i forcave, peshorja, kolovajza), punën me rrotull të përforcuar dhe me një rrotull të lëvizshme.</p> <p>-zgjidhë detyra numerike për njehsimin e përparësisë mekanike <math>\alpha</math>, herësin e shpejtësive <math>\beta</math> dhe efiçencën <math>\eta</math> të disa makinave të thjeshta.</p>

## Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për shkencat natyrore- fizike, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj në realizimin e aktiviteteve kurrikulare poashtu aktiviteteve jashtëkurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive duke u harmonizuar me rezultatet e pritshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur çasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, punë me projekte, punë praktike e të tjera.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimdhënësit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me natyrën e përmbajtjes së temës mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësve etj.

Shkencat e natyrës janë shkenca eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur, të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësve në lëndët e shkencave të natyrës varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur çasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, këshillohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

Mësimdhënie e drejtëdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);

\* Mësimdhënie joedrejtëdrejt (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);

\* Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);

\* Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);

\* Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;

\* Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;

\* Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;

\* Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;

\* Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;

\* Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënësve në lëndën e fizikës janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënësve të tyre.

Në lëndën e fizikës, kërkimi shkencor është baza e kompetencave.

Metodat që mund të përdorin në lëndën e fizikës janë:

- vëzhgimi,
- modelimi,
- metodat eksperimentale dhe empirike,
- formimi i një ideje (hipoteze)
- përdorimi i TIK-ut.

Këto metoda nuk mund të përdoren pa u kombinuar me njëra-tjetrën.

**Metoda e vëzhgimit:** është një metodë që i ndihmon nxënësit në formimin e koncepteve shkencore. Nëpërmjet kësaj metode nxënësit bëjnë lidhjen ndërmjet koncepteve abstrakte dhe objekteve, organizmave apo dukurive të botës reale. Kur vëzhgojnë objekte, organizma apo dukuri, nxënësit përdorin njohuritë shkencore. Vëzhgimet i ndihmojnë ata për të krijuar përfytyrime të qëndrueshme për botën që na rrethon. Vëzhgimet në natyrë i nxisin nxënësit të punojnë në mënyrë shkencore, të ngrenë hipoteza dhe t'i testojnë ato. Vëzhgimi, është hapi i parë i një hetimi, eksperimenti apo studimi.

**Modelimi:** nënkupton ndërtimin e një situatë abstrakte që është e vështirë për t'u vëzhguar ose e pamundur për t'u parë. Ky modelim paraqitet nëpërmjet një teksti, vizatimi, formule matematikore, ekuacioni në formën e një softwar-i programi. Është me shumë rëndësi të kuptohet situata në të cilën është krijuar modelimi. Përveç të tjerave, modelimi duhet t'i ndihmojë nxënësit të kuptojnë realitetin, të shpjegojnë karakteristikat e këtij realiteti dhe të parashikojnë një dukuri.

**Metoda eksperimentale:** fillon me shpjegime teorike shkencore dhe vazhdon me demonstrimin e eksperimentit. Qëllimi i procedurës është të identifikojë dhe të krahasojë elementet e vëzhgueshme sasiore dhe të kontrollojë vërtetësinë e hipotezave të ngritura. Gjatë përdorimit të kësaj metode, nxënësit përdorin një sërë aparaturash për të bërë matje, si dhe tregojnë kujdes gjatë përdorimit të tyre.

**Metoda empirike:** bazohet në modelet intuitive dhe siguron një mënyrë për të eksploruar elementet e një problemi. Kjo metodë udhëheq ide, hipoteza, teori dhe teknika të reja për një studim kërkimor më të detajuar.

**Projektet:** janë veprimtari të nxënësve nëpërmjet të cilave nxënësit zbulojnë objektet, proceset apo dukuritë.

TIK- Teknologjia e informacionit: mbështet procesin kërkues, rrit cilësinë e të nxënësve dhe siguron bashkëpunimin mes tyre. Përmes përdorimit të mjeteve digjitale, nxënësit mund të eksplorojnë dhe të perceptojnë konceptet abstrakte, si dhe të zbulojnë marrëdhëniet ndërmjet objekteve dhe dukurive.

Format e punës

- individuale,
- në çifte,
- në grupe të vogla,dhe
- me të gjithë nxënësit.

Arsimtari i udhëheq nxënësit ashtu, që ata me aktivitetet e tyre në klasë, shkollë, laborator, natyrë etj., të mund të: njohin, vrojtojnë, radhisin, masin, shënojnë, mbledhin të dhënat, eksperimentojnë, mbikëqyrin, mendojnë në mënyrë të pavarur, mbrojnë dhe argumentojnë mendimet e tyre, por duke u nisur gjithmonë nga parimet didaktike: prej të njohurës kah e pa njohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.

## Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Konceptimi i programit të fushës së shkencave natyrore është mbështetur në parime të mirëfillta të integritit, si mes lëndëve të vetë fushës ashtu dhe të fushës me fushat e tjera.Për t'i siguruar nxënësit një mësim të integruar është e rëndësishme lidhja e fushës së shkencave natyrore me fushat e tjera dhe specifikisht me lëndët e këtyre fushave.

Nxënësi nuk mund të perceptojë realitetin dhe të njohë botën që e rrethon, vetëm nëpërmjet studimit të lëndëve që i përkasin fushës së shkencave natyrore. Fusha e shkencave natyrore është ngushtësisht e lidhur **me fushën e matematikës**.

**Matematika** u ofron lëndëve të shkencave natyrore shumë njohuri që janë të përdorshme për studimin e saj. Për shembull: kur nxënësi kryen një kërkim shkencor, i duhet shpesh të bëjë matje, llogaritje, të gjejë mesataren aritmetike, të zotërojë koncepte të gjeometrisë së zbatuar, si dhe të vizualizojë hapësirën. Nxënësi përdor gjuhën matematikore për të shpjeguar ligjet e fizikës dhe për të vendosur lidhjen ndërmjet ndryshoreve, si p.sh., në fizikë ndërmjet forcës, masës dhe nxitimit. Përdorimi i grafikëve, simboleve, formulave e bëjnë matematikën një pasuri të madhe në shërbim të shkencave të natyrës. Gjithashtu, duke studiuar shkencat e natyrës, nxënësi zhvillon kompetencat e problemzgjidhjes, hetimit, arsytimit logjik, lidhjes konceptuale ndërmjet madhësive, si dhe modelimeve .

## Gjuhët dhe komunikimi

Për të analizuar dhe vlerësuar rezultatet gjatë studimit të dukurive dhe ligjeve në shkencat natyrore nxënësi duhet të zhvillojë kompetencën e komunikimit dhe të përdorë drejt gjuhën dhe terminologjinë e shkencës. Nëse nxënësi lexon, shkruan apo shpreh rrjedhshëm mendimet e tij rreth informacioneve shkencore mbi gjithësinë, lëndët, ndotësit e ajrit, ujit, ai zhvillon saktë kompetencën e komunikimit në gjuhën shqipe, që ndjeshëm zhvillohet në fushën” **Gjuhët dhe komunikimi**”. Edhe lëndët e shkencave të natyrës kontribuojnë në zgjerimin dhe përpunimin e fjalorit të nxënësit, duke e nxitur atë të parashtojë qartë dhe saktësisht idetë e tij, me gojë ose me shkrim. Punët praktike dhe eksperimentale, të cilat janë bazë për zhvillimin e kompetencave të kësaj fushe, i japin nxënësit mundësitë që të zhvillojë kompetencën e komunikimit gjuhësor dhe të pasurojë fjalorin terminologjik përmes diskutimeve mbi përshkrimin e punëve praktike dhe laboratorike dhe shpjegimit të rezultateve të tij. Termat e ndryshme, që përdoren në fushën e shkencave të natyrës, janë specifike për fushën dhe ndihmojnë nxënësin për zhvillimin e kompetencës së komunikimit në gjuhën dhe terminologjinë e saj.

**Lidhja e kompetencave të fushës së shkencave natyrore me kompetencat e fushave të tjera si:**

**Shoqëria dhe mjedisi:** trajton mjedisin natyror-shoqëror si një pasuri, e cila duhet të ruhet dhe të shfrytëzohet për të mirat e shoqërisë.

**Edukata fizike, sportet dhe shëndeti:** mbron shëndetin duke respektuar rregullat e lëvizjeve trupore, aktiviteteve të lojërave sportive individuale dhe kolektive dhe të organizimit të pushimit.

**Jeta dhe puna:** bashkëpunon në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të përcaktuara, duke shfaqur shkathtësi manovruese në përdorimin e veglave, pajisjeve dhe teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit për të marrë informacione gjatë hulumtimeve; mendimi kritik, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja, kreativiteti dhe inovacioni.

### **Temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media,
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë, dhe
- Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

### **Edukimi për media**

I referohet përdorimit të mediave për sigurimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit

për media përfshin përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet për të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

### **Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë**

Aftësitë për jetën ndihmojnë nxënësit të marrin vendime të mirëinformuara, të zgjidhin probleme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyrë të efektshme, intelektuale dhe emocionale me të tjerët, si dhe të ndërtojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme dhe të sigurt. Gjatë zhvillimit të kësaj çështje rrisin sigurinë e shëndetit të tij dhe të tjerëve, në mënyrë që të jenë të aftë të ndërtojnë hapa të sigurt, në mjedisin e tyre, të dallojnë vlerat e shumëfishta, për vete dhe për të tjerët

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm, që ndërlidhet me vetëdijësimin dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

### **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para



nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - fizikë, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumenta vlerësues, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me Udhëzimin Administrativ - UA të miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkoj mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe t'ju shpërndahet në formë fizike të gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga çasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të kompetencave në shkencat e natyrës- fizike është e nevojshme të shfrytëzohen mjete dhe materiale të ndryshme mësimore si dhe mjedis i përshtatshëm mësimor.

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i;
- Mjedis mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Biologji**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Bazuar në RNF-të e fushës kurrikulare „Shkencat e natyrës” gjegjësisht të koherencës me programin e klasës së gjashtë, si dhe ruajtjes së filozofisë, nga e përgjithshmja në drejtim të specifikës, nga më shumë e njohura në drejtim të së panjohurës, programi për klasën e shtatë krijon hapësirën e nevojshme që nxënësve të kësaj klase t’u sigurohet baza e nevojshme për biologjinë e njeriut, si dhe shumimi i qenieve të gjalla (bimët, shtazët dhe njeriu) e paraparë me kurrikulë të Kosovës, e pranueshme për shkollat tona dhe e përdorshme për rrethanat tona. Në këtë kontekst, përmbajtja e propozuar e programit të biologjisë për këtë klasë, është e bazuar edhe në planet dhe programet e vendeve të tjera në rajon e më gjerë dhe i kontribuon zhvillimit të kompetencave të nxënësve.

Përmbajtja programore e kësaj lënde është koherente, logjike dhe e aplikuar konform konceptit “Bota e gjallë” dhe kërkesave të KB-së të fusha e shkencave. Përzgjedhja e temave nga përmbajtjet specifike të biologjisë së njeriut (anatomji, fiziologji dhe morfologji), iu mundëson nxënësve të fitojnë njohuri bazë për ndërtimin dhe zhvillimin e njeriut, të aplikojnë masat preventive kundër lëndimeve me etiologji të ndryshme, të vlerësojnë pasojat e toksikomanisë si dhe të zhvillojnë qëndrime dhe vlera shoqërore. Me këto përmbajtje programore, ne konsiderojmë se, nxënësit e kësaj moshe pajisen me njohuri, shprehje, shkathtësi, qëndrime dhe vlera për t’u ballafaquar me sukses në situatat e jetës së përditshme dhe me sfidat e jetës.

Programi i lëndës mësimore - Biologjia 7, krahas kërkesës për arritjen e rezultateve të të nxënësve për fushë (RNF-ve), mundëson edhe në kontribuimin e arritjes së rezultateve të kompetencave, të përcaktuara me kurrikulën bërthamë (KB-në) të shkallës së III-të kurrikulare.

Programi i lëndës mësimore, Biologjia 7, është hartuar sipas konceptit të KK-së, me shtrirja programore në drejtim vertikal (klasa 1 – 12) dhe me shtrirje horizontale/ndërlidhje me fushat tjera kurrikulare, në harmoni të zhvillimit të nxënësit/ës.

Programi, Biologjia 7 -bazë referimi ka konceptin e fushës kurrikulare „Bota e gjallë” me rezultate të të nxënësve për lëndë (RNL), sipas temave:

- Sistemet e organeve të njeriut;
- Shumimi të njeriut;
- Shumimi të shtazët;
- Shumimi të bimët.

Detyrë e mësimin të biologjisë është: zhvillimi i aftësive vrojtuese dhe të menduarit kritik që në realitet është një formë e sofistikuar e të menduarit, përkatësisht është proces njohës, veprues dhe ndërveprues, si dhe përdorimit të mjeteve teknologjike gjatë hulumtimit shkencor.

Zhvillimi i programit mësimor të lëndës së biologjisë është ndërtuar mbi bazën e një ecurie të mirëfilltë shkencore, si nga forma, qasja metodologjike, organizimi dhe ndërtimi i përmbajtjes së

lëndës, parashtrimi i rezultateve të të nxënit për kompetenca, rezultateve të të nxënit të fushës së shkencave natyrore si dhe përzgjedhja e metodave dhe instrumentave të qëndrueshëm për vlerësim.

Baza e lëndës mësimore *Biologjia 7*, qëndron në shpjegimin e sistemeve të organeve të njeriut si dhe mënyrat e shumimit tek qeniet e gjalla.

## Qëllimi

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për kl. 7 – të ka për qëllim:

- Të zhvillojë aftësi të nxënësi për të njohur ndërtimin dhe funksionin e trupit të njeriut (organeve dhe sistemit të organeve ) si dhe për të kuptuar ligjet themelore të proceseve jetësore (shumimit).
- Të krijojë vetëdije për unitetin e ndërtimit dhe të funksionit të strukturave të organizmit të njeriut dhe të zhvillojë aftësi për të kuptuar se njeriu është qenie biologjike dhe shoqërore.
- Të fitojë shprehje për mbajtjen e higjienës personale dhe shkathtësi për zbatimin e njohurive të fituara në situata konkrete (ndihma e parë në rast të gjakderdhjeve, thyerjes së eshtrave, reanimimit etj.).
- Të kontribuojë në zhvillimin e vetëdijes së nxënësit se proceset, funksionet dhe manifestimet jetësore janë reciprokisht të kushtëzuara.
- Të zhvillohet një personalitet stabil dhe vetëkritik i aftë për t'u ballafaquar me sfidat e jetës.

Biologjia 7, ka për qëllim zhvillimin e kompetencave të nxënësit, duke gërshetuar të nxënit teorik me metodat e hulumtimit (vrojtimin të drejtpërdrejtë të eksperimenteve në laborator ose në terren, burimeve të ndryshme mësimore, përpunimit të informatave, prezentimit të gjeturave, etj.). Kjo i mundëson nxënësit që aktivisht të zhvillojë kompetencat e tij dhe në sja të kërkimeve të gjeneron informacionet; kupton, shpjegon dhe ndikon në ndërlidhjen e jetës me natyrën.

Nxënësi, përmes informatave të shumta, hulumton helbin e problemit, zhvillon të menduarit kritik, dhe zbaton shkathtësi praktike në përpunimin, analizimin, argumentimin dhe prezentimin e rezultateve të problemit të caktuar.

Programi mësimor i lëndës së biologjisë për klasën e 7-të, i mundëson dhe ndihmon nxënësin në sintezën e komponentave të kompetencave, si për:

- Njohur:
  - Tiparet kryesore të indeve, të organeve dhe të sistemit të organeve të njeriut;
  - Fjalorin (terminologjinë biologjike) nga fushat e biologjisë humane;
  - Faktet, konceptet dhe parimet që i përkasin lëmisë së biologjisë humane;
  - Procedurat dhe metodat që aplikohen në lëminë biologjike humane.

- Kuptuar:

- Se proceset, funksionet dhe manifestimet jetësore mund të sqarohen, duke u bazuar në ndërtimin e indeve, të organeve dhe të sistemit të organeve të njeriut;
- Rëndësinë e funksionimit normal të indeve të organeve dhe të sistemit të organeve për ruajtjen e homeostazës në organizëm;
- Se njeriu është qenie biologjike dhe shoqërore;
- Rëndësinë e shumëzimit për ruajtjen e kontinuitetit të jetës së llojit njeri, pas vdekjes individuale të organizmit;
- Termat dhe ligjshmëritë shkencore.

- Zhvilluar:

- Aftësitë e të shpjeguarit, krahasimit dhe vlerësimit të sistemeve të organeve të njeriut;
- Shkathësitë e zbatimit të parimeve të ndërvarshmërisë;
- Zotësitë për shpjegimin, analizimin dhe ndikimin pozitiv në jetën e qenieve të gjalla;
- Qëndrimin përgjegjës gjatë punës eksperimentuese në laborator dhe natyrë;
- Shkathësitë për të konsultuar literaturë adekuate, në mbledhjen e informatave shkencore në mënyrë të pavarur, gjatë klasifikimit të materialit burimor shkencor, gjatë promovimit të vlerave për një jetë të shëndetshme;
- Motivimin për përdorim të aparateve dhe instrumenteve teknologjike për mësim tërëjetësor.

Të gjitha këto aftësi, shkathësi, qëndrime, vlera dhe motivime, arrihen duke punuar në drejtim të arritjes së rezultateve të kompetencave për shkallën III-të kurrikulare.

## **Temat dhe rezultatet e të nxënit**

Përmbajtja e lëndës është organizuar sipas koncepteve, temave dhe rezultateve të të nxënit lëndore (RNL) në përputhje me qëllimet e përgjithshme të lëndës.

Ndërtimi i përmbajtjes së lëndës së biologjisë për klasën e shtatë, me konceptin bazë “Bota e gjallë” është zërthyer në tema mësimore, me anë të të cilave përfshihet fundamenti i fushës së shkencave. Pra, është hartuar mbi bazën e asaj se çfarë parasheh koncepti i caktuar duke e balansuar me rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-ve) dhe përmes temave (përmbledhje përmbajtësore) nga të cilat mësimdhënësit i përgatisin njësitë mësimore. Temat, janë zërthyer në rezultate të të nxënit, të përgjithësuara, e që në fakt paraqesin rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore (RNL). Koncepti filozofik i KKK-së është që shkolla respektivisht mësimdhënësi, të kenë autonomi dhe fleksibilitet në zhvillimin dhe zbatimin e programeve mësimore, bazuar në kornizën e paraparë me Kurrikulën Bërthamë (KB) si dhe programit mësimor i hartuar dhe miratuar nga MASHT, mundësohet me angazhimin dhe bashkëpunimin e mësimdhënësve brenda

shkolle. Mësimdhënësi përzgjedh burime mësimore të ndryshme, përzgjedh njësi mësimore dhe harton rezultatet e të nxënit për njësi mësimore (RNJM), të cilat mundësojnë arritjen e rezultateve lëndore.

<b>Koncepti</b>	<b>Temat</b>	RNF Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e përfshira në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.  Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.
		<b>Rezultatet e tënxënit të lëndës (RNL)</b>
<b>Bota e gjallë</b>	<b>Sistemet e organeve të njeriut</b>	-Definon termat: qelizë, ind, organ dhe sistem i organeve.  - Përshkruan ndërtimin, rolin dhe rëndësinë e lëkurës.  - Identifikon prodhimet e lëkurës.  - Hulumton llojet e lëndimeve të lëkurës dhe masat mbrojtëse.  - Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit skeletor.  - Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e sistemit muskolor.  - Identifikon, lëndimet si dhe masat mbrojtëse të e sistemit për levizje.  -Përshkruan procesin dhe rrugën e tretjes së ushqimit te njeriu.  -Vlerëson rolin e organeve të veçanta në procesin e tretjes.  - Vlerëson rëndësin e mbrojtjes së sistemit të organeve të tretjes.  -Hulumton dhe përshkruan ndërtimin dhe funksionin e
	Njeriu ka nevoja të ndryshme jetësore, të cilat i plotësojnë në rrugë të ndryshme nëpërmjet funksionit të organeve dhe të sistemeve të organeve si:  Mbulesa trupore-lëkura Sistemi i lëvizjes Sistemi i organeve të tretjes Sistemi i qarkullimit të gjakut Sistemi i frymëmarrjes Sistemi i	

	ekskretimit Sistemi nervor Shqisat dhe Sistemi endokrin	<p>sistemit të qarkullimit të gjakut.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Hulumton përbërjen, rolin dhe rëndësinë e përbërësve të gjakut dhe limfës.</li> <li>- Analizon ndërtimin dhe punën e zemrës.</li> <li>- Sqaron konceptet: imunitet, alergji dhe identifikon grupet e gjakut.</li> <li>-Emërton rrugët e frymëmarrjes, përshkruan ndërtimin dhe funksionin e tyre.</li> <li>- Përshkruan mekanizmat e frymëmarrjes mushkërore dhe rregullimin e saj.</li> <li>-Vlerëson rolin dhe domosdoshmërin e ruajtjes së organeve të frymëmarrjes si dhe faktorët që demtojnë organet e frymëmarrjes.</li> <li>-Definon termin tajitje dhe të emërton organet kryesore për tajitje te njeriu.</li> <li>-Analizon krijimin e urinës.</li> <li>-Hulumton mundësitë e ruajtjes së sistemit të ekskretimit.</li> <li>-Hulumton ndërtimin dhe funksionimin e sistemit nervor.</li> <li>-Analizon ndervatësin e pjesëve të sistemit nervor.</li> <li>-Analizon harkun reflektiv.</li> <li>-Analizon mundësi për kujdesin ndaj sistemit nervor dhe pasojat në rast dëmtimi.</li> <li>-Emërton dhe përshkruan organet shqisore në trupin tonë (shqisës së të parit, dëgjuarit, ekuilibrit, shijes, nuhatjes, shqisave lëkurore) si dhe analizon funksionin e tyre.</li> <li>-Identifikon dëmtimet dhe masat mbrojtëse të shqisave.</li> <li>-Emërton gjëndrat me tajitje të brendshme te njeriu dhe përshkruan pozitën e tyre në trup.</li> <li>-Përshkruan si gjëndrat endokrine kontrollojnë organe e funksione të caktuara nëpërmjet hormoneve.</li> </ul>
	<b>Shumimi te njeriu</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan ndërtimin dhe funksionin e gjëndrave seksuale te njeriu.</li> <li>-Tregon se sistemi riprodhues seksual, lehtëson procesin e</li> </ul>

	<p><b>Shendeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut</b></p>	<p>trashëgimisë (bartjen e informatave gjetetike ose tipareve gjenetike nga një gjeneratë në tjetrën).</p> <p>-Përshkruan shkurtimisht strukturat e sistemeve riprodhuese te individit femër dhe mashkull si dhe funksionin e tyre në frytëzim.</p> <p>- Përshkruan ndryshimet e trupit gjatë rritjes, zhvillimit dhe ndikimin e reflektimeve të tjerëve për shëndetin e tyre.</p> <p>- Identifikon shërbimet ku adoleshentët mund të shkojnë për ndihmë.</p> <p>- Identifikon përgjegjësitë e prindësisë se hershme, rritjes se fëmijëve, planifikimit familjar, planifikimi në karrierë, kontracepsionin, vendimmarrjen dhe kujdesin në rast të shtatzënisë.</p> <p>- Përshkruan sjelljet e rrezikshme, simptomat përcjelljen dhe parandalimin e STS dhe HIV.</p> <p>- Shpjegon të drejtat seksuale për vete, të tjerët ligjet dhe rregulloret.</p> <p>-Vlerëson ndikimin e moshës, gjinisë, religjionit dhe kulturës në marrëdhënie me të tjerët.</p>
	<p><b>Shumimi te shtazët</b></p>	<p>- Zbaton fjalët dhe përkufizimet kryesore në procesin e një cikli jetësor.</p> <p>- Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te shtazët.</p> <p>- Hulumton dhe përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet gjatë procesit të shumimit tek organizmat e ndryshëm.</p> <p>- Hulumton fazat kryesore të zhvillimit embrional tek ujëtokësorët (në shembullin e bretkosës) dhe te shpendët (në shembullin e zogut të pulës).</p> <p>- Vlerëson rolin e shumimit të shtazëve në zhvillimin e botës së gjallë.</p>
	<p><b>Shumimi te bimët</b></p>	<p>- Hulumton dhe përshkruan format e shumimit te bimët.</p> <p>- Hulumton dhe të përshkruan ngjashmëritë dhe dallimet</p>



		<p>gjatë procesit të shumimit tek grupet bimore.</p> <p>- Vlerëson rolin e shumimit të bimëve në zhvillimin e botës së gjallë.</p>
--	--	--

## Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të programit mësimor sipas planifikimit mësimor për shkencat natyrore-Biologjia7, për realizimin e orës mësimore brenda klasës dhe jashtë saj si dhe gjatë realizimit të aktiviteteve kurrikulare dhe jashtë kurrikulare, nevojitet përzgjedhja e metodologjive të ndryshme të harmonizuara me rezultatet e pritshmedhenëkonteksttëqëllimevedheparimevetë KKK-së.

Përzgjedhja e metodave është kompetencë e mësimit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje me nevojat dhe kërkesat e nxënësit, me natyrën e përmbajtjes së njësive mësimore gjegjësisht me kërkesat e rezultateve të pritura të nxënësit për orë mësimore apo aktivitete mësimore, në harmoni me bazën didaktike, me nivelin e formimit të nxënësit dhe kompetencat e synuara.

Shkencat e natyrës zhvillohen përmes hulumtimit dhe eksperimentit, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur, të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari të ketë rol udhëheqës. Suksesi i nxënësit në lëndët e shkencave të natyrës varet jo vetëm nga puna dhe angazhimi i mësimit të lëndës por edhe nga motivimi, përfshirja, ngritja e hipotezave dhe angazhimi i vetë nxënësit. Kjo arrihet duke përdorur çasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, këshillohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës, si:

- Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo drejtëpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Të mësuarit përmes projekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhënie përmes vrojtimit, demonstrimit dhe eksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

### **Format e punës**

- individuale,
- në çifte,
- në grupe të vogla, dhe
- me të gjithë nxënësit.

Mësimdhënësi udhëheq nxënësin ashtu që ai me aktivitetet e tij në klasë, shkollë, laborator, natyrë dhe në jetën e përditshme, aftësohet të njohë, kuptojë, vrojtojë, krahasojë, klasifikojë, bëj matje, mbaj shënime, mbledh të dhëna, eksperimentoj, mbikëqyrë procedura, mendoj në mënyrë të pavarur, mbroj dhe argumentoj mendimet e veta.

Nxënësi sillet sipas parimeve didaktike: prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.

### **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare paraqesin përmbajtje të rëndësishme kurrikulare, të cilat nuk i takojnë ekskluzivisht vetëm një lëndë. Ato realizohen përmes lëndëve të ndryshme kurrikulare (mësimore) dhe janë në funksion të zhvillimit të kompetencave, respektivisht të arritshmërisë së rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare. Përmbajtjet e tyre dalin nga edukimi për paqe, të drejtat e njeriut, edukimi ndërkulturor, shkathtësitë e komunikimit, çështjet gjinore dhe edukimi qytetar duke përfshirë edhe ndërgjegjësimin për ruajtjen dhe kujdesin e mjedisit, edukimin për karrierë dhe aftësitë për jetë.

#### **Si realizohen çështjet ndërkurrikulare?**

Çështjet ndërkurrikulare mund të integrohen në Kurrikulë nëpërmjet njësive tematike dhe njësive mësimore, nëpërmjet aktiviteteve praktike në klasë, por edhe projekteve të përbashkëta që ndërlidhin fushat kurrikulare.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën shkollë të shkencave natyrore për këtë shkallë kurrikulare gjegjësisht për klasën shtatë, janë: Edukimi për media dhe Arsimimi për zhvillim të qëndrueshëm.

#### **Edukimi për media**

I referohet përdorimit të mediave për sigurimin e informacioneve të reja, të sakta, krijimin dhe përdorimin e informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Tema e edukimit për media përfshin përmbajtje lidhur me publikimet shkencore, shpërblimet për të arriturat në shkencë qoftë në nivelin kombëtar apondërkombëtar. Poashtu duhet të përfshijë edhe përparësitë, mangësitë dhe rreziqet e mesazheve (informatave) të mediave, duke pasur edhe qëndrim kritik ndaj në rast të manipulimit të mediave dhe duke vepruar gjithmonë në përdorimin e tyre (mediave) për të vepruar në shërbim të mirës publike.

## **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve, për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve për mjedisin, në vetëdijësimin e tyre, duke rritur ndjenjën e përgjegjësisë ndaj mjedisit natyror dhe atij të bërë nga dora e njeriut, në ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si: aspekti social, zhvillimi ekonomik, mjedisi i shëndetshëm, kapaciteti për t'u përballur me katastrofat natyrore dhe ato të krijuara nga dora e njeriut, shfrytëzimi i burimeve mjedisore, si trashëgimi e brezit të ardhshëm.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënësve dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënësve;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënësve;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënësve. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngritjes së nxënësve.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - biologji, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumente vlerësuese, ku secili instrument vlerësues duhet të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës, i dalë nga plani vlerësues në nivel të DKA-ve dhe me UA-ve, miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkojë mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për

instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të ketë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivitë profesionale, drejtoritë e shkollës, nxënësit dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndahet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga çasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KK-së.

### **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të programit Biologjia 7, është e nevojshme të shfrytëzohen materialet dhe mjete të ndryshme mësimore, në mjedis të përshtatshëm mësimor, si:

- Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, libri i mësuesit, udhëzues profesionalë, fjalorë, gazeta, revista, materialet psikopedagogjike, enciklopedi, etj.;
- Mjete vizuale – pamore: tabelë shkrimi, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike etj.;
- Mjete auditive-dëgjimore: radioja, magnetofoni, telefoni, kasetofoni etj.;
- Mjete audiovizuale – pamore-dëgjimore: televizori, filmi, videoprojektori, kasetavideo, kompjuteri, interneti, teleteksti, CD-të, e-mail-i, dhe
- Mjedisi mësimor (klasa, laborator, punëtorja, natyra, ferma etj.).

# Kurrikula lëndore/programi mësimor

Kimi

## Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Lënda e kimisë për klasën e 7-të, për herë të parë fillon të mësohet si lëndë e veçantë, në kuadër të shkencave natyrore. Nxënësit tani kanë njohuri paraprake nga lëndët njeriu dhe natyra (niveli 1), biologjia dhe fizika (klasa 6), për disa veti të materialeve të ndryshme, për dukuri dhe ndryshime që ndodhin në natyrë. Në klasën e 7-të këto njohuri do të thellohen më tej në atë mënyrë që të kuptojnë më mirë proceset dhe ndryshimet që ndodhin rreth tyre.

Në këtë klasë nxënësit do të zhvillojnë të mësuarit duke shpjeguar dhe demonstruar idetë dhe teoritë që kanë ndikuar në arritjet shkencore deri më sot si: ndërtimi grimcor i materies, vetitë dhe ndryshimi i saj, vetitë dhe roli i ujit për botën e gjallë, burimet e kufizuara të tij, sot dhe në të ardhmen, rolin e riciklimit të materialeve, si dhe ndikimin e substancave të ndryshme në mjedis.

Krahas mësimit do të zhvillohen edhe shkathtësitë hulumtuese të nxënësve përmes punës praktike/eksperimentale apo duke shfrytëzuar mjetet teknologjike.

Programi dhe metodologjia për klasën e 7-të janë në funksion të arritjes së rezultateve të fushës shkencat e natyrës, si dhe arritjen/kontributin në rezultatet e të nxënit për shkallë/kompetencë (shkalla 3).

## Qëllimi

- Të kuptuarit e kimisë si shkencë natyrore dhe eksperimentale dhe rëndësia e saj për njeriun.
- Zhvillimi i njohurive dhe të kuptuarit e nocioneve kimike përmes aktiviteteve të ndryshme të cilat përfshihen në diskutime, punë eksperimentale dhe çasje të ndryshme të hulumtimit të problemeve.
- Zhvillimi dhe kultivimi i shprehive dhe shkathtësive për përdorimin e substancave kimike, mjeteve laboratorike, për punë të pavarur teorike, eksperimentale e praktike dhe për mbrojtjen e mjedisit.
- Aktivizimi i sa më shumë shqisave (të pamurit, të prekurit, ndëgjimit, shijimit, nuhaturit) për nxënie të qëndrueshme të njohurive.
- Zhvillimi i të menduarit autonom dhe kritik për të kuptuar, shprehur dhe zbatuar fenomenet dhe dukuritë kimike që ndodhin në natyrë dhe në laborator.
- Edukimi i nxënësve, prindërve të tyre dhe komunitetit më të gjerë shkollor për ambientin.
- Zotërimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit për grumbullimin, përpunimin dhe prezantimin e të dhënave gjatë hulumtimeve shkencore.
- Zhvillimin e shkathtësive për të nxënë gjatë gjithë jetës.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e shtatë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shkencat e natyrës, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk 3) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët:

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Materia, vetitë dhe shëndrrimet	<b>RNF: Dallon dhe klasifikon lëndët sipas përbërjes, strukturës, vetive fizike dhe kimike, shndërrimeve dhe përdorimit të tyre në jetën e përditshme</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Natyra grimcore e lëndës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon zhvillimin historik të kimisë si shkencë natyrore.</li> <li>• Definin objektin e studimit të lëndës së kimisë dhe rolin e saj si shkencë.</li> <li>• Shpjegon rolin e eksperimentit në kimi.</li> <li>• Dallon pajisje laboratorike sipas përbërjes dhe përdorimit të tyre.</li> <li>• Identifikon shenjat e rrezikshmërisë së substancave.</li> <li>• Zbaton rregullat e punës gjatë punës praktike.</li> <li>• Përshkruan materien dhe ndryshimet e saj.</li> <li>• Shpjegon vetitë bazë të materialeve të ngurta, lëngjeve dhe gazeve.</li> <li>• Demonstron me eksperiment shndërrime fizike e kimike të substancave.</li> <li>• Dallon substancat e pastra nga përzierjet.</li> <li>• Identifikon llojet e substancave të pastra dhe paraqet ato përmes simboleve apo formulave kimike.</li> <li>• Krahason vetitë e komponimeve me vetitë e elementeve nga të cilat janë ndërtuar.</li> <li>• Dallon përzierjet homogjene nga ato heterogjene.</li> <li>• Demonstron praktikisht ndarjen e përzierjeve me metoda fizike (metodën e ndarjes me magnet, filtrim, distilim, kristalizim, dekantim dhe kromatografi në letër).</li> <li>• Definin atomin si mikrogrimcë e përbërë.</li> <li>• Tregojnë karakteristikat e protoneve, elektroneve dhe neutroneve në atom.</li> <li>• Përdorin numrin atomik dhe numrin e masës për përcaktimin e llojit të atomit.</li> <li>• Diskutojnë ngjashmëritë dhe dallimin mes izotopeve të një elementi (shembulli i</li> </ul>

		<p>izotopeve të hidrogjenit).</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon radhitjen e elektroneve në nivele energjetike për 18 elementet e para në TP.</li> <li>• Përshkruan ndërtimin e tabelës periodike (identifikon grupet dhe periodat) dhe ligjin periodik.</li> <li>• Përdorë tabelën e Sistemit periodik për klasifikimin e metaleve, jometaleve dhe metaloideve.</li> <li>• Definon nocionin masë atomike relative</li> <li>• Përcakton masën molekulare relative duke shfrytëzuar të dhënat e masave atomike relative nga tabela e sistemit periodik të elementeve.</li> <li>• Përshkruan formimin e lidhjes jonike.</li> <li>• Dallon atomet nga jonet duke u bazuar në numrin e protoneve dhe elektroneve në atom.</li> <li>• Përshkruan formimin e lidhjes kovalente.</li> <li>• Identifikon lidhjet kovalente njëfishe, dyfishe dhe trefishe në shembuj të thjeshtë.</li> <li>• Vizaton strukturën e molekulave të hidrogjenit, ujit, klorit, oksigjenit, klorhidrikut, azotit dhe amoniakut.</li> <li>• Zbaton valencën e elementeve për paraqitjen e formulave strukturore për shembuj të thjeshtë.</li> <li>• Ndërton modele molekulare për paraqitjen e ndërtimit të molekulave.</li> </ul>
	<b>Reaksionet kimike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Definon termat:reagjent, reaktant dhe produkt si dhe identifikon ato në reaksion.</li> <li>• Demonstron shembuj të reaksioneve kimike që zhvillohen në natyrë dhe në laborator.</li> <li>• Përshkruan ndryshimet që ndodhin gjatë demonstrimit të një reaksioni kimik.</li> <li>• Cakton koeficientët, gjendjet agregate të substancave reaguese dhe produkteve të reaksionit dhe arrihtë barazojë reaksionet kimike.</li> <li>• Dallon reaksionet e analizës dhe sintezës.</li> <li>• Zbaton ligjin e ruajtjes së masës së reaksioneve kimike në shembuj të thjeshtë.</li> </ul>
	<b>Uji dhe tretësirat ujore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregon vetitë karakteristike të ujit.</li> <li>• Klasifikon llojet e ujërave në bazë të përhapjes së tyre në natyrë (atmosferike, sipërfaqësore dhe nëntokësore).</li> </ul>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vërteton me eksperiment përbërësit e ujit me metodën e elektrolizës.</li> <li>• Vlerëson rëndësinë e ujit për zhvillimin e jetës, për nevoja të higjienës, amvisërisë, të industrisë, bujqësisë etj.</li> <li>• Promovon kursimin e ujit dhe mbrojtjen e tij nga ndotjet.</li> <li>• Demonstron tretjen e substancave në ujë për shembuj të thjeshtë.</li> <li>• Dallon tretësit sipas gjendjes agregate të komponenteve përbërëse.</li> <li>• Klasifikon tretësit në bazë të sasisë së substancës së tretur (të pangopura, të ngopura dhe të tejngopura).</li> <li>• Llogaritë pjesëmarrjen e masës osenë përqindje të tretësirave për shembuj të thjeshtë.</li> <li>• Vlerëson rëndësinë e tretësirave për zhvillimin e proceseve jetësore.</li> </ul>
<b>Toka, mjedisi dhe gjithësia</b>	<b>RNF: Shpjegon përbërjen e litosferës, hidrosferës, atmosferës, biosferës, proceset në to dhe ndërrimet e thjeshta të pozitës së trupave gjatë kohës</b>	
	<b>Toka dhe atmosfera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan strukturën e tokës dhe përbërjen e saj (korës, mantelit dhe bërthamës së tokës).</li> <li>• Shpjegon burimet e limituara të materialeve që i marrim nga Toka dhe rolin e riciklimit.</li> <li>• Dallon përbërësit e ajrit (oksigjeni, azoti dhe dioksidi i karbonit) dhe përshkruan vetitë e tyre.</li> <li>• Analizon ciklin e oksigjenit dhe të dioksidit të karbonit në natyrë.</li> <li>• Vlerëson rëndësinë e përbërësve të ajrit për proceset jetësore, si lëndë të para industriale dhe ndikimin e tyre në ngrohjen globale</li> </ul>
<b>Bota e gjallë</b>	<b>RNF: Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut</b>	
	<b>Shëndeti i njeriut</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Liston substancat e dëmshme që gjenden në duhan dhe pasojat e tyre për organizmin.</li> <li>• Tregon ndikimin e alkoolit dhe drogave në sjelljen dhe shëndetin e njeriut.</li> <li>• Numron metoda të ruajtjes së ushqimeve nga ndikimi i bakterieve dhe oksigjenit.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon vitaminat sipas tretshmërisë.</li> <li>• Tregon rëndësinë e vitaminave për organizmin e njeriut.</li> </ul>
--	--	---

## Udhëzime metodologjike

Për zbatimin praktik të planifikimit mësimor për lëndën e kimisë, qoftë brenda orës mësimore, por edhe jashtë saj nevojitet përdorim adekuat i metodologjive të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Rezultatet e të nxënësve për shkallë (kompetencat) RNK, rezultatet e të nxënësve për fushë (RNF-të) – Shkencat e natyrës, gjegjësisht rezultatet lëndore (RNL) – paraqesin jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve por edhe për përzgjedhjen e metodologjive duke u harmonizuar njëra me tjetrën në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies e në kontekst të filozofisë dhe parimeve të KK-së.

Suksesi i nxënësve në lëndën e kimisë varet nga puna dhe angazhimi i mësimdhënësit dhe nxënësve. Kjo arrihet duke përdorur çasje ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse, metoda, teknika e forma të shumëllojta të punës. Për këtë qëllim, zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, detyra, demonstrime, punë me projekte, punë praktike e të tjera.

Mësimdhënësi duhet të respektojë dhe ti përgjigjet interesave dhe vlerave të të gjithë grupeve të nxënësve pavarësisht nga kombësia, raca, gjinia, gjendja sociale, fetare.

Kimia është shkencë eksperimentale, prandaj është e preferuar që ligjshmëritë, aty ku është e mundur të shpjegohen duke u shërbyer me provë, demonstrim apo eksperiment në bashkëpunim me nxënësit, kurse arsimtari duhet të ketë rol udhëheqës.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, sugjerohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt);
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve);
- Diskutimi dhe të nxënësve në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit);
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve;
- Tëmësuaritpërmesprojekteve, punëve kërkimore në terren;
- Mësimdhëniepërmesvrojtimimit, demonstrimitdheeksperimentit;
- Të mësuarit dhe të nxënësve përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit;
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin e pavarur;
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në objekte industriale.

## **Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar**

Integrimi i disa temave është i domosdoshën në shkencat e natyrë në mënyrë që nxënësit të arrijnë rezultate sa më të mira. Fenomenet që ndodhin në natyrë nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjesëshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve të shkencave të natyrës por edhe fushave tjera, në mënyrë që tek nxënësit, temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

Temat dhe konceptet nga lënda e kimisë që mund të integrohen me lëndë tjer, janë: struktura e atomit, izotopet, forcat/lidhjet mes atomeve dhe molekulave, vetitë e materjes (me lëndën e fizikës), vetitë dhe rëndësia e ujit për Tokën dhe botën e gjallë (biologjia, gjeografia, fizika), ndotja e ujit, ajrit dhe tokës (biologjia, gjeografia), ndikimi i ushqimit, barnave dhe drogave në shëndet (biologjia dhe fusha shoqëria dhe mjedisi), përdorimi i llojeve të ndryshme të materialeve sipas vetive të tyre (fizika, fusha jeta dhe puna) si dhe tema apo koncepte të tjera të cilat kontribuojnë në arritjen e rezultateve për fushë apo për kompetenca. Paraqitja dhe analiza e rezultateve për këtë klasë kryesisht mund të realizohet përmes TIK-ut dhe llogaritjeve matematike ku integrimi me këto lëndë/fusha është i domosdoshëm.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shkencave të natyrës i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në Kurrikulën e shkencave të natyrës për këtë moshë të nxënësve janë:

- **Edukimi për media, si dhe**
- **Arsimimi për zhvillimin e qëndrueshëm.**

### **Edukimi për media**

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin: përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijësimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm, përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm, që ndërlidhet me vetëdijësimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është proces i grumbullimit sistematik, cilësor e sasior të informatave të arritjeve të nxënësve gjatë procesit të të nxënit dhe nxjerrja e gjykimeve për to.

Vlerësimi është në funksion të:

- Sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimi të punës praktike dhe demonstruese;
- Identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënit;
- Nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënit;
- Vetëvlerësimit të nxënësve ;
- Përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

Vlerësimi i nxënësit bëhet për përgjigjet me gojë dhe me shkrim, detyrat e shtëpisë, aftësitë e tij/saj gjatë punës së pavarur dhe në grup, provave, punës me projekte, punës praktike, punës në terren, punës kërkimore, llojeve të ndryshme të testeve etj. Format e vlerësimit duhet të jenë në përputhje me stilet e ndryshme të të nxënit. Mësimdhënësi është i pavarur në përzgjedhjen e metodave, teknikave dhe instrumenteve të vlerësimit. Vlerësimi duhet të jetë transparent para nxënësve, prindërve dhe komunitetit. Instrument i rëndësishëm për vlerësim, vetëvlerësim dhe marrje të informacioneve të përparimit apo të ngecjes së nxënies.

Mësimdhënësit e shkencave natyrore - kimi, për shkak të specifikave që ka lënda mësimore, duhet të përdorin sa më shumë instrumente vlerësuese, ku secili instrument vlerësues të ketë një standard dhe të jetë i specifikuar me kritere të hartuara nga vetë mësimdhënësit, (aktivi profesional, aktivi i mësimdhënësve) në harmoni me planin vlerësues të shkollës i dalë nga plani vlerësues në nivel DKA-ve dhe me UA-ve, i miratuar nga MASHT-i.

Duke vlerësuar se vlerësimi është një çështje mjaft komplekse, mësimdhënësi vazhdimisht duhet të kërkoj mundësi zhvillimi profesional, hulumtim të gjendjes, rishikim të kritereve për instrumentin vlerësues të përdorur, e mbi të gjitha të këtë gatishmëri të llogaridhënies para çdo grupi të interesit.

Mësimdhënësi harton plan vjetor për vlerësimin e nxënësve, i cili plan duhet të miratohet nga gjitha grupet e interesit (aktivi profesional, drejtorja e shkollës, nxënës dhe prindërit) dhe të jetë transparent si dhe të ju shpërndahet në formë fizike gjitha palëve të interesuara.

Për të arritur synimin e Kurrikulës së re të Kosovës, të cilat burojnë nga çasja e bazuar në kompetenca, për të përmbushur filozofinë e kurrikulës e në veçanti për arritjen e rezultateve nga shkencat e natyrës, domosdoshmërisht duhet njohur sistemin e vlerësimit që është përcaktuar me UA i bazuar në kërkesat e KKK-së.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të kompetencave dhe koncepteve kryesore në shkencat e natyrës është e nevojshme të krijohen kushte, të sigurohen mjete mësimore dhe mjedis i përshtatshëm mësimor. Si burim i informacionit përveç tekstit shkollor është e domosdoshme të përdoren edhe burime të tjera, si : CD (filma, dokumentarë, video eksperimente etj), interneti (materiale tekstuale, fotografi, programe interaktive, video etj.), enciklopedi, atlase etj.

Për të rritur interesimin dhe kureshtjen e nxënësve është e domosdoshme të përdoren mjete të ndryshme si: tabelë shkrimi, tabela interaktive, fotografi, piktura, modele, makete, diagrame, mjete grafike, televizori, videoprojektori, kompjuteri, telefoni, tableti etj.

Për arritje të rezultateve në shkencat e natyrës është e domosdoshme sigurimi i mjedisit të përshtatshëm mësimor. Sipas mundësive, përveç klasës, mësimi duhet të zhvillohet edhe në mjedise të tjera (laborator, punëtori, natyrë, ferma etj.).

# **FUSHA KURRIKULARE: SHOQËRIA DHE MJEDISI**

## **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

Histori

Gjeografi

Edukatë qytetare

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Histori**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Lënda e Historisë në klasën e shtatë, luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e njohurive, shkathtësive, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të nxënësit. Përmes kësaj lënde, nxënësi do të njihet me zhvillimet e shoqërisë njerëzore në periudhën historike të Mesjetës (shek. V- XV). Në këtë klasë trajtohen mënyrat e jetesës dhe organizimit shoqëror, ekonomik, politik, kulturor si dhe bota materiale e shpirtërore përgjatë Mesjetës. Duke trajtuar proceset, fenomenet dhe marrëdhëniet midis individëve, grupeve, shoqërive, shteteve-vendeve dhe civilizimeve përgjatë kësaj periudhe historike, nxënësit do të kuptojnë ndryshimet dhe transformimet në vazhdimësi të shoqërisë njerëzore dhe të mendimit historik.

## Qëllimi

Qëllimi i kësaj lënde, në këtë klasë, është që nxënësi të përfitojë njohuri të duhura për Mesjetën, në mënyrë që të krijojë një botëkuptim të përgjithshëm për këtë periudhë historike. Gjithashtu, përmes kësaj lënde synohet që gjatë procesit mësimor për ngjarjet, personalitetet e proceset në të gjitha fushëveprimet e rëndësishme të shoqërisë mesjetare, tek nxënësi të zhvillohet të menduarit kreativ e kritik, aftësia për të hulumtuar e analizuar dhe zhvillimi i shkathtësive për të përdorë burime të ndryshme. Njëherazi, lënda ka për qëllim që tek nxënësi të kultivohen vlera, qëndrime e sjellje të një qytetari të përgjegjshëm, i cili do të pranojë dhe respektojë identitetet, përkatësitë dhe diversitetet e ndryshme, si ato: kulturore, fetare, etnike, racore, gjinore, orientimet seksuale etj.

## Temat dhe rezultatet e të nxënësit

Nxënësit në klasën e shtatë i arrijnë rezultatet e të nxënësit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënësit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, të shkallës së tretë (Shk 3) në Kurrikulën Bërthamë të Shkollës së Mesme të Ulët.

Koncepti	RNF
<b>Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</b>	<b>RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</b>  1.1 Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.  1.2 Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.



1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimin, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.	
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
<b>Dyndjet e popujve dhe zhvillimi i formacioneve të reja shtetërore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon disa nga shkaqet e dyndjeve të popujve, rrjedhojat e ngulitjeve të tyre në Evropë dhe identifikon formacionet e reja shtetërore.</li> <li>- Përshkruan rrethanat e krijimit dhe fuqizimit të shtetit Frank dhe vlerëson rolin e Karlit të Madh në formimin e Perandorisë së Shenjtë Romake.</li> <li>- Përshkruan invazionet e vikingëve dhe analizon rrjedhojat e tyre në rrafshin shoqëror dhe politik në Evropë e më gjerë.</li> <li>- Identifikon marrëdhëniet e fuqive të kohës, rivalitetin dhe konfliktet e armatosura midis tyre dhe rrjedhojat për shoqërinë evropiane.</li> </ul>
<b>Arbrit (Shqiptarët) midis Romës dhe Kostandinopojës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon shtrirjen territoriale të arbërve dhe identifikon veçoritë kulturore dhe marrëdhëniet shoqërore tek ta.</li> <li>- Përshkruan pozitën e iliro-arbërve si pasojë e ndarjes së Perandorisë Romake (Vija e Teodosit) dhe shqyrton rrjedhojat e ndarjes së Kishës (1054) tek ta.</li> <li>- Dallon elementet kryesore të trashëgimisë kulturore iliro-arbërore dhe vlerëson rëndësinë e tyre.</li> <li>- Identifikon qytetet/vendbanimet kryesore në territorin e Kosovës gjatë Mesjetës dhe krahason mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre.</li> <li>- Përshkruan reformat politike-administrative dhe shoqërore të Perandorisë Romake të Lindjes-Bizantit, dhe diskuton për pozitën e arbërve brenda këtij sistemi.</li> <li>- Shpjegon rrethanat e themelimit të Principatës së Arbrit dhe krahason rolin e prijësve të saj.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Veçon përfaqësues të dalluar të bujarisë arbërore, faktorët që ndikuan në fuqizimin e tyre, përkufizon principatat e veçanta dhe marrëdhëniet midis tyre.</li> </ul>
	<b>Skënderbeu dhe epoka e tij</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon veçoritë kryesore të personalitetit të Gjergj Kastriotit-Skënderbeut si strateg dhe burrë shteti.</li> <li>- Vlerëson rolin e Gjergj Kastriotit - Skënderbeut në themelimin e Lidhjes së Lezhës dhe analizon përpjekjet e tij për formimin e shtetit arbëror.</li> <li>- Dallon betejat kryesore të luftës mbrojtëse kundër pushtimit osman dhe prezanton argumente për jehonën e luftës së Skënderbeut në Evropë dhe më gjerë.</li> </ul>
	<b>Personalitete të njohura të Mesjetës</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon personalitetet më të spikatura nga fusha e artit, kulturës, shkencës, teknologjisë e politikës, në Mesjetë, dhe vlerëson veprimtarinë e kontributin e tyre.</li> </ul>
<b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b>	
	<p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasqyruar parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)</b>
	<b>Perandoria Romake e Lindjes-Bizanti, Arabët, Sllavët.</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan faktorët që ndikuan në ngritjen, forcimin dhe zgjerimin e Bizantit si dhe vlerëson kontributin e Justinianit si perandor reformator.</li> <li>- Identifikon shkaqet që ndikuan në dobësimin e Bizantit dhe dallon faktorët e brendshëm e të jashtëm që ndikuan në rënien e tij.</li> <li>- Analizon faktorët që ndikuan në bashkimin dhe fuqizimin e botës arabe dhe ndikimin e saj gjatë</li> </ul>

		<p>Mesjetës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përkufizon rrethanat e dyndjeve dhe ngulitjeve të sllavëve në Evropën Juglindore.</li> </ul>
	<b>Lindja e Largët gjatë shekujve V-XV</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon aspektet kryesore të qytetimit kinez gjatë kësaj periudhe.</li> <li>- Shpjegon pushtimet mongole në krye me Xhingis Kanin dhe ndikimin e tyre.</li> </ul>
	<b>Organizimi i jetës shoqërore në Mesjetë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ilustron aspekte të jetës së përditshme të shtresave të ndryshme shoqërore (fshat, qytet) në botën mesjetare.</li> <li>- Shpjegon rolin e avancimit të zejtarisë dhe tregtisë në lindjen e formave të reja të organizimit të grupeve të interesit (esnafet, gildet, hanzat etj.) në shoqërinë mesjetare.</li> </ul>
	<b>Religjioni në Mesjetë</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon rrethanat shoqërore të lindjes dhe përhapjes së besimit islam dhe përshkruan karakteristikat kryesore të tij.</li> <li>- Analizon rolin e kishës në shoqërinë mesjetare, identifikon disa nga urdhërat kryesor fetar dhe përshkruan inkuizicionin si mënyrë e luftimit të oponentëve ndaj saj.</li> <li>- Debaton për Skizmën e madhe të Perëndimit dhe identifikon lëvizjet e para për reformimin e kishës.</li> </ul>
	<b>Kryqëzatat-ndikimi i tyre në botën mesjetare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan shkaqet e organizimit dhe rrjedhën e kryqëzatatave si dhe identifikon personazhet kryesore të tyre.</li> <li>- Identifikon ngulitjet e kryqtarëve (evropianëve) në Lindjen e Afërt dhe rolin e tyre në marrëdhëniet Lindje - Perëndim.</li> </ul>
	<b>Perandoria Osmane dhe pushtimet në Ballkan</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përshkruan fillet e shtetit osman dhe zgjerimin e tij.</li> <li>- Shpjegon gjendjen politike në Ballkanit në prag të pushtimeve osmane.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Krahason të dhëna të ndryshme për Betejën e Kosovës, vlerëson bashkëpunimin midis popujve të Ballkanit, si dhe argumenton pasojat që pati kjo betejë për ta.</li> <li>- Analizon pozitën vasale të princave ballkanas ndaj Perandorisë Osmane dhe nxjerr përfundime për gjendjen e popujve të Ballkanit.</li> </ul>
	<b>Humanizmi dhe Renesanca – ndryshimet në shoqërinë evropiane</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Analizon rrethanat kulturore, ekonomike dhe politike në Evropë në prag dhe gjatë periudhës së Humanizmit dhe Renesancës.</li> <li>- Numëron disa nga humanistët evropianë, dhe vlerëson ndikimin e tyre në shoqërinë mesjetare.</li> <li>- Vlerëson kontributin shkencor, kulturor, artistik të figurave përfaqësuese të renesancës dhe evidencon ndikimin e tyre në shoqëri.</li> <li>- Numëron disa nga humanistët shqiptarë dhe vlerëson kontributin e tyre në kulturën arbërore/shqiptare dhe evropiane.</li> </ul>
<b>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</b>	<b>RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b>	
	<p>3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p> <p>3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
<b>Organizimi juridik i shoqërisë mesjetare</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon kodet juridike evropiane dhe bizantine dhe përshkruan rolin e tyre në organizimin e shoqërisë.</li> <li>- Analizon rrethanat e krijimit dhe ndikimet e Magna Carta-së në jetën dhe sistemin juridik mesjetar.</li> <li>- Shpjegon rolin e kanuneve shqiptare dhe ndikimin e tyre në shoqërinë mesjetare</li> </ul>	

		<p>arbërore/shqiptare.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon kodet/kanunet në Azinë mesjetare dhe shpjegon rolin e tyre në organizimin shoqëror dhe institucionet e vendimëarrjes.</li> </ul>
<b>Vendimmarrja dhe institucionet</b>	<b>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b>	
	<p>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme</p> <p>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Feudalizmi si bazë e qeverisjes</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Shpjegon veçoritë kryesore të feudalizmit dhe arsyet e lindjes së shtresave të reja shoqërore.</li> <li>- Identifikon shtresat shoqërore, marrëdhëniet ndërmjet tyre, dhe evidencon të drejtat, obligimet dhe përgjegjësitë e tyre.</li> </ul>
<b>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b>	<b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</b>	
	<p>5.1. Inicion aktivitete konkrete grupe me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</p> <p>5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Avancimet shkencore e teknike dhe ndikimi i tyre në cilësinë e jetës dhe mjedisit</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Identifikon avancimet shkencore, teknike-teknologjike gjatë mesjetës dhe shpjegon ndikimin e tyre në shoqëri.</li> <li>- Shpjegon kontributin dhe ndikimet reciproke shkencore Lindje-Perëndim në Mesjetë.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Për mësimdhënie të suksesshme kërkohen disa përgatitje paraprake. Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive. Rekomandohet që mësimdhënësi të lexojë me kujdes rezultatet e të nxëniet për shkallë - (për kompetencë) (RNK), rezultatet e të nxëniet për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së Historisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por dhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore. Andaj, për planifikim efektiv të mësimdhënies duhet të merren në konsideratë vazhdimisht dokumentet kurrikulare.

Zbatimin praktik i planifikimit mësimor për lëndën e historisë, duhet të jetë i ndërlidhur me përdorimin adekuat të metodologjive të përzgjedhura, në harmoni me filozofinë dhe parimet e Kornizës së Kurrikulës. Duke u bazuar në këtë filozofi, planifikimet ditore ose përzgjedhja e metodologjive duhet të fokusohet në mësim praktik e jo vetëm në atë teorik. Mësimdhënia dhe mësimnxënia e historisë duhet të orientohet në të zhvilluarit e shkathtësive të nxënësit si vrojtimi, hulumtimi, analiza e vendimmarrja. Kjo realizohet duke përdorur burime dhe materiale të ndryshme mësimore, që nxisin “*të menduarit si historian*”, dhe kultivojnë aftësi, vlera dhe qëndrime individuale. Mësimdhënësi gjithmonë duhet të marrë parasysh se mësimi i historisë duhet t'i ndihmoj nxënësit në zgjidhjen e konflikteve në mënyrë demokratike, në të gjykuarit në mënyrë racionale dhe në kultivimin e qytetarisë aktive demokratike. Për këtë arsye kërkohet që mësimdhënësi të respektoj stilet e ndryshme të të nxëniet, potencialet dhe kapacitetet individuale të nxënësit. Përdorimi i metodave, strategjive e teknikave të ndryshme dhe gërshetimi i tyre adekuat ndihmon që nxënësi të shfaq interesim dhe përkushtim. Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për qasjen e mësimi të diferencuar. Për këtë qëllim zbatohet një kompleks i tërë procedurash, si: informacion i ri, ushtrime, punë individuale e grupore, hulumtime, detyra, demonstrime, punë me projekte, e të tjera.

Pjesë e rëndësishme e metodologjisë së mësimdhënies së historisë është edhe demonstrimi. Kjo metodë është efektive në mësimdhënie dhe nxënie për shkak të ndikimit vizuel. Mësimdhënësi dhe nxënësi shpeshherë duke u përpjekur të përcjellin mendimin e tij, bëjnë lëvizje duke treguar, bërë, shpjeguar, etj. Demonstrimi kryesisht ka të bëjë me planifikimin e ndonjë loje në klasë e jashtë saj p.sh: loja në role, gara përmes asociacioneve, pantomimës, etj. Kjo metodë është e pranueshme nga nxënësi dhe ndihmon mësimdhënësin të zbulojë dhe vlerësojë shkathtësi të ndryshme të nxënësit. Gjithashtu, zhvillon shprehi të komunikimit efektiv, shkathtësi të të menduarit kreativ, menaxhimin e emocioneve, përgjegjësinë individuale dhe grupore, aftësi ndërvepruese dhe bashkëpunuese, si dhe socializmin.

Mësimdhënësi ka rol të rëndësishëm edhe në orientimin e nxënësit për shfrytëzimin racional të TIK-ut dhe medias, gjë që i ndihmon atij në thithjen e informacioneve dhe përgatitje për angazhim të suksesshëm. Organizimi i vizitave mësimore dhe ekskursioneve ka rol po ashtu të rëndësishëm në zhvillimin e gjithanshëm të nxënësit. Ato mundësojnë që nxënësi të zhvillojë aftësitë e vrojtimit, hulumtimit dhe vëzhgimit, interpretimit dhe diskutimit për dukuri të ndryshme të shoqërisë dhe mjedisit.

Mësimdhënësi duhet të merr parasysh edhe mësimdhënien dhe të nxënit e integruar. Duke ju përmbajtur parimeve të kurrikulës është e domosdoshme që të synohet qasja integrale, ku temat brenda lëndëve të fushës apo dhe fushave tjera të trajtohen në mënyrë të integruar. Ngjarjet, fenomene që ndodhin në shoqëri dhe mjedis nuk mund të mësohen si të ndara apo të pjeshme, prandaj nevojitet bashkëpunim mes mësimdhënësve të lëndëve së historisë me mësimdhënësit e lëndëve brenda fushës por dhe me mësimdhënësit e lëndëve të fushave tjera. Kjo garanton që të nxënësit temat të paraqiten të plota dhe në koherencë me njëra tjetrën.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Mësimdhënësi duhet të kujdeset edhe për trajtimin e çështjeve/ temave ndërkurrikulare. Integrimi i këtyre temave me temat/përmbajtjet e lëndës së historisë i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë ngjarjet, proceset, marrëdhëniet në shoqëri dhe mjedisi, ndërvarësinë e tyre dhe në këtë mënyrë të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Me programin e lëndës së historisë për këtë moshë të nxënësve mund të integrohen të gjitha çështjet/temat ndërkurrikulare:

- Edukimi për qytetari demokratike
- Edukimi për paqe
- Globalizimi dhe ndërvarësia
- Edukimi për media
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm

Këto tema mund të ndërlidhen dhe të trajtohen gjatë shtjellimit të temave të parapara me program. Për shembull, kur trajtohet tema për organizimin juridik të shoqërisë mesjetare, ku flitet dhe për Magna Carta-në, mund të ndërlidhen me edukimin për qytetari demokratike, ku liritë dhe të drejtat e njeriut, pjesëmarrja në vendimmarrje mund të shpjegohen në kontekste të kohës dhe, si ka ndodhë evoluimi i tyre etj. E njëjta çasje vlen edhe në trajtimin e temave tjera, për shembull tema/çështja e Edukimit për media mund të shërbej në kontekstin e hulumtimit të nxënësve për përmbajtje të ndryshme duke siguruar material, fotografi, harta të ndryshme etj.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë e mësimdhënies dhe kërkon pajtueshmëri dhe konsistencë në gjithë procesin. Mësimdhënësi duhet të harmonizojë vlerësimin me atë që ka planifikuar, synuar, ta arrijë tek nxënësi. Pra duhet vlerësuar atë që e kemi vënë në objektiv të vlerësimit, njohuritë, shkathësitë, sjelljet, qëndrimet e nxënësve. Për vlerësimin e nxënësve në këtë moshë mund të përdoren forma dhe instrumente të ndryshme, përveç llojeve të ndryshme të

testimit, si ai verbal, joverbal, vlerësimi i nxënësve në punë grupore, i punës me projekte etj., mund dhe duhet të bëhen edhe vëzhgime të përvetësimit të njohurive, sjelljeve dhe qëndrimeve, dhe shkallës së rritjes së shkathtësive dhe aftësive për të zbatuar rezultatet e parapara në Kurrikulën Bërthamë për këtë nivel.

Për të gjitha llojet e vlerësimeve që duhet t'i bëhen nxënësit pikë referimi janë rezultatet e lëndës, të fushës në nivel klase si dhe ato për kompetenca në nivel shkalle. Mësimdhënësi, varësisht nga specifikat e tyre, hulumton gjetjen e formave më të përshtatshme për vlerësimin e arritjeve së tyre.

çasja kurrikulës së re me kompetenca, synon vlerësimin e asaj se çka është në gjendje të bëjë nxënësi, pra vlerësimi i zbatimit praktik të njohurive të marra gjatë shkollimit. Kështu, aplikimi i vlerësimit përmes vëzhgimit të vazhdueshëm të arritjeve të nxënësve dhe mbajtja e evidencës për qëllime dokumentimi dhe planifikimi të punës së mëtutjeshme me nxënësit është e domosdoshme. Vëzhgimi i punës në grupe dhe nismave individuale mund të vlerësohet edhe përmes teknikës që njihet si buletini i pjesëmarrjes ose edhe asaj që quhet lista e kontrollit etj.

Që në këtë moshë është e rëndësishme të kultivohet shprehja e vetëvlerësimit e cila mund të realizohet me mbajtjen e dosjeve të nxënësve, ku ata ruajnë punimet e tyre reprezentative, si: intervistat me familjarët, punë individuale ose në grupe për mbrojtjen e mjedisit dhe angazhime të tjera që lidhen me rezultatet e parapara për këtë moshë të nxënësve.

Vlerësimi gjithmonë duhet të ketë karakter motivues në mënyrë që nxënësi të edukohet të pranojë vlerësimin real dhe të synojnë arritje sa më të larta.

## **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për mësimin e historisë burimet, materialet dhe evidenca historike kanë rëndësi të veçantë. Krahas teksteve shkollore bazë mund të përdoren edhe burime tjera si: tekste alternative, atlase, gazeta, revista, literaturë të specializuar apo doracakë të ndryshëm, harta, materiale të ndryshme të shkarkuara nga interneti, fotografi, artefakte, sekuenca nga filma të ndryshëm artistik dhe dokumentar, këngë me tekste epike dhe lirike, etj. Përzgjedhja e këtyre burimeve rekomandohet të jetë e përshtatshme për moshën e nxënësit dhe të kombinohen gjatë përdorimit të tyre, p.sh. një foto me një tekst përshkrues narrativ. Gjatë përzgjedhjes së burimeve alternative preferohet të ketë çasje multiperspektive, me qëllim që nxënësi të njoh këndvështrime të ndryshme dhe përmes tyre të zhvillojë vetëdijen dhe edukimin historik. Ai duhet të kuptojnë kompleksitetin e historisë, shkaktarët e ndryshëm të ngjarjeve historike, si dhe interpretimin e tyre duke nxitur pyetje shtesë për burimet dhe gjetjet tjera të së vërtetës historike. Qasja multiperspektive do ta aftësojë nxënësin të marrin në konsideratë perspektiva të ndryshme historike, që do t'i ndihmojë për t'i kuptuar rrethanat e ndërlikuara të së kaluarës. Vetëdija dhe edukimi historik duhet të jetë bazë e mendimit historik, që shprehet me shkathtësinë e hulumtimit vetanak, aftësimin e kontestimit të burimeve duke mbrojtur dhe argumentuar pikëpamjet e veta.



# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Gjeografi**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## **Hyrje**

Programi i lëndës së gjeografisë për klasën e shtatë është ndërtuar duke respektuar Kornizën e Kurrikulës dhe Kurrikulat Bërthamë të arsimit parauniversitar, rezultatet e të nxënësve të kompetencave, Rezultatet e të nxënësve të (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi, dhe planin mësimor të arsimit të mesëm të ulët.

Në përputhje me metodologjinë vertikale (shtrirja ndër vite e mësimit të lëndës së gjeografisë), të respektuar ndër dekada në Kosovë, programi kurrikular i kësaj lënde vjen pas njohurive fundamentale gjeografike të arritura nga nxënësit lidhur me aspektet hapësinore, teknike dhe orientuese, njohurive fizike-gjeografike dhe njohurive humane-gjeografike të arritura në klasën paraprake.

Përmes kësaj lënde, nxënësi do të njihet me regjionet dhe kontinentin e Evropës në përgjithësi. Në përputhje me standardet e aplikueshme didaktike, pedagogjike dhe metodologjinë, promovuar edhe nga ky dokument kurrikular, duke trajtuar Evropën kontinent të veçantë nga të tjerët dhe regjionet e saj specifike, nxënësit do të kuptojnë: dallimet dhe ngjashmëritë, marrëdhëniet midis pjesëve dhe tërësisë, përparësitë dhe mangësitë e shfaqura në regjionet gjegjëse, zhvillimin ekonomik dhe mungesën e tij në regjione të ndryshme si dhe dallimet (orientimet) tjera politike, sociale dhe kulturore midis regjioneve, popujve dhe shteteve në Evropë.

## **Qëllimi**

Qëllimi i lëndës së gjeografisë, në këtë klasë është, që nxënësi të zhvillojë njohuri dhe shkathtësi gjeografike për kontinentin e Evropës dhe pjesët e saj, për të përbashkëtat dhe diferencat, shtrirjen dhe kufizimet, duke analizuar nga pikëvështërimi i të çenurit pjesë e këtij kontinenti.

Për më tepër njohuritë e fituara në këtë klasë, nga kjo lëndë, synojnë të ndikojnë në zhvillimin e aftësive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve kritike dhe kreative të nxënësve duke respektuar strukturën: nacionale, fetare, kulturore, sociale dhe të tjera e cila është prezente në Evropë, si vlerë e përbashkët e të gjithëve pa asnjë dallim.

## **Temat dhe rezultatet e të nxënësve**

RNL-të në këtë program mësimor, janë bazuar në temat e lëndës, në përputhje me RNF-të dhe konceptet e fushës, në harmoni me RNK-të e shkallës së tretë. Nxënësit në klasën e shtatë i arrijnë rezultatet e të nxënësve të lëndës duke respektuar obligimet, kërkesat dhe normat e caktuara në këtë dokument.

RNL-të i mundësojnë mësimdhënësit nxjerrjen e njësive mësimore duke respektuar autonominë e tij dhe të shkollës. Kjo u jep liri mësimdhënësve, që në përputhje me kushtet konkrete, jo të

barabarta (nxënësit, pajisjet, lokacioni, etj.), të mund të zgjedhin metodologji përkatëse, por duke u bazuar në RNL dhe RNF. Kjo natyrshëm nënkupton se mësimdhënësit mund të përdorin literaturë alternative dhe informata shumëburimorëshe për të arritur qëllimin e ngritur me këtë program.

<b>Koncepti</b>	<b>RNF, Temat dhe RNL</b>	
<b>Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore</b>	<p><b>RNF: 1. Njeh rolin e individit, strukturën e grupeve shoqërore, mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</b></p> <p>1.1. Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapësinor.</p> <p>1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimet, shpërndarjen, dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.</p>	
	<p><b>Tema</b></p> <p><b>Pozita, kufijtë dhe madhësia e Evropës</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përcakton kriteret për ndarjen e regjioneve gjeografike.</li> <li>▪ Përcakton kufijtë e Evropës dhe i tregon rolin e pozitës së saj.</li> </ul>
	<p><b>Specifikat popullatave, kulturore dhe politiko - administrative të Evropës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon popujt, kulturat dhe grupet më të mëdha të popujve në Evropë, në regjione dhe në shtete.</li> <li>▪ Analizon mënyrën e organizimit shtetëror unitar, federal, republikan dhe mbretëritë.</li> </ul>
<b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasur parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</p>	

	<p><b>Aspektet e përgjithshme-fiziko gjeografike të Evropës</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon njësit kryesore morfologjike (gadishujt dhe ishujt më të njohur te Evropës, sistemet malore- vargmalet, malet e vjetra, ultësirat, fushat dhe luginat lumore më të njohura).</li> <li>▪ Dallon tipat kryesore klimatike që dominojnë në Evropë.</li> <li>▪ Analizon përhapjen e lumenjve dhe të liqeneve ne kontinentin e Evropës.</li> <li>▪ Analizon përhapjen e botës bimore dhe shtazore ne kontinentin e Evropës.</li> </ul>
	<p><b>Evropa Jugore, veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon gadishujt, ishujt, objektet tjera natyrore dhe shtetet që e përbëjnë Evropën Jugore.</li> <li>▪ Analizon pozitën e Evropës jugore dhe ndikim historik të saj.</li> <li>▪ Vlerëson ndikimin e Detit Mesdhe përmes rritjes së bimëve mesdhetare dhe jetës së njerëzve.</li> <li>▪ Dallon në hartë sistemet malore, fushat, rrafshlartat dhe luginat lumore më të njohura dhe të arsyetojë pse rreth Mesdheut ka termete dhe vullkane (Etna, Vezuvi,etj.).</li> <li>▪ Analizon faktorët klimatik që ndikojnë në klimën e vendeve të Evropës Jugore.</li> <li>▪ Arsyeton rrjetin e varfër lumor, sasia e vogël e ujit gjatë verës dhe varfëria e liqeneve në Evropën Jugore.</li> </ul>
	<p><b>Evropa e Mesme, veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon pozitën gjeografike të Evropës së Mesme dhe rëndësinë e saj për regjionet e tjera të Evropës.</li> <li>▪ Identifikon në hartë shtetet e Evropës së Mesme dhe fqinjët e tyre.</li> <li>▪ Analizon shtrirjen e vargmaleve, malet e vjetra,</li> </ul>

		<p>ultësirat dhe fushat e rëndësishme të këtij regjioni.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon dhe arsyeton tipat e klimës mes pjesëve perëndimore dhe lindore, viseve të larta dhe të ulëta të Evropës së Mesme.</li> <li>▪ Identifikon lumenjtë më të rëndësishëm dhe i përshkruan veçoritë specifike të tyre.</li> <li>▪ Dallon në hartën fiziko-gjeografike liqenet më të njohura në Evropën e Mesme.</li> </ul>
	<b>Evropa e Mesme, veçoritë shoqërore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Radhitë popujt e Evropës së Mesme sipas numrit të popullsisë.</li> <li>▪ Analizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike sipas shteteve veç e veç, duke gjetur ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.</li> </ul>
	<b>Evropa Perëndimore, veçoritë natyrore</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vlerëson rëndësinë e pozitës gjeografike të Evropës Perëndimore dhe rolin e saj për Evropën në përgjithësi.</li> <li>▪ Vlerëson se çfarë ishte roli i pozitës gjeografike në ngjarjet historike të Evropës Perëndimore.</li> <li>▪ Arsyeton rëndësinë e detit për jetën dhe në luftën e njerëzve me të.</li> <li>▪ Vlerëson rëndësinë e Oqeanit dhe të rrymës së Golfit në klimë dhe në jetën e njerëzve.</li> <li>▪ Identifikon malet më të njohura molloke, të reja, fushat, polderet dhe luginat lumore.</li> <li>▪ Arsyeton rolin e grykave të lumenjve në formë të hinkës (estuarëve) për lundrim.</li> </ul>

	<p><b>Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon shtrirjen gjeografike të Evropës Veriore dhe Verilindore.</li> <li>▪ Vlerëson ndikimin e detit dhe klimës në këtë regjion gjeografik.</li> <li>▪ Arsyeton ndryshimet e mëdha në relief si rezultat i ndikimit të akullnajave.</li> <li>▪ Përshkruan relievin malor, rrafshlartat malore, fjordet, fushat dhe pyjet.</li> <li>▪ Dallon tiparet e klimës dhe dallimet e saja nga Atlantiku e deri te tajgat ruse.</li> <li>▪ Arsyeton shkaqet e lumenjve të shkurtër, me shumë ujë dhe me fuqi të madhe energjetike.</li> <li>▪ Arsyeton praninë e numrit të madh të liqeneve.</li> <li>▪ Dallon ndërrimin e bimësisë dhe të kafshëve nga veriu e deri në jug dhe nga perëndimi në drejtim të lindjes.</li> </ul>
	<p><b>Evropa Veriore dhe Verilindore, veçoritë shoqërore ekonomike</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon popujt që e banojnë këtë regjion dhe veçoritë e tyre demografike, kulturore dhe ekonomike.</li> <li>▪ Vlerëson rolin e pasurive dhe kushteve natyrore me strukturën e ekonomisë së këtyre vendeve.</li> <li>▪ Nxjerr përfundime pozitive si kanë arritur njerëzit nivelin e lartë të zhvillimit kulturor e ekonomik në kushte të vështira natyrore.</li> </ul>
	<p><b>Evropa Lindore me Bashkësitë e Shteteve të Pavarura -veçoritë natyrore</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon në hartë shtetet e Evropës Lindore dhe sqaron Bashkësinë e Shteteve të Pavarura.</li> <li>▪ Analizon deri ku shtrihet Evropa Lindore dhe deri ku Bashkësia e Shteteve të Pavarura si dhe sqaron pozitën transitive socio-ekonomike dhe politike të këtyre shteteve.</li> <li>▪ Dallon tërësitë e mëdha relievo-re: Ultësirën e</li> </ul>

		<p>Evropës Lindore, Ultësirën Perëndimore të Sibirit, të Turanit, vargmalet e Karpateve, Kaukazit të Madh, të Vogël, Malet e Azisë Qendrore deri te lumi Amur dhe Gadishulli Kamçatka.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon tipat e klimave prej Evropës Lindore e deri në bregdetin e Pacifikut dhe prej Oqeanit të Ngrirë të Veriut e deri te vargmalet e larta në jug.</li> <li>▪ Ndërlidh klimën me tipat e vegetacionit sipas zonave.</li> <li>▪ Identifikon, rrjedhjet, drejtimin e rrjedhjes dhe veçoritë specifike të lumenjve.</li> <li>▪ Identifikon, emërton dhe të krahason liqenet më të njohura të Evropës Lindore dhe Bashkësisë së Shtetve të Pavarura sipas veçorive të tyre.</li> <li>▪ Identifikon në hartë shtrirjen e shkretëtirave, emrat e tyre dhe të arsyetojë praninë e tyre.</li> </ul>
<p><b>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</b></p>	<p><b>RNF: 3. Shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat dhe rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b></p> <p>3.1 Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</p> <p>3.2 Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</p>	
	<p><b>Evropa Jugore, veçoritë shoqërore ekonomike</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përkufizon specifikat natyrore, populative, kulturore, ekonomike dhe politike të shteteve të Evropës Jugore.</li> <li>▪ Identifikon veçoritë e ujit, klimës, pasurive kulturore dhe elementeve tjera etnike të zonës mesdhetare dhe rolin e tyre turistiko-ekonomik.</li> <li>▪ Identifikon popujt që jetojnë në vendet e Evropës Jugore.</li> <li>▪ Analizon shpërndarjen hapësinore të popullsisë,</li> </ul>

		<p>shpjegon dallimet në dendësi, në vendet e ndryshme të Evropës Jugore.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon zonat turistike më të njohura në këtë regjion dhe vlerëson ndikimin e turizmit në ekonominë e shteteve të Evropës Jugore.</li> </ul>
<p><b>Vendimmarrja dhe institucionet</b></p> <p><b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b></p>	<p><b>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b></p> <p>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme</p> <p>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</p> <p><b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b></p> <p>2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pat parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</p> <p>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-geografike të mjedisit natyror e human.</p>	
	<p><b>Tema</b></p> <p><b>Evropa Perëndimore, veçoritë shoqërore ekonomike</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Vlerëson rëndësinë e shumë kanaleve që lidhin lumenjtë mes veti.</li> <li>▪ Identifikon pesë limanet më të njohura të Evropës Perëndimore.</li> <li>▪ Analizon shtrirjen gjeografike dhe rëndësinë ekonomike të vendburimeve të qymyrit, naftës, gazit, hekurit dhe metaleve të tjera.</li> <li>▪ Analizon aspekte tjera të ndërlidhura me pozitën e që i kanë mundësuar zhvillim ekonomik dhe turistik këtij regjioni.</li> <li>▪ Identifikon popujt e Evropës Perëndimore sipas shteteve.</li> </ul>



		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Radhitë shtetet e Evropës Perëndimore sipas numrit të banorëve si dhe të ardhurave për kokë banori.</li> </ul>
<b>Vendimmarrja dhe institucionet</b>  <b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<b>RNF: 4. Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b>  4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupore e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdor në jetën e tij të përditshme  4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).  <b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë në pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke</b>  2.1. Përdor burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasë parasysh lëvizjet dhe zhvillimet e përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.  2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-geografike të mjedisit natyror e human.	
	<b>Tema</b> <b>Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë shoqërore</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>  <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon popujt më të njohur në Evropën Lindore dhe Bashkësinë e Shteteve të Pavarura sipas përkatësisë etnike e fetare.</li> <li>▪ Identifikon në hartat e punës qytetet më të njohura dhe më të mëdha të Evropës Lindore dhe Bashkësisë së Shteteve të Pavarura.</li> <li>▪ Analizon shtetet sipas madhësisë sipërfaqësore, populative, nivelit të arsimit, sistemit politik, urbanizimit dhe strukturës ekonomike të tyre.</li> </ul>
<b>Mjedisi, resurset dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b>	<b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm</b>  5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.	

5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.	
<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
<b>Evropa e Mesme, veçoritë ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon shtrirjen e vendburimeve më të njohura të qymyrit dhe të hekurit në këtë regjion.</li> <li>▪ Analizon zhvillimin ekonomik të shteteve të Evropës së Mesme duke u bazuar edhe në resurset e tyre.</li> </ul>
<b>Evropa Lindore me Bashkësinë e Shteteve të Pavarura, veçoritë ekonomike</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon viset e tundrave, tajgeve, stepeve, shtrirjen gjeografike dhe rolin e tyre në ekonomi.</li> <li>▪ Arsyeton hapjen e kanaleve dhe rëndësinë e tyre ekonomike në pjesën evropiane.</li> <li>▪ Identifikon në hartë vendburimet e mineraleve më të njohura në hapësirën e Bashkësisë së Shteteve të Pavarura dhe rëndësinë e tyre ekonomike</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Metodat, teknikat dhe strategjitë e mësimdhënies, në lëndën e gjeografisë, janë një ndër pikat kyçe të programit për një mësimdhënie të suksesshme që nxit interesimin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve.

Zbatimi i metodave, teknikave, strategjive dhe formave të ndryshme të organizimit të procesit është kompetencë profesionale e mësimdhënësve.

Për mësimdhënie të suksesshme kërkohen disa përgatitje paraprake. Planifikimi i kujdesshëm dhe përzgjedhja e metodologjive adekuate është çelësi për një mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive. Rekomandohet që mësimdhënësi të lexojë me kujdes rezultatet e të nxënit për shkallë - (për kompetencë) (RNK), rezultatet e të nxënit për fushë (RNF-të) – Shoqëria dhe Mjedisi si dhe rezultatet lëndore (RNL) të lëndës së Gjeografisë. Rezultatet janë jo vetëm pika referente për përzgjedhjen e përmbajtjeve (njësive mësimore) por dhe për përzgjedhjen e strategjive, metodave dhe teknikave mësimore që do të aplikohen gjatë orëve mësimore. Andaj, për planifikim efektiv të mësimdhënies duhet te merren në konsideratë vazhdimisht dokumentet kurrikulare.

Metodologjia duhet të jetë tërësisht në shërbim të përvetësimit dhe përdorimit më të shpejtë e më të saktë të njohurive, shprehive, shkathtësive dhe vlerave gjeografike, që kontribuojnë në

zgjdhjen e problemeve në jetën e përditshme. Metodatat didaktike duhet të ndërthuren me njëra-tjetrën gjatë gjithë orës së mësimit, në përputhje me karakterin e dijeve, të rezultateve lëndore si dhe në funksion të teknologjive të reja që mund të përdoren nga mësimdhënësit dhe nxënësit.

Mësimdhënia dhe të nxënit, bazuar në kompetenca, kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësimdhënësit e kësaj lënde:

- të marrin parasysh njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet paraprake të nxënësit;
- të nxitin vrojtimin e drejtpërdrejtë, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve dhe vëzhgimeve në natyrë (sa herë që është e mundur)
- të nxitin të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojnë nxënësin, duke e konsideruar partner të vetin dhe duke kuptuar se në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë plotësues të njëri-tjetrit;
- të mbështesin të nxënit e pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët, përmes punës me projekte, punës në grupe, punës individuale, etj.;
- të kenë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të fushës” Shoqëria dhe Mjedisit”, zbatimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe lidhjen ndërlëndore (kjo mund të bëhet me e fuqishme nëse ka nivel më të mirë të bashkëpunimit në aktivet profesionale në nivel shkolle):
- të shfrytëzojnë burime të shumëllojshme informacioni dhe ta çmojnë tekstin si një burim të rëndësishëm, por jo të vetmin për përmbushjen e kompetencave, si dhe
- të përdorin TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënit.

Me qëllim të përmbushjes së kërkesave për nxënie cilësore, këshillohen disa metoda, forma dhe teknika të ndryshme të punës:

- Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, biseda, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt).
- Mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve).
- Mësimdhënia me anë të pyetjeve (teknika e pyetjeve drejtuar nxënësve).
- Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim (në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit).
- Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve.
- Të mësuarit dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale e në veçanti përmes kompjuterit.
- Mësimdhënie që nxit hulumtimin.
- Të mësuarit në natyrë dhe vizitat në ambiente të hapura (nëse kjo nuk është e mundur atëherë sjellja reciproke e eksperiencave nga vizitat jashtë vendit të mësimdhënësit dhe nxënësve).

Për realizimin e programit, mësimdhënësi duhet ketë parasysh edhe parimet bazë në mësimin e gjeografisë. Ai gjatë realizimit të programit të gjeografisë i udhëheq nxënësit në mënyrë që ata me aktivitetet e tyre në klasë, kabinet, etj., të mund të: njoh, vrojtojë, radhis, mat, shënojë, mbledh të dhënat, të mbikëqyr, të mendojë në mënyrë të pavarur, të mbrojë dhe argumentojë

mendimet e tij, duke u nisur prej të njohurës kah e panjohura, prej të afërmes kah e largëta, prej të thjeshtës kah e përbëra, prej konkretes kah abstraktja, prej të veçantës kah e përgjithshmja.

Në shkencën e gjeografisë, si për njohuritë teorike, ashtu dhe për njohuritë empirike dhe praktike që përmban kjo lëndë, krijohen një sërë sisteme njohurish, sikundër janë njohuritë: gjeomorfo-gjeografike, klimo-gjeografike, hidro-gjeografike, bio-gjeografike, ekonomiko-gjeografike, turistiko-gjeografike, demo-gjeografike, etj.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Integrimi i temave ndërkurrikulare në fushën e shoqëria dhe mjedisi i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë botën dhe të përballojnë më lehtë sfidat e jetës.

Temat ndërkurrikulare që mund të integrohen në fushën Shoqëria dhe Mjedisi për këtë moshë të nxënësve janë:

- Edukimi për media.
- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë.
- Arsimitimi për zhvillimin e qëndrueshëm.

### **Edukimi për medie**

I referohet përzgjedhjes dhe përdorimit të mediave për sigurimin dhe përpunimin e informacioneve të reja dhe të sakta, krijimin dhe përdorimin kritik të informatave për hulumtimet dhe zbulimet e reja shkencore. Çështja e edukimit për media përfshin: përmbajtjet lidhur publikimet, shpërblimet dhe efektet e të arriturat në shkencë në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtarë.

### **Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë**

Aftësitë për jetën ndihmojnë nxënësit të marrin vendime të argumentuara, të zgjidhin probleme, të mendojnë në mënyrë kritike dhe krijuese, të komunikojnë në mënyra të shumëllojshme dhe të efektshme, intelektuale dhe emocionale para të tjerëve, si dhe të ndërtojnë jetën e tyre në mënyrë të shëndetshme të sigurt. Gjatë zhvillimit të kësaj çështje rrisin sigurinë e shëndetit të tij dhe të tjerëve, në mënyrë që të jenë të aftë të ndërtojnë hapa të sigurt në mjedisin e tyre dhe më gjerë.

### **Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm**

I referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në marrjen e përgjegjësive të rinjve/nxënësve për qëndrim dhe veprim aktiv ndaj çështjeve në vetëdijesimin dhe ruajtjen e pasurive natyrore, në nivel lokal dhe global. Këtu hyjnë çështjet si : aspekti social, zhvillimit ekonomik dhe mjedisor.

Çështjet e zhvillimit të qëndrueshëm përfshijnë aspektet për të pasur mjedis të shëndetshëm që ndërldhet me vetëdijesimin, veprimin qytetar dhe rëndësinë e shfrytëzimit të burimeve mjedisore si trashëgimi dhe kulturë e brezit të ardhshëm.

## Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi është pjesë integrale e procesit të mësimdhënies dhe të nxënimit. Vlerësimi mat shkallën në të cilën janë arritur (nga nxënësit) njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet e dëshiruara. Ai përfshin, mbledhjen e informacioneve me anë të teknikave të ndryshme të vlerësimit, për arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënimit në nivel klase dhe shkalle. Vlerësimi u shërben mësimdhënësve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies, nxënësve për të përmirësuar të nxënimit si dhe prindërve për të monitoruar progresin e fëmijëve të tyre në shkollë.

Mësimdhënësi duhet të përdorin situata të jetës reale, si pikënisje për vlerësimin e nxënësve. Format e ndryshme të vlerësimit duhet t'u krijojnë mundësi të gjithë nxënësve të vlerësohen në atë mënyrë që është më e përshtatshme për to.

Për vlerësimin e nxënësve, mësuesit duhet të mbështeten në disa parime bazë:

- Vlerësimi duhet të jetë i besueshëm dhe i paanshëm. Nxënësit duhet t'i jepet mundësia të demonstrojnë shkallën e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.
- Vlerësimi duhet t'i ndihmojë nxënësit. Ai duhet t'u japë informacion pozitiv dhe nxitës për t'u përfshirë aktivisht në procesin e të nxënimit.
- Vlerësimi udhëhiqet nga rezultatet e të nxënimit dhe shfrytëzon shumëllojshmëri strategjish dhe teknikash vlerësimi.

### Vlerësimi është në funksion të:

- sigurimit të informatave të nevojshme për përparimin e nxënësve dhe motivimit të tyre për të nxënë;
- Vlerësimit të punës praktike dhe demonstrues;
- identifikimit të vështirësive gjatë procesit të të nxënimit;
- nxjerrjes së përfundimeve për arritjet e nxënësve gjatë procesit të të nxënimit;
- vetëvlerësimit të nxënësve, si dhe
- përmirësimit të mësimdhënies dhe të nxënies.

### Vlerësimi kërkon:

- Rezultate të qarta mësimore;
- Motivim të nxënësve;
- Njohjen e përvojës dhe e aftësive të nxënësve;
- Kërkesa të qarta të nxënësve dhe metoda e teknika mësimore efikase.

**Vlerësimi bazohet në:** Çka thonë, Çka shkruajnë dhe Çka bëjnë nxënësit?

### Etapat e vlerësimit:

- Kontrolli: p.sh. çka di (çka është arritur) dhe çfarë nuk di nxënësi (çka nuk është arritur).
- Matja: ajo që kontrollohet matet.

- Vlerësimi: nënkupton vendosjen e një vlere gjykimi, sasior ose cilësor bazuar në matje me notë.

**Për vlerësimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ka një sërë teknikash:**

- Vlerësimi me gojë (të pyeturit, diskutimi, debati etj.);
- Vlerësimi me shkrim;
- Vlerësimi me anë të dëgjimit;
- Vlerësimi përmes punës praktikë;
- Vlerësimi me anë të pyetësorëve të nxënësve;
- Vlerësimi i projekteve kurrikulare, lëndore ose ndër lëndore;
- Esetë;
- Portofoli;
- Testimi - si ecuri e matjeve sipas një qëllimi të caktuar.

**Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënësve në lëndën e gjeografisë ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme, tematike, atlase, albume, foto, skica, modele, makete, diagrame, mjete grafike, filma mësimorë, kompjuter, projektor, CD, DVD etj. Materiale tekstuale: teksti shkollor, fletore e punës, atlase, harta, libri i mësuesit, udhëzues profesional, fjalorë, gazeta, revista, materiale psikopedagogjike, enciklopedi, etj.

Ndërsa mësimdhënësi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues. Ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë çasje në burimet e ndryshme të të nxënësve. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e njohurive në gjeografi është e larmishme: muzeume, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizive, pjesëmarrje në ngjarje kulturore, sportive, etj. Gjithashtu, burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

**Sugjerime për përdorimin e TIK-ut**

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni.
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar ueb-et për gjeografinë.
- Përdorimi i PC për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave, duke përdorur tipa të ndryshëm softuerëve
- Përdorimi i grafikëve softuerëve.
- Paraqitja grafike e të dhënave.

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Edukatë qytetare**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## **Hyrje**

Lënda Edukatë qytetare në klasën e shtatë, e aftëson nxënësin për të menduar në mënyrë kritike e kreative dhe për tu shprehur në mënyrë të efektshme. Kjo lëndë e ndihmon nxënësi që të bëhet nxënës i suksesshëm, individ i shëndoshë, kontribues produktiv, e mbi të gjitha qytetar i përgjegjshëm.

Në lëndën Edukatë qytetare të klasës së shtatë trajtohen çështjet si: raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë njerëzore, lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë, vlerat shoqërore, humane dhe qytetare, pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale, si dhe mjedisi dhe mireqenia.

Për t'u bërë qytetar i denjë i vendit, nevojitet dije dhe shkathtësi për të krijuar raporte të mira me njerëzit, për të manifestuar sjellje korrekte dhe për të kultivuar shprehi të dobishme. Për këtë qëllim, programi përmban tema që kanë të bëjnë me raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë. Ndërtimi i raporteve të mira ndërnjerëzore në shoqëri që karakterizohen me frymën e pranimit reciprok, mirëkuptimit dhe tolerancës mundëson krijimin e kohezionit social dhe të një shoqërie me më pak konflikte dhe tensione.

Përmbajtja e lëndës Edukatë qytetare përfshinë tema jo vetëm mbi raportet ndërmjet njerëzve ose ndërmjet qytetarëve dhe institucioneve, por edhe të raporteve ndërmjet shoqërisë njerëzore dhe natyrës. Këto raporte janë komplekse sepse në vete përmbajnë aspektin fizik, gjeografik, ekologjik, social, ekonomik, kulturor, psikologjik etj. Të gjitha këto aspekte të lidhjes së shoqërisë me natyrën janë fusha të veçanta studimore, prandaj njohuritë bazike nga këto fusha janë mjaft të dobishme edhe për edukatën qytetare.

Nxënësi i kësaj moshe duhet të kuptojë raportin me rrethin shoqëror dhe me mjedisin ku jeton, prandaj edhe duhet të kultivojë dhe praktikojë vlera qytetare dhe humane. Duhet të kuptojë se shoqëria demokratike bazohet në ligj, në respektimin e të drejtave të njeriut, në respektimin e diverzitetit, barazinë e mundësive, transparencën, gjithpërfshirjen, solidaritetin dhe respektin e dinjitetit njerëzor.

Edukata qytetare mëson nxënësin për t'u bërë qytetar aktiv dhe i përgjegjshëm në vendimmarrje, për t'i njohur llojet e institucioneve, funksionet dhe përgjegjësitë e tyre, pastaj për të njohur ndarjen e pushteteve, rolin e organeve të qeverisjes, rolin e shoqërisë civile, medieve dhe rrjeteve sociale. Të gjitha këto njohuri dhe shkathtësi, duke përfshirë edhe atë që kanë të bëjnë me mjedisin dhe ekologjinë, kontribuojnë në krijimin e mirëqenies së nxënësit, përkatësisht qytetarit.

## **Qëllimi i lëndës**

Për nxënësit e klasës së shtatë, është shumë me interes të mësohet lënda Edukatë qytetare, sepse moshë 12-13 vjeçare paraqet fazë shumë delikate për zhvillimin e personalitetit, si në kuptimin e



paisjes me dije dhe shkathtësi për jetë, ashtu edhe të rrezikut për sjellje devijante ose delikuecë. Kjo është koha kur fillon puberteti dhe rreziku për sjellje, ndikime dhe orientime të gabuara të fëmijëve është i mundshëm. Prandaj, Edukata qytetare e udhëzon fëmijën për sjellje dhe veprime të drejta e të dobishme, si për vetveten, ashtu edhe për familjen, rrethin dhe shoqërinë.

Interesi i familjes, shkollës dhe shoqërisë është që fëmija t'i arrijë kompetencat jetësore të parashtruara në Kurrikulën Bërthamë, pra fëmija të jetë: komunikues efektiv, mendimtar kreativ, nxënës i suksesshëm, kontribues produktiv, individ i shëndosh dhe qytetar i përgjegjshëm. Qëllimi i lëndës Edukatë qytetare është që t'i ndihmojë nxënësit për të zhvilluar këto kompetenca dhe për t'u bërë qytetar i denjë i vendit të vet.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësi në klasën e shtatë arrinë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme. Temat dhe RNL-të dolën nga konceptet dhe rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Shoqëria dhe Mjedisi të shkallës së tretë kurrikulare të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Individi, grupet dhe marrëdhëniet shoqërore	<b>RNF: 1.Hulumton strukturën e grupeve shoqërore dhe mënyrat e pjesëmarrjes dhe përfshirjes në to</b>	
	<i>1.1.Njeh grupet dhe institucionet shoqërore, strukturën dhe organizimin e tyre, si dhe ndërlidhjen me kontekstin kohor dhe hapsinor.</i>	
	<i>1.2. Përkufizon profilin e personaliteteve të shquara dhe kontributin e tyre në zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë ose të fushave të veçanta të saj.</i>	
	<i>1.3. Shpjegon hapësirën e banimit dhe veprimit, shpërndarjen dhe lëvizjen natyrore të popullsisë, migrimet, strukturën, organizimin, zhvillimin dhe transformimin e vendbanimeve dhe të ekonomisë në nivel lokal, rajonal dhe global.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon llojet e ndryshme të raporteve shoqërore (miqësore, bashkëpunuese, afruese, integruese, si dhe ato jomiqësore, larguese, përjashtuese, diskriminuese) dhe lidhjet e tyre me sjelljet personale dhe kolektive.</li> <li>▪ Përshkruan ndjenjën e ngrohtësisë dhe sigurisë që e ndien në shtëpi dhe në shkollë duke qenë i rrethuar me njerëz të afërt dhe dashamirës.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Klasifikon dhe përshkruan rolin e grupeve, organizatave të ndryshme të shoqërisë civile si dhe institucioneve që veprojnë në fusha të ndryshme si: mjedisi, arsimi, kultura, shërbimet publike etj.</li> <li>▪ Përshkruan dhe krahason funksionin dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës në nivelin lokal dhe atë qendror që u shërbejnë qytetarëve si p.sh.: arsim, shëndetësi, mjedis, punësim, drejtësi, infrastrukturë, kulturë, zhvillim ekonomik, siguri, mbrojtje, migrimit, trafikimit, dhunës, ngacmimit (bullying), etj.</li> <li>▪ Analizon rolin e personaliteteve të shquara historikisht në nivel kombi dhe më gjerë dhe ndikimin e tyre në themelimin e institucioneve shtetërore, ligjvënëse, ekzekutive dhe gjyqësore, organizatave, shoqatave humanitare etj.</li> <li>▪ Analizon rëndësinë e motivimit, angazhimit, vullnetarizmit, respektimit, transparencës, raportimit dhe llogaridhënies për zhvillimin e shoqësisë demokratike dhe identifikon faktorët që i pengojnë ato.</li> </ul>
<b>Proceset shoqërore dhe natyrore</b>	<b>RNF: 2. Hulumton dukuritë dhe proceset shoqërore, historike, natyrore dhe mjedisore duke vënë pah ndërlidhjet, ndërvarjet dhe ndërveprimet reciproke.</b>  <i>2.1. Përdorë burime të ndryshme kur prezanton dallimet në mënyrën e jetesës së njerëzve në kohë dhe hapësirë, duke pasë parasysh lëvizjet dhe zhvillimet përgjithshme historike, shoqërore dhe natyrore.</i>  <i>2.2. Shpjegon orientimin në hapësirë, pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, përbërjen e gjeosferave, veçoritë e elementeve natyrore dhe socio-gjeografike të mjedisit natyror e human.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Analizon lidhjet dhe ndikimet reciproke ndërmjet natyrës dhe shoqërisë duke pasë parasysh aspektet gjeografike, mjedisore, ekonomike dhe kulturore.</li> <li>▪ Analizon ndryshimet në shoqëri si procese të përgjithshme dhe të përhershme të shkaktuara nga natyra ose njeriu, si:</li> </ul>

	<b>shoqërisë</b>	<p>tërmetet, vullkanet, vërshimet, thatësitë, shkrirja e akullnajave, lufta, epidemitë, uria, varfëria, papunësia etj., shpesh të ndërlidhura dhe të ndërvarura.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon rëndësinë e përdorimit të teknologjisë për të hulumtuar dhe prezantuar natyrën në funksion të zhvillimit ekonomik, kulturor e turistik.</li> <li>▪ Prezanton gjetjet nga eksplorimi i natyrës në rrethinë e më gjërë, si: florën dhe faunën, lumenjtë, liqenet, parqet kombëtare, malet, fushat pjellore, monumentet natyrore dhe ndikimin njerëzor në natyrë.</li> <li>▪ Analizon dokumentarë dhe burime të ndryshme për ndikimin e njeriut në natyrë.</li> </ul>
<b>Normat, të drejtat dhe përgjegjësitë</b>	<p><b>RNF: 3. Analizon dhe shqyrton në mënyrë kritike dhe zbaton normat e rregullat shoqërore për jetë të përbashkët në diversitet</b></p> <p><i>3.1. Kupton dhe analizon shkaqet dhe rrethanat e ndryshimit të normave, ligjeve dhe zakoneve për rregullimin e jetës shoqërore në kohëra dhe vende të ndryshme.</i></p> <p><i>3.2. Kupton dhe vlerëson llojllojshmërinë e kulturave, traditave, bashkësive të ndryshme dhe tregon tolerancë dhe respekt për to.</i></p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënimit të lëndës (RNL)</b>
	<p><b>Rregullat, normat dhe ligjet</b></p> <hr/> <p><b>Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon evoluimin dhe funksionimin e rregullave, normave dhe ligjeve shoqërore dikur dhe sot.</li> <li>▪ Krahason traditat, zakonet dhe adetet e pashkruara që praktikohen ose janë praktikuar dikur në familje ose komunitet, si: besa, mikpritja, fejesa dhe martesat, lojërat tradicionale, festat popullore etj., me rregullat, normat dhe ligjet e shkruara që praktikohen në shoqëri dhe institucione publike, si: shkollë, teatër, spital, polici, organe të pushtetit, organizata shoqërore etj.</li> </ul> <hr/> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon rëndësinë e respektimit të vlerave humane për funksionimin e një shoqërie të qëndrueshme, si p.sh. paqja, liria, barazia, respektimi i drejtave të njeriut, solidariteti, toleranca, bëmirisia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj. dhe i praktikon këto në jetën e përditshme.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve që janë në kundërshtim me vlerat e shoqërisë demokratike si: paragjykimet racore ose etnike, diskriminimin gjinor, jotolerancën fetare, përjashtimin social, ekstremizmin, radikalizmin, korrupsionin etj., te personat dhe institucionet përgjegjëse.</li> <li>▪ Shpjegon rëndësinë e raportimit të veprimeve të dhunshme dhe aktiviteteve të paligjshme si: trafikimi i lëndëve narkotike, armëve, qenieve njerëzore, detyrimin në punë të rënda, trajtimin johuman të të pambrojturve dhe viktimave të trafikimit te personat dhe institucionet përgjegjëse.</li> <li>▪ Shpjegon rëndësinë e përfitimit të shoqërisë nga trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve pa dallim përkatësie gjinore, moshe, sociale, etnike, fetare, racore etj., duke u bazuar në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.</li> </ul>
<b>Vendimmarrja dhe institucionet</b>	<b>RNF: 4.Jep ide dhe propozime si dhe merr vendime në mënyrë të vetëdijshme dhe të përgjegjshme</b>  <i>4.1. Vlerëson ndikimin e vendimmarrjes individuale, grupe e institucionale në kohë dhe vende të ndryshme, krijon qëndrime personale për to dhe i përdorë në jetën e tij të përditshme.</i>  <i>4.2. Tregon kujdes, respekt e përgjegjshmëri për vendimmarrjen e drejtë në aktivitetet ku është i përfshirë (në shkollë, bashkësi dhe më gjerë).</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Pjesëmarrja në vendimmarrje institucionale</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Dallon rolin institucioneve lokale dhe atyre qendrore në vendimmarrje për rregullimin e jetës së qytetarëve në nivel lokal dhe shtetëror.</li> <li>▪ Shpjegon se si secili qytetar i moshës madhore mund të bëhet pjesë e institucioneve vendimarrëse të nivelit lokal dhe qendror.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Demonstron njohuri dhe shkathtësi për pjesëmarrje në vendimmarrje në nivel, klase, shkollë apo komuniteti që kanë të bëjnë me interesat e bashkëmoshatarëve.</li> <li>▪ Analizon vendimet që merrën nga grupe, organe dhe institucione të ndryshme që janë me interes për të dhe bashkëmoshatarët p.sh. për sjelljet, vlerësimin e arritjeve, përfshirjen ose mospërfshirjen në aktivite shkollore dhe jashtë saj, etj.</li> <li>▪ Identifikon dhe respekton vendimet që dalin nga institucionet shkollore, lokale dhe qendrore që janë me interes për të, shoqërinë dhe mjedisin (p.sh., vendimet e këshillave të ndryshme që funksionojnë në shkollë, në lagje, dhe nivel vendi)</li> <li>▪ Vlerëson rolin e shoqërisë civile, medieve dhe grupeve të ndryshme (OJQ-ve, shoqatave, forumeve, medieve të shtypura dhe elektronike, grupeve të ndryshme në rrjetet sociale, etj.), në interes të përmirësimit cilësisë së jetës dhe për nxitjen e qytetarëve për të reaguar ndaj padrejtësive të ndryshme dhe për të dhënë ide dhe propozime konkrete.</li> </ul>
<b>Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm</b>	<b>RNF: 5. Kontribuon në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.</b>  <i>5.1. Inicion aktivitete konkrete grupore me qëllim të ngritjes së vetëdijes së bashkësisë për ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit jetësor.</i>  <i>5.2. Vlerëson dhe vepron sipas parimeve bazë të zhvillimit të qëndrueshëm.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Mjedisi dhe mirëqenia</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Prezenton aktivitete që zhvillohen në shkollë, komunitet dhe më gjerë, për çështje mjedisore (p.sh. iniciativat e nxënësve, klubeve në shkollë, prindërve, qytetarëve dhe OJQ-ve që veprojnë në komunitet).</li> <li>▪ Shpjegon rëndësinë dhe demonstroi shkathtësitë e kursimit të ujit, energjisë, ruajtjes së gjelbërimit, riciklimit të mbeturinave, kultivimit të bimëve, mbrojtjes së kafshëve, në aspektin dhe funksionin e mirëqenies ekonomike, shëndetsore dhe sociale.</li> </ul>

		<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikon dhe analizon masat mbrojtëse të organizatave dhe institucioneve përkatëse për mjedisin që veprojnë në komunë dhe në nivel vendi, si: parandalimi i ndotjes së ujit, ajrit, tokës, pastaj kufizimin e gjuetisë, keqtrajtimin e kafshëve etj.</li> <li>▪ Bashkëpunon me tw tjerwt, organizata apo institucione përkatëse për realizmin e aktivitete të ndryshme lidhur me shënimin e festave mjedisore, si: Dita Botërore e Mjedisit Dita e Tokës, Dita e Ujit, Dita e Biodiversitetit etj.</li> </ul>
--	--	---

## Udhëzime metodologjike

Për arritjen e rezultateve të parapara për këtë moshë dhe klasë, lënda Edukatë Qytetare, ndihmon shumë në pajisjen e nxënësve jo vetëm me njohuri, por i bën ata edhe të shkathët në çdo lëmi. Për këtë arsye ekzistojnë një mori metodash dhe strategjishë si dhe teknikash që mësimdhënësi duhet t'i përdorë në mësimdhënie. P.sh. tema: *Raportet shoqërore, sjelljet dhe shprehitë*, nxënësi këshillohet që të hulumtojë në faqet zyrtare të institucioneve tona që veprojnë në Kosovë dhe t'i sjellin materialet e ndryshme në klasë. Ata në grupe mund t'i ndajnë rolet, p.sh., nëse është fjala për institucionet ligjvënëse, ata do ta kenë rolin e deputetit dhe nga aty njëherit t'i analizojnë disa ligje, e mëpastaj të provojnë të nxjerrin ligje të mira që do të jenë në funksion për njerëzit. Kësisoj, në kushte klase do të mund të simulohet një parlament i vogël. Kur është fjala për personalitetet e shquara natyrisht se, mësimdhënësi sjell në klasë material me thënie të ndryshme të personaliteteve të shquara botërore dhe do të lexohen dhe analizohen nga ana e nxënësve.

Sa i përket temës: *Lidhjet dhe ndikimet reciproke të natyrës dhe shoqërisë*, mësimdhënësi këtë mund t'a realizojë përmes një filmi ose dokumentari i nxjerr nga YouTube, që ka të bëjë me katastrofat ekologjike, si: vërshimet, tërmetet, zjarret, thatësitë etj. Në bazë të atyre pamjeve, nxënësit ndahen në grupe dhe debatojnë për pasojat që dalin nga keqpërdorimi i resurseve natyrore nga ana e njeriut. Ngjashëm mund të realizohen edhe tema tjera mësimore.

Tema, *Rregullat, normat dhe ligjet shoqërore*, mund të realizohet ashtu që nxënësit duke u bazuar në shpjegimet që i kanë dëgjuar nga të moshuarit ose nga prindërit e tyre, do të sjellin argumente rreth riteve dhe zakoneve të vjetra. Ato, sigurisht se dallojnë nga rajoni në rajon, sepse dihet që struktura e nxënësve është mjaft heterogjene për sa i përket origjinave rajonale, sociale dhe kulturore. Për to, merren shënime dhe rangohen, duke nxjerr dallimet dhe ngjashmëritë. Sigurisht se kjo na ndihmon që, gradualisht të vijmë deri te analiza dhe krahasimi i traditave, zakoneve dhe riteve, me ligjet e nxjerra nga institucionet. Kësisoj, kuptohet karakteri universal i ligjit, për dallim nga karakteri i pjesërishtëm dhe i kufizuar i traditës, zakonisht ose rritit.

Sa i përket temës *Vlerat shoqërore, humane dhe qytetare*, për nxënësin është e domosdoshme t'i ndjejë dhe t'i kuptojë llojllojshmërinë e vlerave humane (paqeja, liria, barazia, respektimi i drejtave të njeriut, të drejtën humanitare, solidariteti, toleranca, bamirësia, vullnetarizmi, falja, pajtimi, ndihma, empatia, shpëtimi etj.) dhe të përpiqet t'i praktikojë këto në jetën e përditshme. Si mund të realizohet kjo? Kjo mund të realizohet edhe gjatë orës mësimore, por edhe jashtë orës mësimore. Në klasë mësimdhënësi sjell dokumentin “Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve”, që ka të bëjë mbi barazinë, lirinë, solidaritetin etj., dhe në bazë të njohurive për këto të drejta, ata kuptojnë rëndësinë e humanitetit, faljes, pajtimit: si vlera qytetare dhe ndjesisë se të gjithë jemi të barabartë. Ndërsa, jashtë klase por në ambiente të shkollës mund të organizohen aksione të ndryshme vullnetare, kuptohet me ndihmën e mësimdhënësve dhe tërë stafit shkollor (p.sh. java e solidaritetit me fëmijët me nevoja të veçanta, apo me të moshuarit, me qytetarët që kanë pësuar humbje materiale nga vërshimet, tërmetet, zjarret, orteqet etj.).

Sa i përket temës *Pjesëmarrja në vendimmarrje Institucionale*, nxënësi nëse është i mirëinformuar me të drejtat e tij; ai do të jetë aktiv edhe në vendimmarrje në baza personale dhe grupore, si: vendimet që merren në nivel klase, gjenerate, shkolle, komune apo/dhe shteti. Këto fillin e kanë në këshillat e nxënësve, të prindërve, drejtuese e profesionale të shkollës dhe komunitetit. Për këto, mësimdhënësi duhet të bëjë plane në gjithëpërfshirjen e nxënësve duke ua përshtatur aftësive për çka ata janë në gjendje të marrin vendime. Psh, organizimet e mbrëmjeve shoqërore, ekskurzioneve, marrja pjesë në turnire, gara, dhe aktivitete të ndryshme shkollore.

*Mjedisi dhe mirëqenia* është tema tjetër, ku rezultatet na obligojnë që nxënësi së pari të dijë për rëndësinë e angazhimit të tij dhe përfshirjes në aktivitete të ndryshme. Këtë mësimdhënësi e konkretizon në klasë; përmes shembujve duke i ndarë në grupe dhe duke i emëruar me emra të ndryshëm të klubeve. Për shembull, në shkollë është klubi i lexuesve, klubi i aktrimit, klubi letrar, i futbollit, i ambientalistëve, i ndërmjetsimit (për zgjidhje problemesh në mes nxënësve), i riciklimit, higjienës etj.

Pra, kompleksi i llojllojshëm i metodave dhe teknikave, përbën strategjinë e mësimdhënies dhe është në funksion të parimeve të kurrikulës. Gjithmonë duke pasur parasysh potencialet, interesat, stilet e të nxënësve të nxënësit dhe mundësinë e lidhjes së temave mësimore me situata dhe realitete jetësore.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Çështjet ndërkurrikulare janë tema që domosdo duhet ndërlidhur me rezultatet e fushës/lëndës mësimore andaj duhet t'i kushtohet vëmendje realizimit të tyre. Nga mësimdhënësi kërkohet që në fazën e planifikimit të analizojë rezultatet e lëndës, temat dhe njësitë mësimore dhe të parashih se me cilat çështje ndërkurrikulare që janë përcaktuar në Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët ndërlidhen. Në këtë mënyrë sigurohet trajtimi i tyre. Temat ndërkurrikulare që mund të përfshihen në lëndën Edukatë qytetare janë:

- Edukimi për qytetari demokratike;
- Edukimi për paqë;
- Globalizmi dhe ndërvarësia;
- Edukimi për media, si dhe
- Arsimit për zhvillim të qëndrueshëm.

Temat mësimore që janë përcaktuar në progamin lëndor të Edukatës qytetare natyrshëm lidhen me çështjet ndërkurrikulare të përcaktuara në Kurrikulën Bërthamë të Arsimit të Mesëm të Ulët. Mësuesit i mbetet të identifikoj ato dhe të bëj ndërlidhjen me temat, RNL-të dhe njësitë mësimore.

## **Udhëzime për vlerësim**

Vlerësimi bëhet me qëllim përparimi të nxënësit, ndjekjes së progresit në nxënie dhe përmirësimit të mësimdhënies. Vlerësimi është i lidhur ngushtë me metodologjinë, mjetet didaktike të nevojshme dhe kërkon konsistencë në gjithë procesin. Ai realizohet përmes vlerësim formativ e sumativ duke përdorur teknika (vëzhgimin, testimin, etj.) dhe instrumente të ndryshme (fleta kontrolluese, teste, notesa të mbajtjes së shënimeve, etj.). Këto metoda dhe instrumente përdoren për të parë nivelin e njohjes, analizës, gjykimit, vlerësimit, dhënies së mendimeve në mënyrë të pavarur, në këtë kontekst se si nxënësi po i bënë diskutimet, debatet, prezantimet, hulumtimet, si po bashkëpunon me të tjerët, si po i përdor vebfaqet, (p.sh., për nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme ligjore, artikujve, fotove, filmave, etj., apo përdor vebfaqet e besueshme, apo i citon burimet, etj.). Mbi të gjitha qëllimi i vlerësimit është të vëzhgohet progresi i përvetësimit të njohurive, i zhvillimit të sjelljeve, qëndrimeve dhe vlerave në përshtashmëri me rrethanat dhe situatat jetësore dhe i zhvillimit të mësimdhënies duke u bazuar në progresin e nxënësit.

## **Udhëzime për materiale dhe burime mësimore**

Edukata qytetare mund të realizohet jo vetëm përmes teksteve të ndryshme mësimore, por edhe me shumë burime të tjera si: libra të ndryshëm për ushtrime, fletore pune, broshura, përdorim të internetit, hartave, leksikone, enciklopedive, gazetave ditore, revistave periodike, radios dhe televizionit, projekteve të ndryshme empirike, programeve softuerike, intervistave, vizitave mësimore, sjelljes së ekspertëve në ambiente klase etj.

Natyrisht, të gjitha këto burime duhet t'i sigurojë mësimdhënësi, në bashkëpunim me stafin e shkollës, stafin prindëror etj. Gjithashtu, mësimdhënësi angazhon nxënësit të hulumtojnë në mënyrë të pavarur individuale ose si grup, për tema të caktuara në kuadër të lëndës, duke u bazuar gjithnjë në dokumenta të vërteta dhe në përdorimin e materialeve me leje të autorit ose duke e cituar atë.



**FUSHA KURRIKULARE: EDUKATË  
FIZIKE, SPORTET DHE SHËNDETI**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor**  
Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrja

Lënda Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, fokus primar ka edukimin e nxënësve mbi rëndësinë që ka aktiviteti fizik, sporti dhe edukimi shëndetësor për jetën e njeriut. Kjo lëndë është parë si një mundësi ideale për promovimin e aktivitetit të rregullt fizik dhe për një stil jetese të shëndetshme.

Kjo lëndë jep shumë efekte përfituese në drejtim të shëndetit për nxënësit. Njerëzit të cilët bëjnë jetë të shëndetshme dhe që rregullisht kanë futur në rutinën e tyre ushtrime fizike, kanë me pak mundësi të zhvillojnë sëmundje të ndryshme. Mënyra aktuale e jetesës përkon me më pak aktivitete fizike, si pasojë e rritjes së përdorimit të makinave, përdorimit të teknologjisë dhe aktiviteteve jo të mjaftueshme në shtëpi, të dinamikës dhe modernizimit të jetës. Kësaj i shtohen edhe zakone të tjera të mënyrës së jetesës, si ushqimet e shpejta, shtimi i peshës, të cilat kontribuojnë në rritjen e rrezikut ndaj sëmundjeve kronike. Është e rëndësishme që nxënësit të zhvillojnë aktivitete fizike dhe sportive duke integruar me arsimimin dhe edukimin shëndetësor për të gëzuar shëndet dhe mirëqenie.

## Qëllimi

Qëllimi i lëndës Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti për klasën e shtatë, është arritja e rezultateve të nxënësit të kompetencave të planifikuara për shkallën e tretë dhe arritja e të gjitha rezultateve të nxënësit të fushës të përcaktuara në programin mësimor dhe në Kurrikulën Bërthamë.

Edukata Fizike, Sportet dhe Shëndeti ndihmon që nxënësit të zhvillojnë njohuritë, shkathtësitë, shprehitë, vlerat, qëndrimet dhe kompetencat e nevojshme, të cilat sigurojnë mirëqenien e shëndetit të tyre mendor, emocional, fizik e social, për të përballuar me sukses sfidat e jetës së tashme dhe të ardhshme.

### 1. Njësitë tematike/mësimore përgjatë një klase/viti shkollor:

- Sporti, roli dhe ndikimi në shëndet dhe mirëqenie,
- Atropometria dhe motorika;
- Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive dhe individuale,
- Atletika dhe gjimnastika sportive, ritmike,
- Të ushqyerit e shëndetshëm,
- Substancat që krijojnë varshmëri, si dhe
- Aktivitetet fizike në natyrë dhe rëndësia e mjedisit.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL	
Mirëqenie plotë fizike, psikike, emocionale dhe sociale	<i>RNF: 1. Shpjegon dhe analizon veprime konkrete për ruajtjen e mirëqenies fizike, psikike, emocionale dhe sociale të tij/saj dhe të tjerëve si në familje, me kolegët dhe anëtarët e komunitetit në situata të ndryshme.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Sportet, roli dhe ndikimi në shëndet dhe mirëqenie</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Dallon presionin e bashkëmoshatareve në situata të ndryshme para, gjatë, pas aktivitetit fizik, sportiv dhe reagon në mënyren e duhur .</li> <li>Analizon vlerat si barazia, diversiteti, respekti, pranimi, toleranca gjatë aktiviteve apo debateve në klasë dhe mjedis</li> </ul>
Zhvillimi i gjithanshëm dhe harmonik i trupit përmes aktiviteteve fizike dhe sportive	<i>RNF: 2. Demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të teknikave në disiplina sportive (atletikë, gjimnastikë, sportet luftarake etj.) duke përforcuar shkathtësitë psiko-fizike individuale dhe kolektive me kombinime lëvizore dhe përfshirje të formave të ndryshme të lëvizjes.</i>	
	<i>2. Liston, përshkruan rregullat elementare të sporteve të ndryshme kolektive dhe demonstron shkathtësi gjatë ushtrimit të elementeve teknike ne sportet kolektive.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Antropometria dhe motorika</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Përshkruan dhe krahason rezultatet antropometrike si dhe i komenton të gjeturat.</li> <li>Demonstron shkathtësi motorike gjate testeve motorike dhe i krahason rezultatet e arritura me rezultatet paraprake.</li> </ul>
	<b>Rregullat e përgjithshme dhe elementet tekniko-taktike të sporteve kolektive</b>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstron shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në basketboll.</li> <li>Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstron shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në volejball.</li> <li>Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstron</li> </ul>

	<b>dhe individuale</b>	<p>shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në futboll.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në hendboll.</li> <li>• Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në sporte individuale: pingpong, tenis, badminton etj.</li> <li>• Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në not.</li> <li>• Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në skijim.</li> <li>• Shpjegon rregullat e përgjithshme dhe demonstroi shkathtësi në realizimin e elementeve teknike dhe taktike në sportet luftarake.</li> </ul>
	<b>Atletika dhe gjimnastika sportive, ritmike</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan disiplinat e atletikës.</li> <li>• Demonstroi shkathtësi për realizimin e teknikave në disiplinën të ndryshme në atletikë.</li> <li>• Shpjegon disiplinat e gjimnastikës sportive dhe ritmike.</li> <li>• Demonstroi kompozim ushtrimesh të ndryshme në parter, mbi vegla dhe valle të ndryshme.</li> </ul>
<b>Promovimi i stilit aktiv dhe të shëndetshëm te jetës</b>	<b>RNF: 3. Hulumton sistemin e klasifikimit të ushqimit të etiketuar, kupton që njerëzit kanë nevojë të ndryshme për ushqim dhe nevojat e tyre ndryshojnë në etapa të ndryshme të jetës se si duhet të ushqehen.</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)</b>
	<b>Të ushqyerit e shëndetshëm</b>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon llojet e ndryshme të ushqimit dhe një mënyrë të përdorimit të artikujve ushqimor.</li> <li>• Shpjegon pasojat e konsumimit të stimuluesve energjetik.</li> <li>• Vlerëson shprehjet e tij në raport me sasinë dhe cilësinë e ushqimit.</li> </ul>
<b>Vetëdijësimi për ndikimin e përdorimit të</b>	<b>RNF: 4. Një dhe dallon situatat e rrezikshme dukuritë dhe shprehjet negative (substancat negative duhani, alkooli dhe drogat) dhe kupton mënyrën për parandalimin e tyre)</b>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)</b>

<b>substancave që krijojnë varshmëri</b>	<b>Substancat që krijojnë varshmëri</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpjegon rrethanat dhe faktorët që nxisin pirjen e duhanit, alkoolit, drogave dhe substancave të tjera.</li> <li>• Krijon qëndrim refuzues ndaj duhanit, alkoolit, drogave dhe substancave tjera.</li> <li>• Interpretin normat ligjore që rregullojnë konsumimin e duhanit, alkoolit, drogave dhe substancave të tjera.</li> </ul>
<b>Edukimi mbi mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm</b>	<i>RNF: 5. Njeh burimet natyrorë, rregullat e sjelljes, në natyrë, në kampe dhe shfrytëzon ato për zhvillim të aftësive fizike.</i>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	<b>Aktivitetet fizike në natyrë dhe rëndësia e mjedisit</b>	<b>Nxënësi:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë aktive në se paku një aktivitet fizik të organizuar në natyrë.</li> <li>• Vlerëson dobritë e shfrytëzimit të mjedisit natyror dhe mjediseve të mbyllura për aktivitetet të ndryshme fizike dhe sportive.</li> </ul>

## Udhëzime metodologjike

Realizimi i përmbajtjes në lëndën Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, për klasën e shtatë, behet përmes përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies, të cilat duhet të jene në përputhje me moshën e nxënësve por edhe t'i përshtaten përmbajtjes, në mënyre që të arrihen rezultatet e përcaktuara me program.

Organizimi i mirë i orës mësimore do të thotë që nxënësit të vendosën në situata konkrete praktike ku ata kanë mundësi të zhvillohen në aspektin fizik, psikologjik, emocional dhe shoqëror. Theks të veçantë duhet t'i kushtohet mbajtjes së higjienës personale dhe të mjedisit. Gjithashtu, duhet të kemi parasysh edhe sigurinë e nxënësve në kuptimin e praktikave të sigurta, të cilat duhet të bëhen shprehi tek nxënësit në mënyrë që ato të ndiqen gjatë gjithë jetës së tyre .

Mësimdhënia është proces ndërveprues dhe ka të bëjë me faktin se funksioni dhe qëllimi kryesor i saj është të nxënit. Kjo është karakteristika më themelore e të gjithë metodave dhe teknikave, me në qendër nxënësin, që përdoren në klasën e shtatë duke përfshi edhe metoda dhe teknika tjera të cilat sigurojnë një mësimdhënie gjithëpërfshirëse për të gjithë nxënësit.

Disa prej metodave që mund të përdoren janë:

- metoda verbale:ka përdorim të gjerë në mësimdhënien e kësaj lënde,

- metoda e demonstrimit: është shumë efikase për përvetësimin e lëvizjeve të reja nga ana e nxënësve,
- metoda e ushtrimit praktik,
- metoda integrale (e tërësisë) përdoret për paraqitjen e ushtrimit në tërësi me të gjitha pjesët përbërëse të tij,
- metoda analitike (e pjesëshme) ndihmon në përvetësimin e ushtrimeve komplekse dhe më të vështira, diskutimi, stuhi mendimesh (brainstorming) e të tjera të cilat mësimdhënësi i përzgjedh në varësi nga përmbajtja e tematikave.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave dhe teknikave mësimore duhet të shoqërohet me përdorimin e materialeve dhe të mjeteve përkatëse didaktike duke pasur gjithnjë parasysh dhe sigurinë e nxënësve.

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Lidhjet midis fushave të ndryshme kurrikulare zëne vend të posaçëm në lëndën e Edukatës fizike, sportet dhe shëndeti, pasi i ndihmon nxënësit të kuptojnë, përforcojnë dhe zbatojnë në praktikë njohuritë e fituara.

Realizimi i çështjeve ndërkurrikulare do të ndihmojë zhvillimin dhe plotësimin e përmbajtjes së fushës për arritjen e të gjitha kompetencave të përcaktuara me Kornizën e Kurrikulit të Kosovës. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që i ndihmojnë nxënësit në këtë nivel janë:

- Globalizimi dhe ndërvarësia (i referohet bashkëveprimit, kombinimit të aftësive dhe mundësive për të krijuar gjëra të përbashkëta, kombinimit të përpjekjeve me të tjerët për të arritur suksese më të mëdha)
- Shfrytëzimi i medias (i referohet përdorimit të medieve për sigurimin e informacioneve të reja dhe të drejta, krijimin dhe përdorimin e informatave, komunikimin përmes mediave tradicionale dhe digjitale, kritiken ndaj medieve, gjuhën e mediave dhe ndikimin e saj në shoqëri, pritjet e qytetarëve nga mediat dhe përdorimit të drejtë dhe të sigurt)
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm (ekonomik, shërbimet për bashkësinë; siguria, mbrojtja e mjedisit natyror dhe human dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike);
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit në tërë Kurrikulën (cilësia e mirë e komunikimit në të gjitha lëndët);

- Zhvillimi personal dhe aftësitë për jetë (edukimi për konsumim dhe kursim; respekti për vete dhe për të tjerët, toleranca, vetëpërbajtja, aftësia për marrëveshje; vetiniciativa dhe përgatitjet për të ardhmen).
- Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm (i referohet temave me rëndësi të përgjithshme të cilat ndikojnë në ndërgjegjësimin e të rinjve/nxënësve për një qëndrim aktiv ndaj çështjeve dhe dukurive mjedisore, në nivel lokal dhe global)

Në përgjithësi rezultatet e fushës i prekin çështjet ndërkurrikulare andaj kujdes do t'i kushtohet trajtimit adekuat në njësitë mësimore. Megjithatë parësore është puna e mësimitdhënësit i cili gjatë punës t'i kushtoj kujdes çështjeve ndërkurrikulare që në fazën e planifikimit të konsultojë njësitë mësimore me çështje ndërkurrikulare ndërlidhen, në mënyre që të sigurohet të nxënë i integruar i cili synon përfshirjen e të gjitha aspekteve të rëndësishme shoqërore të trajtohen nga lëndë të ndryshme dhe me këndvështrime të ndryshme me qëllim të arritjes së kompetencave.

## **Udhëzimet për vlerësim**

Vlerësimi ka për qëllim mbledhjen sistematike të informatave të arritjeve të nxënësit gjatë procesit të të nxënës, përkrahjen e nxënësit në zotërimin e rezultateve të të nxënës dhe përcaktimin e nivelit të performancës për secilin nxënë. Vlerësimi i bazuar në kompetenca, në vete përmban informata të hollësishme kthyesë të sakta dhe kritike përmbajtësore e konstruktive për të ndihmuar nxënësin në arritjen e rezultateve të të nxënës në zotërimin e kompetencave.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në rezultatet e programit lëndor dhe mësimitdhënësi/ja nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ato rezultate që nuk përshkruhen në program mësimor. Objektivi i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por edhe qëndrimet dhe vlerat e nxënësve. Mësimitdhënësi/ja zhvillon një larmi mënyrash vlerësimi, për shembull:

- Përshkrim gojor të lëvizjeve që duhet përmirësuar;
- Përdoren fjalë e shprehje inkurajuese gjatë të mësuarit;
- Teste me shkrim;
- Pjesëmarrja aktive gjatë orës mësimore;
- Ese (hulumtim individual apo grupor për temat e ndryshme të fushës );
- Video incizimet;
- Korrigjim me takt i lëvizjeve të gabuara;
- Lista e kontrollit;
- Pjesëmarrja aktive në lojërat elementare gjatë orës mësimore;
- Me zgjedhjen e nxënësve më të shpejt në vrapim;
- Me kompozim ushtrimesh fizike dhe me pikë;
- Me sistem pikësh për ushtrimet e veçanta;
- Me sistem pikësh për vallëzimin e kompozuar;



- Me pikë për veprime individuale;
- Me pikë për grupin me të mirë gjate lojës apo garës, si dhe
- Me pikë për skemat lëvizore të vrapimeve të ndryshme.

Këtyre vlerësimeve mund t'u shtohen edhe vlerësimet mbi aktivizimin në veprimtaritë e ndryshme sportive.

Portfolio e nxënësve është mundësi tjetër që mund të përdoret për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e performances gjatë vitit shkollor për një fushë të caktuar. Ajo mund të përmbajë detyra tematike praktike, foto dhe CD të demonstrimit të aftësive lëvizore për linja të ndryshme të programit, angazhime në veprimtari të ndryshme shkollore etj.

### **Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore**

Për realizimin me sukses të kompetencave në fushën mësimore Edukatë Fizike, Sportet dhe Shëndeti është e rëndësishme të përdoren burime të ndryshme mësimore që i motivojnë fëmijët dhe stimulojnë progresin e tyre në mënyrë që të krijojnë shprehi dhe shkathtësi të nevojshme për jetë.

Për realizimin më të suksesshëm të lëndës Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti, duhet të përdoren një spektër i gjerë i burimeve mësimore, përfshirë tekstet, librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve, librat e punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza dhe raporte të ndryshme të lëmit përkatës dhe libra të tjerë.

Mësimdhënësit dhe nxënësit mund të angazhohen në hartimin dhe shfrytëzimin e materialeve mësimore, p.sh.: rezultatet e projekteve të realizuara nga fëmijët mund të bëhen burime të vlefshme mësimore për klasa të ndryshme.

**FUSHA KURRIKULARE: JETA DHE  
PUNA**

**Kurrikula lëndore/programi mësimor  
Teknologji me TIK**

# **Kurrikula lëndore/programi mësimor**

## **Teknologji me TIK**

### **Përmbajtja**

Hyrje

Qëllimi

Temat dhe rezultatet e të nxënit

Udhëzime metodologjike

Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare

Udhëzimet për vlerësim

Udhëzime për materialet dhe burimet mësimore

## Hyrje

Në fushën “Jeta dhe Puna” në klasën VII, lëndë bartëse është lëndë Teknologji me TIK. Lëndë Teknologji me TIK, synon të zhvillojë shkathtësitë praktike tek nxënësit, duke filluar me përdorimin e plastikës, letrës, drurit, veglave të punës, përpunimin e të dhënave me programe kompjuterike, si dhe zhvillon të menduarit kritik gjatë krijimit të modeleve në praktikë.

Në kuadër të kësaj lënde do të zhvillohen module të cilat synojnë të përmbushin konceptet kryesore të fushës “Jeta dhe puna” për shkallën III, si:

- Këshillimi dhe Orientimi në Karrierë,
- Puna dhe Edukimi për ndërmarrësi, si dhe
- Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm.

Përmes Teknologjisë dhe TIK-ut, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë; qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Njëkohësisht, nxënësit do të vetëdijësohen për mundësitë e orientimit profesional.

## Qëllimi

Qëllimi i kësaj lënde është që të zhvillojë të menduarit kritik tek nxënësit, duke i aftësuar ata për zgjidhje të problemeve praktike, marrjen e vendimeve, punën e pavarur, punën me projekte përmes përdorimit të TIK-ut, shkathtësitë për jetë, si dhe i orienton ata drejt qëllimeve të veta.

## Temat dhe rezultatet e të nxënit

Nxënësit në klasën e shtatë arrijnë rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL) për temat e përcaktuara në tabelën e mëposhtme, të dala nga rezultatet e të nxënit të fushës (RNF) Jeta dhe Puna, të shkallës së tretë të kurrikulës (Shk 3) në Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

Koncepti	RNF, TEMA dhe RNL
<b>Teknologji duke përfshirë TIK-un</b>	<b>RNF:</b> <b>1.Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b> <i>1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup, në mjedis shkollor dhe në komunitet.</i> <i>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.</i>

	<p>1.3 Zhvillon aktivitete praktike përmes punës me projekte në shkollë, shtëpi dhe në ambiente tjera jashtëshkollore.</p> <p><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b></p> <p>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.</p> <p><b>3. Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b></p> <p>3.1 Përshkruan dhe analizon doracakët për vegla dhe makina të ekonomisë familjare.</p> <p>3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.</p> <p><b>4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p>4.1 Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.</p> <p>4.2 Aplikon TIK-un në përmbajtje të lëndëve të ndryshme mësimore drejt digjitalizimit në nxënie.</p> <p><b>5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit</b></p> <p>5.1 Kupton aspektin etik dhe ekonomik të ekonomisë familjare e në veçanti veprimet kursimtare në familje.</p> <p><b>6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b></p> <p>6.1 Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë.</p> <p><b>8. Komunikimi në / për jetë dhe punë</b></p> <p>8.1 Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.).</p> <p><b>9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit</b></p> <p>9.1 Adreson sfidat e tashmes dhe të ardhmes në mënyrë konstruktive dhe kreative për të krijuar një shoqëri më të qëndrueshme.</p> <p>9.2 Angazhohet për ruajtjen e baraspeshës ekologjike të mjedisit.</p>
<p><b>Tema</b></p>	<p><b>Rezultatet e të nxënës të lëndës (RNL)</b></p>
<p>1. Materialet dhe përpunimi i tyre</p>	<p><b>Nxënësi:</b> Përshkruan artikujt plastik, prodhimin e tyre nëpërmjet prezentimit digjital, dhe mënyrat e përpunimit të materialeve artificiale.</p> <p>Analizon format e përpunimit të materialeve duke përshkruar lëndën e parë, procesin dhe materialin e ri.</p> <p>Dallon llojet e materialeve plastike për nga funksioni dhe përdorimi i tyre në jetën e përditshme.</p> <p>Përdor mjete të ndryshme për përpunimin e materialeve. Klasifikon mjetet e dorës për nga funksioni, profesioni dhe</p>

		<p>materiali.</p> <p>Kryen përpunime në forma të ndryshme të objekteve me materiale artificiale dhe krijon modele të ndryshme prej tyre në kabinet.</p> <p>Tregon vetitë dhe zbatimet e materialeve termoplastike.</p>
	4. Njeriu dhe shoqëria në teknologji	<p><b>Nxënësi/nxënësja:</b></p> <p>Tregon rëndësinë e teknologjisë ushqimore dhe funksionin e saj nëpërmjetprezentimeve të ndryshme.</p> <p>Paraqet planin për përdorimin e ushqimit të shëndetshëm nëpërmjet projekteve të ndryshme.</p> <p>Analizon tregtimin e prodhimeve në Kosovë me shtetet për rreth.</p> <p>Paraqet transportin si pjesëtë teknologjisë dhe rëndësisë në jetën tonë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme.</p> <p>Krijon ide për ruajtjen e mjedisit për realizimin e aktiviteteve të ndryshme praktike.</p> <p>Krijon publikime të ndryshme për vetëdijësimin e ruajtjes së mjedisit në formë digjitale.</p> <p>Planifikon dhe realizon aktivitete me komunitetin për përdorimin dhe ndikimin e teknologjisë në shoqëri.</p>
	3.Shkathësitë e dizajnit	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Zbaton inicimin dhe skicimin e idesë.</p> <p>Zbaton projeksionin kënddrejtë të trupit në tri rrafshe.</p> <p>Krahason objektet dy dhe tri dimensionale në shkollë dhe jashtë saj.</p> <p>Krijon projekte të ndryshme në programe të dizajnit në formë digjitale.</p> <p>Analizon përdorimin e programeve me objekte të gatshme dhe ato të konstruara nga fillimi sipas idesë.</p> <p>Paraqet idenë në grafikë nëpërmjet vizatimit teknik me mjete</p>

		<p>të punës për vizatim.</p> <p>Konstruktoren projeksionin kënddrejtë të objekteve.</p>
	6.Teknologjia e Informimit dhe Komunikimit	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Përdor në mënyrë të pavarur programin për përpunim të tekstit.</p> <p>Përdor programet për përpunim të tekstit për insertimin e objekteve të ndryshme, krijimin e tabelave dhe grafikeve, kryen printime, veprime tjera në faqen e punës.</p> <p>Shkruan tekste të ndryshme duke krijuar, edituar artikuj të ndryshëm për edukimin, sportin, shëndetësinë etj.</p> <p>Përshkruan funksionimin e rrjetit kompjuterik, protokolëve për komunikimin në internet.</p> <p>Dallon funksionimin e strukturave URL në internet përmes paraqitjes praktike dhe grafike.</p> <p>Krijon plane për mbrotjen e të dhënave, të sigurisë në internet.</p> <p>Prezanton zgjidhje të ndryshme për sigurinë në internet.</p> <p>Krijon BLOG-un për komunikimin me të tjerët.</p> <p>Krijon projekte të ndryshme digjitale për teknologjinë, mjedisin, materialet etj.</p>
<b>Këshillim dhe orientim në karrierë</b>		<p><b>RNF:</b></p> <p><b>RNF 2: 1.Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b></p> <p><i>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.</i></p> <p><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b></p> <p><i>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.</i></p> <p><b>4.Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p><i>4.1Përdorë informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.</i></p> <p><b>7.Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme</b></p> <p><i>7.1Shfaq qëndrime vendimmarrëse në situata të ndryshme duke dhënë arsye të mbi vendimet që merr.</i></p> <p><b>8.Komunikimi në / për jetë dhe punë</b></p>

	<p>8.1 Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.).</p>				
	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="358 268 583 331">Tema</th> <th data-bbox="583 268 1427 331">Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="358 331 583 1035"> <p>7. Këshillimi dhe orientimi nëkarrierë</p> </td> <td data-bbox="583 331 1427 1035"> <p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Informohet nga burime,forma e mënyra të ndryshme për rolin edukimit me kohë për karrierën e tij të ardhshme.</p> <p>Paraqet ambiciet e tij për një profesion të caktuar.</p> <p>Përshkruan mënyrat e planifikimit për tëardhmen në forma të ndryshme vizuale,teknologjike.</p> <p>Tregon shkathtësitë dhe cilësitë personale duke zbatuar përmes aktiviteteve të ndryshme.</p> <p>Kryen aktivitete në ekip lidhur me informimin e profesioneve të ndryshme.</p> <p>Formon bindje për orientimin e tij në karrierë, pa imponime nga rrethi dhe familja.</p> </td> </tr> </tbody> </table>	Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)	<p>7. Këshillimi dhe orientimi nëkarrierë</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Informohet nga burime,forma e mënyra të ndryshme për rolin edukimit me kohë për karrierën e tij të ardhshme.</p> <p>Paraqet ambiciet e tij për një profesion të caktuar.</p> <p>Përshkruan mënyrat e planifikimit për tëardhmen në forma të ndryshme vizuale,teknologjike.</p> <p>Tregon shkathtësitë dhe cilësitë personale duke zbatuar përmes aktiviteteve të ndryshme.</p> <p>Kryen aktivitete në ekip lidhur me informimin e profesioneve të ndryshme.</p> <p>Formon bindje për orientimin e tij në karrierë, pa imponime nga rrethi dhe familja.</p>
Tema	Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)				
<p>7. Këshillimi dhe orientimi nëkarrierë</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Informohet nga burime,forma e mënyra të ndryshme për rolin edukimit me kohë për karrierën e tij të ardhshme.</p> <p>Paraqet ambiciet e tij për një profesion të caktuar.</p> <p>Përshkruan mënyrat e planifikimit për tëardhmen në forma të ndryshme vizuale,teknologjike.</p> <p>Tregon shkathtësitë dhe cilësitë personale duke zbatuar përmes aktiviteteve të ndryshme.</p> <p>Kryen aktivitete në ekip lidhur me informimin e profesioneve të ndryshme.</p> <p>Formon bindje për orientimin e tij në karrierë, pa imponime nga rrethi dhe familja.</p>				
<p><b>Puna dhe edukimi për ndërmarrësi</b></p>	<p><b>RNF:</b></p> <p><b>1.Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet.</b></p> <p>1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup, në mjedis shkollor dhe në komunitet.</p> <p><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b></p> <p>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.</p> <p><b>3.Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b></p> <p>3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.</p> <p><b>4.Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p>4.1Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.</p> <p><b>6.Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b></p> <p>6.1Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë.</p> <p><b>8.Komunikimi në / për jetë dhe punë</b></p> <p>8.1Identifikon burime të ndryshme të informimit e të orientimit për arsim, aftësim profesional dhe punësim (në medie, internet etj.).</p>				



	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	8.Ndërmarrësi i ri	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Përshkruan idenë si ndërmarrës.</p> <p>Krijon një produkt të ri si ndërmarrës.</p> <p>Ndryshon një produkt ekzistues.</p> <p>Përshkruan rolin e investimeve.</p> <p>Organizon aktivitete grupore bamirësie në fokus ndërmarrësinë.</p> <p>Përpilon planin se si do t'i menaxhojë parat e fituara.</p> <p>Prezanton punën e një ndërmarrësi të suksesshëm.</p>
<b>Edukim për zhvillim të qëndrueshëm</b>	<p><b>RNF:</b></p> <p><b>1.Kuptimi dhe ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet</b></p> <p>1.1 Zbaton aktivitete individuale dhe në grup në mjedis shkollor dhe në komunitet.</p> <p>1.2 Kryen aktivitete konkrete praktike sipas planifikimit të parashtruar.</p> <p><b>2. Ngritja e kualiteteve personale për jetë dhe për punë</b></p> <p>2.1 Kupton drejt dhe zbaton udhëzimet e shkruara dhe pasqyrimet pamore për aktivitete të ndryshme praktike.</p> <p><b>3.Kuptimi dhe përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme</b></p> <p>3.2 Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar produkte, modele të thjeshta, bazuar në skica dhe udhëzime.</p> <p><b>4.Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme</b></p> <p>4.1Përdor informacione nga burime elektronike për të qartësuar njohuritë në kontekste të caktuara.</p> <p><b>5.Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe biznesit</b></p> <p>5.1Kupton aspektin etik dhe ekonomik të ekonomisë familjare e në veçanti veprimet kursimtare në familje.</p> <p><b>6.Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe punë</b></p> <p>6.1Zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri, parandalon dhe ndihmon në menaxhimin e rreziqeve në punë.</p> <p><b>9. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit</b></p> <p>9.1 Adreson sfidat e tashmes dhe të ardhmes në mënyrë konstruktive dhe kreative për të krijuar një shoqëri më të qëndrueshme.</p> <p>9.2 Angazhohet për ruajtjen e baraspeshës ekologjike të mjedisit.</p>	
	<b>Tema</b>	<b>Rezultatet e të nxënit të lëndës (RNL)</b>
	2.Shkathësitë e të punuarit	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Kryen përpunime në forma të ndryshme të objekteve me</p>

		<p>materiale artificiale brenda dhe jashtë klasës.</p> <p>Krijon modele të ndryshme me materiale plastike në kabinet.</p> <p>Skicon dhe krijon modelin e çikrikut, modele tjera, sipas kriterëve të dhëna në libër ose manual me materiale adekuate.</p> <p>Krijon projekte të ndryshme nëpërmjet ideve me materiale si: vizore, laps, lamë prerëse, ngjitës, bojëra, plastika, pllaka kompensate, fije, markerë etj.</p> <p>Krijon modeletë ndryshme duke paraqitur polimeret.</p> <p>Prodhon materialin plastik nëpërmjet procedurave të thjeshta me materiale si qumështi, uthulla dhe mjetet tjera të nevojshme.</p> <p>Krijon dhe përdor instrumentet matëse për realizimin e aktiviteteve të ndryshme sipas nevojës.</p> <p>Kryen detyra praktike për të ilustruar përdorimin e instrumenteve matëse dhe funksionin e tyre.</p>
	<p>5.Strukturat, mekanizmat, forcat dhe energjia</p>	<p><b>Nxënësi:</b></p> <p>Përshkruan ndarjen e strukturave shembuj praktik të ndërtimit.</p> <p>Paraqet me aktivitete forcën e materialeve gjatë përdorimit.</p> <p>Shpjegon rëndësinë e pajisjeve elektrike dhe elektronike që përdoren në jetën e përditshme dhe ndikimin e tyre në shoqëri.</p> <p>Krijon levën, makina të thjeshtanëpërmjet materialeve që gjenden në klasë dhe klasifikon llojet e levave sipas përdorimit dhe funksionit.</p> <p>Përdor burimet më të thjeshta të energjisë elektrike gjatë punës praktike dhe dallon burimet e energjisë elektrike të ripërtërishme dhe të paripërtërishme.</p> <p>Përshkruan elementet e ndërtimit të qarkut elektrik të thjeshtë, me çelës etj.</p> <p>Dallon burimet e energjisë elektrike që ndotin ambientin dhe ato ekologjike nëpërmjet realizimit të aktiviteteve të ndryshme.</p>

		<p>Shpjegon punën e motorit, shndërrimin e energjisë elektrike në atë mekanike.</p> <p>Bën dallimin në mes të rrymës alternative dhe asaj të vazhduar gjatë realizimit të punës praktike në shkollë.</p> <p>Analizon punën e çelësave gjatë aktivitetit në shkollë.</p> <p>Paraqet llojet e transmetuesve mekanik nëpërmjet grafikëve dhe punës praktike.</p> <p>Dallon transmetimin sipas llojit, përmasave dhe pozicionit të rrotave, prej rrotave hyrëse deri tek ato dalëse.</p> <p>Krahason llojet e mekanizmave transmetues me dhëmbëzorë gjatë punës praktike.</p> <p>Përshkruan përdorimin, funksionimin dhe rëndësinë e pajisjeve hidraulike dhe pneumatike, dhe analizon pjesët përbërëse dhe mënyrën e funksionimit të sistemit të thjeshtë</p> <p>Kryen aktivitete praktike duke paraqitur punën e sistemit të thjeshtë hidraulik dhe pneumatik.</p>
--	--	--

## Udhëzime metodologjike

Metodologjia e mësimdhënies dhe nxënies përkufizohet si sistem i strategjive, metodave, mënyrave e parimeve dhe mjeteve e teknikave, të cilat na shërbejnë si bazë për ndërtimin e konceptit të mësimin ose për organizimin e dhënies së mësimin në shkollë.

Në KKK-në e re, metodologjitë bazë të mësimdhënies janë:

Mësimdhënia dhe nxënia me nxënësin në qendër dhe gjithëpërfshirjen, i cili merr parasysh dhe adreson stilet e ndryshme të të nxënit, mënyrën dhe shpejtësinë me të cilën mësojnë nxënësit, si dhe aspektet e tjera të diversitetit të nxënësve, duke përfshirë; gjininë, moshën, kulturën, prejardhjen shoqërore dhe ekonomike, si dhe nevojat e veçanta të nxënësve, qoftë për aspektet e nxënies plotësuese qoftë për ato të nxënies shtese.

Mësimdhënia dhe nxënia e diferencuar- nxënësi në këtë pjesë synohet të angazhohen në forma sipas stileve të të nxënit dhe formave të paraqitjes së ideve të tyre. Duke planifikuar mësimin, aktivitetin, instrumentet per individin, jo grupit, atëherë themi se kemi analizuar secilin nxënës në orë duke arritur nxënien e difrencuar.

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në çështjet ndërkurrikulare *Integrimi i çështjeve ndërkurrikulare mund të realizohet përmes:*

- Gjetjes së korrelacioneve midis lëndëve/temave apo njësive mësimore me qëllim të realizimit të ndonjëres nga kompetencat, p.sh., nëse tema mësimore është nga mbrojtja e mjedisit, ajo ndërlidhet edhe me çështje gjuhësore, letrare, teknologjike por edhe me matematikë, edukatë qytetare etj. (shih në KB).

Mësimdhënia dhe nxënia e bazuar në çështjet jashtëkurrikulare, një metodë ku nxënësit mund të zhvillojnë aktivitete jashtëmësimore, p.sh.: vizita në laboratore të mekatronikës, në pyje, në fabrika tekstili etj.

Metodologjia ndërlidhë përmbajtjet e veçanta të lëndëve mësimore me qëllim të arritjes së rezultateve në të nxënit e fushave mësimore me rezultatet e të nxënit të kompetencave kryesore – për shkallë dhe nivele. Pothuajse e tërë veprimtaria e fushës “Jeta dhe puna” bazohet në punën praktike. Metodatat që përdoren te kjo fushë duhet të mundësojnë konkretizimin e teorisë në praktikë.

Të nxënit në bashkëpunim, bën të mundur që, nxënësit të nxënë në mënyrë aktive dhe të shprehin shkathtësitë e tyre praktike. Të nxënit në bashkëpunim, nxit të menduarit e rendit të lartë, ngre motivimin dhe moralin, mësohen shprehitë ndërvetjake, nxit mirëkuptimin midis nxënësve dhe grupeve etj. SHIH UDHËZUESIN PRAKTIK: FUSHA JETA DHE PUNA, faqe 59

## **Udhëzime për zbatimin e çështjeve ndërkurrikulare**

Në kuadër të fushës kurrikulare “Jeta dhe puna”, një ndër qëllimet e rëndësishme të saj është realizimi i çështjeve ndërkurrikulare. Kjo do të ndihmojë në arritjen e kompetencave kryesore të parapara me KKK. Disa nga çështjet ndërkurrikulare që duhet të merren në konsideratë në këtë nivel, por që mund të trajtohen në vazhdimësi edhe në nivelet e tjera janë:

- Njohja e medias;
- Zhvillimi i qëndrimeve ekologjike;
- Gjuha dhe shkathtësitë e komunikimit;
- Barazia gjinore dhe toleranca;
- Puna vullnetare;
- Edukimi për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore;
- Shkathtësitë për jetë;
- Komunikimi ndërkurrikular përmes TIK-ut.

Më shumë për këto çështje, konsultoni Kurrikulën bërthamë për arsimin e mesëm të ulët.

## Udhëzime për vlerësim

Duke u bazuar në dy llojet e rezultateve të të nxënësve në nivel shkalle kurrikulare ( RNK-kompetenca dhe RNF) dhe në planifikimet vjetore, dymujore dhe më pas javore e të orës mësimore, edhe përcjellja dhe vlerësimi i performancës së nxënësve në raport me këto planifikime, duhet të jetë në përputhshmëri me llojet e vlerësimit, siç janë përcaktuar në KKK, respektivisht KB-të (Kapitulli VII). Kjo do të thotë se gjatë tërë vitit shkollor (mësimor) do të bëhet vlerësimi i vazhdueshëm i performancës së secilit nxënës dhe në fokus duhet të jenë arritjet e rezultateve që janë planifikuar në planifikimet dymujore, javore e të orës mësimore. Mbi mesataren e vlerësimit të vazhdueshëm, respektivisht mbi mesataren aritmetike të notave numerike që nxënësi është vlerësuar nga mësimdhënësi gjatë tërë vitit shkollor, bëhet vlerësimi përfundimtar në nivel klase dhe për secilën fushë kurrikulare, lëndë mësimore; nxënësit i vendoset nota shkronjë/numër, siç është paraparë në KB-të. Me të njëjtën procedurë duhet vazhduar me vlerësimin edhe në klasat pasuese, përbrenda shkallës së caktuar kurrikulare dhe kështu, për të arritur te vlerësimi përmbyllës, në nivel shkalle kurrikulare (lexo procedurat e vlerësimit përfundimtar dhe përmbyllës në KB-të, kapitulli VII).

Vlerësimi tashmë duhet të bazohet në UA 08.2016, i cili përcakton qartë, ndarjen e vlerësimit në periudha, gjithashtu vlerësimin e bazuar në shkallën përkatëse.

Nëse dëshirojmë të masim progresin në arritjen e kompetencave, preferohet të ndjekim këtë procedurë:

- Së pari, për fushën e caktuar kurrikulare, përcaktojmë se cilat rezultate të kompetencave të planifikuara në planifikime mësimore do t'i masim;
- Pastaj, përcaktojmë nivelin e arritjes së kompetencës për moshën e nxënësve, sepse këto rezultate, siç e dimë, duhet të arrihen deri në fund të shkallës dhe nuk janë të zërthyera. (Kujto zërthimin e rezultateve të kompetencave për klasë! Shih pjesën e udhëzuesit II.3.1, Rezultatet e të nxënësve për shkallë –kompetencë (RNSH) dhe arritshmëria e tyre shembullin e zërthimit të rezultatit III.3, IV.1 (niveli III) dhe IV.1(niveli II);
- Më pas, caktohet tema apo njësia mësimore përmes të së cilës masim rezultatit e kompetencës;
- Në fund, caktohen kriteret e vlerësimit dhe teknikat e instrumentet adekuate përmes të të cilave maten rezultatet e kompetencave (RNK).

*Një shembull i duhur për matjen e RNK-së:*

KOMPETENC A I.Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit Komunikues efektiv	AKTIVITETI	NIVELI I ARRITJES SË NXËNËSIT					KOMENTE	LLOJET E PËRKRAHJES PËR NXËNËSIN			
		1	2	3	4	5		Përkrahja përmirësuese	Mënyra	Përkrahja për të talentuarin	Mënyra
		II Harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyrë duke përcaktuar fazat kryesore sipas fushës mesimore (letrar, shkencor, artistik).	I. Skicimi i objekteve të ndryshme me përmasa të zvogëluara në perspektive								Udhëzimi i drejt në format e skicimit, paraqitjes objekteve me dorë të lirë dhënia e një shembulli nga vet mësimdhënësi

Si mund të bëhet vlerësimi i arritjes së rezultateve të të nxënësit përmes njësisë mesimore?

Pasi keni përzgjedhur njësinë mesimore që do të zhvilloni në ditët në vijim, hartojeni një plan vlerësimi për këtë njësi. Përcaktoni rezultatet e të nxënësit mbi bazën e RNSH dhe RNF (RNL), zgjidhni një teknikë të vlerësimit dhe caktoni kriteret e suksesit (kujo planifikimin e orës mesimore).

Njëra ndër strategjitë për vlerësim është edhe *Rubrika* që mund të përdoret nga vetë nxënësit për matjen e nivelit të arritjes së tyre. Kjo strategji e vlerësimit bazohet kryesisht në rezultatet e të nxënësit të orës mesimore (plani i orës mesimore). Arritja e rezultateve demonstron në bazë të shkallës së përmbushjes së aktiviteteve. Secila shkallë e arritjes përcaktohet sipas ngjyrave.

### Dosja (portfolio)

Është një koleksion i qëllimshëm i punimeve të nxënësve, që tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij në fushën mesimore të caktuar. Këtu përfshihet pjesëmarrja e nxënësit në përzgjedhjen e përmbajtjes së dosjes, udhëzimet për përzgjedhje dhe kriteret e vlerësimit për të dëshmuar për meritat dhe dëshmitë e vetëreflektimit të nxënësit.

Ky lloj i vlerësimit është vlerësim për të nxënë (vlerësim formativ), pasi që për një kohë të gjatë, vazhdimisht mblidhen informata për zhvillimin e nxënësit.

### Udhëzime për materialet dhe burimet mesimore

Planifikimet mesimore me çasje të re u mundësojnë mësimdhënësve të jenë autonomë në përzgjedhjen e përmbajtjes, metodologjisë së mësimdhënies dhe gjithashtu të materialeve mesimore.

Mësimdhënësit, mbi bazën e përmbajtjes mësimore, metodave dhe teknikave të mësimdhënies, përzgjedhin materialet mësimore që janë në funksion të zhvillimit të kompetencave të identifikuar dhe parimeve të KK-së. Përzgjedhja adekuate e materialeve, konform temës mësimore dhe potencialeve të nxënësve ndikon në stimulimin e progresit të tyre drejt zhvillimit të shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për jetë dhe punë.

Sot, teksti mësimor nuk konsiderohet si burim i vetëm dhe i mjaftueshëm për zhvillimin e kompetencave të nxënësit, sepse nuk mund t'i përcjellë zhvillimet e shpejta që po ndodhin në fushat e ndryshme të jetës shoqërore dhe gjithashtu nuk është i përshtatshëm për gjithë nxënësit e të së njëjtës moshë, sa u përket niveleve të njohjes.

Kjo na bën me dije se, mësimdhënësit duhet të sigurojnë edhe materiale të tjera mësimore për të ndihmuar nxënësit në zhvillimin e kompetencave. Materialet mësimore nuk do të thotë të jenë domosdo të shtrenjta dhe të sofistikuara. Shumë aktivitete mësimore mund të realizohen edhe me materiale të krijuara nga mësimdhënësit, por edhe nga vetë nxënësit; ***kujto të nxënët duke vepruar!***

Krijimi i këtyre materialeve mund të bëhet edhe me materiale ricikluese, si: letër, gazeta, rroba të vjetra, ambalazhe të ushqimeve, copëza të drurit, gjethe, litarë, kopse rrobash,...., etj, respektivisht me gjëra të cilat mund t'i ketë çdo shtëpi dhe që nuk i përdor më. Gjithashtu, në disa raste mësimdhënësit së bashku me nxënës mund t'i riciklojnë edhe vetë.

Si materiale për klasën e shtatë mund të përdoren: druri, letra, ngjitësi etj. Mjetet e punës duhet t'i përshtaten moshës së nxënësve dhe të sigurohet forma e parandalimit të rrezikut në punën praktike.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara mësimdhënësi mund të përdorë burime të ndryshme, qoftë elektronike, por edhe të shkruara, si: libra të punës, broshura, atlase, enciklopedi, softuerë arsimorë, projekte, studime të ndryshme, analiza etj.

Gjithashtu, është shumë me rëndësi që nxënësit dhe mësimdhënësit të bashkëpunojnë edhe në prodhimin e materialeve të ndryshme didaktike, përmes shfrytëzimit të burimeve të teknologjisë informative.